

Atë. Robert DeGrandis S.S.J.

PUSHIMI NË SHPIRTIN SHENJT

Dëshmi dhe mendime për një dhuratë të Shpirtit Shenjt, të pa kuptuar mirë.

Titulli i origjinalit
"Resting in the Spirit"

Titulli në kroatishte
Počivanje u Duhu

Përktheu nga kroatishtja:
Gjon Kelmendi ida

Redaktimi gjuhësor:
Prend Buzhala

Kopertina

*"Zoti është bariu im
asgjë nuk më mungon*

*Më mballon kullotave të gjelbra
më prin në ujëra të qeta
shpirtin ma përtërin."*
(Ps 23, 1-3)

PARATHËNIE BOTIMIT KROAT

Besoj se shumica prej jush, të dashur lexues, së bashku i gëzoheni me mua daljes së këtij libri, të karizmatikut të njohur nga ShBA, atit Robert DeGrandis, meshtarit katolik, i cili është i pranishëm dhe shumë aktiv në lëvizjen karizmatike tani e njëzet e pesë vjet; krahas kësaj, është më i madh dhe teolog i lëvizjes karizmatike. Ky libër është pritur një kohë të gjatë (për shkak të diskutimeve), që bëhen për këtë temë. Libri del me rastin e ardhjes së tij në Zagreb dhe mbajtjes së seminarit karizmatik prej 16 deri më 18 dhjetor 2001.

Lëmi që trajtohet në këtë libër, fenomeni i pushimit në Shpirtin Shenjt, është realitet i pranishëm edhe në hapësirat tona. Shpesh është kundërshtuar, më së shumti në mesin e klerikëve, para së gjithash, nga ata, të cilët vetë nuk e kanë këtë përvojë, ose madje as që kanë marrë pjesë ndonjëherë në situatën kur dikush ka pushuar në Shpirtin Shenjt. Zakonisht, as që kanë biseduar fare me ata që kanë pushuar në Shpirtin Shenjt të dëgjojnë përvojat e tyre të mrekullueshme të takimit me Zotin, paqes së pakufishme dhe ndjenjës se Zoti na do: ose shërimeve shpirtërore dhe trupore që ndodhin kur dikush pushon në Shpirtin Shenjt... Po ashtu, seminarët karizmatikë më së shpeshti kritikohen nga ana e atyre, të cilët kurrë nuk kanë marrë pjesë në to! Natyrisht, në këtë lëmi si edhe në të gjitha lëmitë tjera të fesë, ka keqpërdorime. Mund të ndodhë të përzihet edhe shpirtkeqi ose që pushimi të jetë rezultat i sugjestionit psikik ose teatralitet. Kjo ndodh me siguri në një numër të vogël rastesh, por kjo nuk guxon të jetë arsye për të mos u parë dobia e madhe dhe përvojat e mrekullueshme pozitive të shumë besimtarëve.

Fenomeni i pushimit në Shpirtin Shenjt, sikurse që shihet në këtë libër, bazohet në Bibël (në libër sillen disa citate përkitazi me këtë) dhe është i pranishëm edhe në historinë e Kishës, sikurse që shihet qartë nga shembulli i librit të Shën Augustinit "Shteti i Zotit", ku është paraqitur rasti i prekjes së relikteve të martirëve. Vetë prekja e këtyre relikteve me fe, ka shkaktuar pushimin në Shpirtin Shenjt dhe pastaj ka ndodhur shërimi i plotë i shpirtit dhe trupit. Mirëpo, ky fenomen është intensifikuar me paraqitjen e lëvizjes karizmatike viteve të gjashtëdhjeta në SHBA, e cila pastaj është shtrirë në mbarë botën dhe ka më se gjashtëdhjetë milionë anëtarë. Më së shpeshti dikush pushon në Shpirtin Shenjt pas lutjes së meshtarit me shtrirjen e duarve mbi personin, por ndodh, po , që dikush të pushojë në Shpirtin Shenjt me prekjen e relikteve të shenjtërve, me rastin e lutjes dhe bekimit me Sakramentin Tejet të Shenjtë të Altarit, pas pranimit të Kungimit të Shenjtë, pas lutjes së ndonjë besimtari me përvojë dhe të sprovuar... Mund të pushohet në Shpirtin Shenjt jo vetëm i shtrirë në dysheme, por edhe i ulur, në disa raste edhe duke qëndruar në këmbë.

Pushimi në Shpirtin Shenjt është, në të vërtetë, dhuratë e Zotit, sidomos në kohën tonë. Bekimin e tij e kanë shijuar me miliona njerëz nga të gjitha anët e botës, sidomos në lëvizjen karizmatike. Ajo është përvojë e forcës, e dashurisë dhe bukurisë së Zotit, në të njëjtën kohë, kur zvogëlohen funksionet tona trupore dhe psikike, derisa intensifikohet veprimi i shpirtit tonë, në të cilin ndikon Shpirti Shenjt. Në atë gjendje (e cila, natyrisht, nuk është e domosdoshme as për shërim as për shpëtim) ndodhin përvoja të jashtëzakonshme të pranisë së Zotit dhe për shumë njerëz është përvoja më e bukur e tërë jetës. Në atë gjendje shumica shërohen shpirtërisht apo fizikisht ose fitojnë forcën që t'i bartin kryqet e tyre me gëzim si dhuratë e Zotit. "*Zgjedha ime është e ëmbël e barra ime e lehtë*" – thotë Jezusi (Mt 11,30).

Përvojën e pushimit në Shpirtin Shenjt, përveç besimtarëve laikë, e përjetojnë edhe rregulltarët, meshtarët dhe shumë ipeshkvij, të cilët edhe vetë pastaj fillojnë të shprehen pozitivisht për këtë fenomen. Vlerë të veçantë të librit përbëjnë edhe hulumtimet e hollësishme, të cilat i ka bërë në lidhje me pushimin në Shpirtin Shenjt ati DeGrandis në mesin e burrave dhe grave të profesioneve dhe të moshave të ndryshme. Shumica e atyre që kanë pasur këtë përvojë, shprehet shumë pozitivisht për pushimin në Shpirtin Shenjt. Mund të gjenden edhe shumë dëshmi të besimtarëve laikë dhe të atyre të kushtuar Zotit që flasin për mendimin e autorit dhe përvojën

e tij personale. Në faqet e fundit të librit gjenden tabelat e hulumtimeve të bëra tek mjekët, psikiatrit, psikologët, të cilët po ashtu kanë pasur përvoja tejet pozitive në lidhje me këtë çështje, edhe pse e dimë se pikërisht ata më së vështiri kanë besuar në fenomenet e këtij lloji.

"Kisha e ardhmërisë do të jetë Kisha e përvojës së thellë të besimit. Pushimi në Shpirtin Shenjt, padyshim, do të jetë pjesë e kësaj përvoje" – ka thënë autori i këtij libri. Unë personalisht i gëzohem një zgjimi të madh të fesë te popull ynë kroat, sepse çdo ditë shoh kthime të shumta kah Zoti. Dhe gjëja më e bukur është, se shumë prej tyre fillojnë të jetojnë krishterimin e vet shumë thellë, disa prej tyre, si mistikë të vërtetë. Gati marr guximin të them se kurrë nuk ka pasur kaq besimtarë të mirë si sot, të cilët lusin shumë, agjërojnë, rregullisht lexojnë Shkrimin Shenjt. Familje të tëra kthehen kah Zoti dhe luten së bashku.

Le të ndihmojë ky libër që edhe më shumë t'i njohim pasuritë e fesë sonë katolike njëra prej të cilave është edhe përvoja e pushimit në Shpirtin Shenjt që shumë njerëz i ka sjellë deri te përjetimi i thellë i Zotit dhe deri te përvoja e veprimit të Shpirtit Shenjt. Mendoj se edhe në këtë fenomen po realizohet profecia e Joelit profet: *"E pas këtyre Do ta ndikoj Shpirtin tim mbi çdo njeri e do të bëhen profetë bijtë e bijat tuaja, pleqtë tuaj ëndrra do të shohin, djelmoshat tuaj do të kenë vegime. Madje edhe mbi skllëvër të mi – burrat e gra, në ato ditë do ta ndikoj Shpirtin tim. Do të bëj shenja të bindshme në qiell e në tokë: gjak e zjarr e shtylla tymi!* (Joeli 3, 1-3). Ashtu qoftë dhe le ta ndikojë Zoti Shpirtin e vet në mbarë popullin tonë kroat dhe të gjithë njerëzit vullnetmirë që jetojnë me ne, të ripërtërihemi shpirtërisht dhe të mposhtim çdo të keqe.

Atë. Ivan Mishkiq OFM Conv.

Parathënie

Kuptimi im i pushimit në Shpirtin Shenjt dallohet nga kuptimi i udhëheqësve të shumtë karizmatikë, të cilët përndryshe i respektoj shumë. Disa pikëpamje të kundërta janë publikuar; e disa të tjera jo.

Një meshtar, i cili e mbështet pushimin në Shpirtin Shenjt ka theksuar se, jo rrallë pikëpamjet negative i paraqesin ata, të cilët nuk e kanë këtë përvojë. Në këtë aspekt supozohet se është fjala për orientim intelektual, i cili nuk është i harmonizuar me përvojën e jetës reale. Shumë vetë, brenda dhe jashtë shtetit, më kanë nxitur që "t'ua mundësoj njerëzve që t'i paraqesin përvojat e veta", ashtu që në mënyrë të barabartë të ofrohet këndvështrimi pozitiv.

Ftoj lexuesin të më bashkëngjitet në lutjen fillestare: "Shpirt Shenjt, eja. Na ndaj nga çdo gjë që do të pengonte veprën që Ti dëshirosh ta bësh në ne nëpërmes këtij libri. Qëndrojmë nën Kryqin e Jezu Krishtit dhe mbulohe mi me Gjakun e Krishtit. Rrethohemi me dritën e Krishtit dhe në emër të Jezusit themi se asgjë nuk do të jetë pengesë në rrugën e realizimit të caqeve të Zotit në jetën tonë. Çdo pështjellim duhet të zhduket. Çdo mashtrim duhet të përfundojë. Çdo shtrembërim duhet të ndërpritet, në emër të Jezusit. Shpirt Shenjt, eja dhe fshij prej mendjes sonë çdo pengesë për Urtinë Tënde hyjnore. Pastro prej zemrave tona çdo pengesë të shërimit të kujtimeve tona. Na pagëzo me zjarrin e dashurisë Sate dhe digje papastërtinë që ngarkon shpirtin tonë. Na ndiz me zjarrin e ri, shqetësimin dhe pasionin për veprat e Zotit. Sidomos na jep *'Shpirtin e dijës e të zbulesës'* (Ef 1,17), që ta krijojmë mundësinë ta dallojmë të vërtetën Tënde të thellë mbi pushimin në Shpirtin Shenjt.

Robert Degrandis, S.S.J.

1. Zoti është bariu im, asgjë nuk më mungon

*"Si bariu e kullot grigjën e vet,
në dorë i merr qengjat,
ngrykë i mbart;
i këqyr me kujdes pëllejat."*
(Is 40,11)

"Punëtorja e Zotit..." – të mësojmë nga George Uashington Carver

Është një tregim mbi këtë njeri të dashur, se si shpesh tërhiqej në "Punëtorinë e vogël të Zotit", të merrte përgjigje në pyetje të rëndësishme. Thuhet se George "...ka besuar ngultas, se raporti personal me Krijuesin e të gjitha gjërave është i vetmi themel për jetën në plotësi." Ja tregimi i tij:

"E pyeta Krijuesin e Madh: pse e ka krijuar gjithësinë.

"Pyet diçka më të përshtatshme për mendjen tënde të vockël," u përgjigj Ai.

"Përse është krijuar njeriu?"

"Njeri i vogël, ende dëshiron të dish tepër. Zvogëloje përmasën e kërkesave tua dhe përmirësoji qëllimet."

"Atëherë i thashë krijuesit se do të doja të di çdo gjë për kikirikun. Ai më tha se mendja ime është shumë e vogël të kem mundësi të di çdo gjë për kikirikun, por tha se do të më japë një grusht me kikirikë... I çova kikirikët në laboratorin tim, e krijuesi më tha që ta çel dhe zërthej në elemente. Me njohjen që posedoja nga kimia dhe fizika, iu rreka kësaj pune. E ndava ujin, yndyrën, vajin, rrëshirën bimore, sheqerin, amidonin, pektinet, aminothartinat. Ja! Para vetes i kisha të gjitha elementet përbërëse të kikirikut.

"E shikova Atë, e Ai më shikoi mua. 'Tani e di çka është kikiriku!'

"Por përse e krijove kikirikun?"

Thuhet se në bazë të përgjigjes në këtë pyetje, George Uashington Carver i ka shpikur më se njëqind mënyra të ndryshme të përdorimit të kikirikut dhe kështu e ka përtërirë bujqësinë e Jugut.

Derisa po fillojmë të kërkojmë shpalljen e Zotit mbi pushimin në Shpirtin Shenjt, lus që secili lexues të hyjë në "Punëtorinë e vogël të Zotit" dhe t'ia bëjë Zotërisë disa pyetje. Ai na porositi në Jeremia 33,3: *"Kërkoje ndihmën time e unë do të të vështroj e do të të njoftoj gjëra të mëdha e të pashqyrtueshme që ti s'i di."*

Hyrja

"Pushimi në Shpirtin Shenjt" është në kohën e sotme temë kundërthënëse, e cila përmendet shumë. Shpesh diskutohet për të në kuadrin e lëvizjes karizmatike. Ashtu si lutja në gjuhët e ndryshme, edhe kjo përvojë e pushimit në dysheme gjatë kohës së lutjes, e ka tërhequr vëmendjen e njerëzve. Përkitazi me këtë gjë, është shkruar shumë pak, prandaj shumë gjëra nuk dihen ende. Në një mënyrë, është fjala për një lëmi të virgjër (të pa hulumtuar), sidomos brenda bashkësisë katolike.

Pasi është fjala për diçka që paraqitet dhe ka rezultate, dëshiroj të hap komunikimin dhe të nxis dialogun. Dëshiroj të hulumtoj diçka që e konsideroj lëvizje të Shpirtit Shenjt në kohën e sotshme.

Pushimi në Shpirtin Shenjt, sipas të gjitha gjasave, është dhuratë karizmatike, së paku pjesërisht. Duket se është fjala për karizëm dy llojesh: karizmen e disa njerëzve, në të cilët ndodhet fuqi aq e madhe, sa shumica e njerëzve bien në tokë kur ata luten mbi ta: dhe karizmen e disa pranuesve, të cilët janë aq të hapur, aq sa, kur dikush lutet, rrëzohen nga fuqia e Shpirtit Shenjt.

Kushtetuta dogmatike mbi Kishën, e koncilit të Dytë të Vatikanit, paragrafi 12, në pjesën që bën fjalë për dhuratat karizmatike thotë:

“...pa marrë parasysh, a është fjala për të veçanta ose për të thjeshta dhe të shpeshta, duhet të pranohen me mirënjohje dhe si ngushëlluese, sepse janë shumë të përshtatshme dhe të adaptuara nevojave të Kishës.”

Ajo që dëshiroj të arrij me këtë libër, është fillesa ime në hulumtimin e “përshtatshmërisë dhe adaptueshmërisë” së kësaj dhurate dhe që “ta pranoj me mirënjohje.”

Për deri sa po filloj t’i shqyrtoj drejtimit për shfrytëzimin e dhuratës sikurse është pushimi në Shpirtin Shenjt, më kujtohet rasti kur kam dëgjuar një ekspert për analizë dhe marrje vendimesh. Ai pati thënë se mendimet nuk duhet të vijnë vetëm prej lart poshtë, por edhe anasjelltas. Urtinë e njerëzve do dëgjuar dhe shqyrtuar. Gjithmonë ekziston tendenca - kur është fjala për diçka të jashtëzakonshme që ndodh në Shpirtin Shenjt – që kategorikisht të mohohet, duke mos i dëgjuar me atë rast përvojat e njerëzve.

Gjithashtu besoj se në procesin e shqyrtimit është me rëndësi të shikohen frytet, siç janë ato që i shohim në shërbesën e atit Ralph DiOr, ose atit Edward McDonough e të tjerëve, të cilët i janë kushtuar krejtësisht shërbesës së shërimit. Dallimi i njerëzve që cilësohet me përqendrim dhe shembull është me rëndësi të madhe.

Më në fund, katolikët në mesin tonë presin nga Kisha udhëheqjen, duke e njohur atë si autoritet të dhuruar nga Zoti.

Dëshirojmë ta bëjmë këtë: të hulumtojmë urtësinë e të tjerëve në shërbesën e shërimit që edhe vetë kanë pushuar në Shpirtin Shenjt; të dëgjojmë atë që kanë për të thënë disa ekspertë shëndetësorë dhe të dëgjojmë dëshmitë e laikëve prej shtresave më të ndryshme të shoqërisë. Do t’i shikojmë gjithashtu edhe disa probleme pastorale të lidhura me pushimin në Shpirtin Shenjt dhe të propozojmë udhëzime të caktuara fillestare. Ky nuk është libër i përgjigjeve, por më tepër mjet me të cilin, shpresoj, do të nxisë diskutimin e shëndoshë dhe të drejtpeshuar, i cili do të hedh themelet për drejtimit e ardhshme pastorale dhe teologjike të shqyrtimit të çështjes së pushimit në Shpirtin Shenjt.

Një varg i tërë ekspertësh shëndetësorë i ka dhënë propozimet e veta përkitazi me mënyrën se si do të duhej të paraqitej ky material. Propozimet e tyre janë:

*të paraqiten dëshmitë e shkruara të njerëzve të hapur, të prirur të pyesin, të cilët kanë për qëllim të njoftojnë e jo të bindin të tjerët,

*të paraqitet qëndrimi i tyre dhe rëndësia që ata vetë i japin asaj përvoje,

*të mblidhen përvojat

I falënderoj të gjithë ata që aq lirshëm i kanë hapur zemrat e veta. Kontributi i tyre është vërtet i madh dhe si të tillë e vlerësojmë.

Anketa ka përfshirë 200 individë, të cilët kanë pasur përvoja të shumta të pushimit në Shpirtin Shenjt (shiko shtojcën dhe fundin e gjashtë pjesëve të para) me ç’rast ndjenja e tyre më e shpeshtë e përbashkët ka qenë “dashuria dhe kujdesi” i Zotit. Për këtë arsye, këtë material e sjell në kuadrin e Psalmi të mirënjohur 23. Kjo pjesë e Shkrimit Shenjt në mënyrë të fuqishme e përshkruan ndjenjën e dashurisë dhe kujdesit të Zotit. Ndjenja se jemi të dashur, se na kushtohet kujdes, është themeli i shërbesës të shërimit. Pajtohem me monsinjor Wallshe-in, i cili në veprën

Ruajeni flakën sjell mendimin sipas të cilit pushimi në Shpirtin Shenjt e ka vendin e vet brenda kornizave të përgjithshme të shërbesës së shërimit. Kur të takohemi me natyrën e Zotërisë që është e cilësuar me dashuri, i hapemi tërësisë në çdo lëmi të jetës sonë.

*Ne e njohëm dashurinë që Hyu ka kundrejt nesh dhe i besuam asaj.
Hyu është dashuri dhe kush mbetet në dashuri,
mbetet në Hyun dhe Hyu mbetet në të.*

(1. Gjn 4,16-17)

Përvoja ime e parë e pushimit në Shpirtin Shenjt ka ndodhur në seminarin e Kathryn Kuhlman në vitin 1971. Më kujtohet se si kam qenë i shtrirë në dysheme në një paqe të thellë dhe i vetëdijshëm për fuqinë e pashpjegueshme të Zotit. Qysh atëherë kam pushuar në Shpirtin Shenjt së paku 50 herë. Nëse i shtoj rastet kur i ulur në karrige kam pranuar lutjen, ai numër do të rritej në 75 ose 100. Gadi gjithmonë kur pranoj shërim të brendshëm, pushoj në Shpirtin Shenjt.

Njëra prej përvojave më të mira që kam pasur ndonjëherë ka qenë në Brazil, pas një dite pune të gjatë dhe të rëndë. Kam qenë i rraskapitur dhe dikush u ofrua të më fuste në pushimin në Shpirtin Shenjt. Pasi pushova një kohë të shkurtër te Zotëria, u ngrita krejtësisht i freskët dhe i përtërirë. Ishte fantastike! Nganjëherë, kur jam në stres para seminarit, e lus dikë të më fusë në pushimin në Shpirtin Shenjt. Pushoj ashtu nja njëzet minuta, pastaj jam i gatshëm të shkoj, i hapur dhe i përgatitur të njoh kahen në të cilin Zotëria dëshiron të drejtohem në seminarin konkret.

Në vitin 1972., në universitetin Notre Dame, kur më kanë thirrur në lutje në bashkësinë të cilën e udhëhiqte Francis MacNutt, kam pasur përvojën time të parë të futjes së personit tjetër për pushim në Shpirtin Shenjt. Kur e kam lutur Barbara Shlemon të shikojë personin, i cili ishte shtrirë, mu përgjigj se vetëm "po pushon në Shpirtin Shenjt". Këtë nuk e kisha parë kurrë.

Me kohë jam kushtuar krejtësisht shërbimit të shërimit në kuadër të Përtëritjes Shpirtërore. Pushimi në Shpirtin Shenjt u zhvillua në një mjet të fuqishëm të shërimit, sidomos tek grupet e mëdha, kur nuk ka kohë për lutje të gjata e të veçanta. Fillova të dëgjoj përvojat se si Zotëria realizon shërime të thella për një kohë jashtëzakonisht të shkurtër, derisa njerëzit pushojnë të qetë në karrige ose në dysheme gjatë kohës së shërbesës së shërimit. Individët, të cilët me vite u janë drejtuar meshtarëve dhe laikëve në shërbesën e shërimit, kanë pranuar shërime të thella dhe kanë realizuar përparim të madh në rritjen personale gjatë pushimit në Shpirtin Shenjt.

Sipas përvojës sime, njëra prej mënyrave më efikase që me lutje t'u ndihmohet njerëzve të pranojnë shërimin dhe të përjetojnë rritjen shpirtërore është nëpërmes të pushimit në Shpirtin Shenjt. Zakonisht kam mbajtur kurse mbi lutjen, por tani gjatë atyre kurseve gjithashtu u ndihmoj njerëzve të hapen për përvojën e pushimit në Shpirtin Shenjt. Nganjëherë, në punëtoritë njëditore ose seminarët fund javor, me lutje i fus pjesëmarrësit në pushimin në Shpirtin Shenjt në fillim të seminarit në mes dhe në fund. Ajo përvojë i bën të hapur të pranojnë shërimin prej Zotërisë në mënyrë shumë më efikase se cila do metodë tjetër. Njerëzit, në seminare shpesh i kanë pranuar shërimet më të mëdha pikërisht nëpër pushimin në Shpirtin Shenjt.

Sot, kur udhëtoj nëpër SHBA dhe nëpër shumë shtete tjera duke i mësuar udhëheqësit e Përtëritjes Shpirtërore dhe duke u marrë me shërbesën e shërimit, që ia kam kushtuar krejt kohën time, shoh me qindra pjesëmarrës se si pushojnë në Shpirtin Shenjt— madje edhe ipeshkvij!

Në Çile mu afrua një ipeshkëv të lutem për të. Me atë rast pranoi një pushim të thellë në Shpirtin Shenjt. Shumë vite më vonë kam marrë vesh se si atëherë ka përjetuar një përvojë të thellë mistike. Një tjetër ipeshkëv, në një shtet të Amerikës Jugore, i cili dy herë ka pushuar në Shpirtin Shenjt, ka qenë shumë i kënaqur me atë përvojë. Edhe një ipeshkëv tjetër - përndryshe njeri shumë i shenjtë – ka pushuar në Shpirtin Shenjt me rastin e një seminari tjetër për meshtarë. Në të vërtetë është e pabesueshme se sa ipeshkvij kanë pushuar në Shpirtin Shenjt.

Në fillim, kur, në kishë, posa ishte paraqitur përvoja karizmatike, disa ipeshkvij dhe meshtarë e kanë shtyrë mënjane, duke ndaluar aktivitetin e bashkësive të lutjes, gjegjësisht - në kuadër të tyre – lutjen në gjuhë, ose shtrirjen e duarve, e të ngjashme... Shumë prej tyre e kanë ndërruar mendimin pas deklaratës së përbashkët të ipeshkvijve të shtetit në vitin 1969., në të cilën thuhej se bashkësitë e lutjeve duhet të lejohen sepse i kanë frytet e mira.

Megjithatë ka të tillë që edhe më tutje nuk e pranojnë krejtësisht koncilin e Vatikanit. Duhet, ndoshta, 50 -100 vjet që ta pranojnë. Kështu, nuk mund të presim se pushimi në Shpirtin Shenjt – kjo dukuri e re – të jetë e pranuar menjëherë dhe tërësisht., por mendoj se ajo që po provoj të bëj me këtë libër, është për ta bërë këtë gjë të dukshme për ta krijuar mundësinë të shqyrtohet dhe të nxitet diskutimi.

Njëri prej komenteve kryesore që i dëgjoj me rastin e kryerjes së shërbesës sime, është ky: "Atë, ti je i pari që na e ke shpjeguar në mënyrë të hollësishme pushimin në Shpirtin Shenjt." Më kujtohet, madje, në vitin 1974 njerëzit në bashkësitë e lutjeve rrëzoheshin nën fuqinë e Shpirtit Shenjt derisa lavdëronin Zotërinë. Shumë vetë nuk e kanë kuptuar këtë, prandaj janë frikuar së tepërmi (Shiko pyetjen e anketës nr. 3) Mungesa e kuptimit ka shkaktuar pështjellim, keqkuptim dhe keqpërdorim. Është e nevojshme që kjo temë të hapet për diskutim. As nuk mund t'ia kthejmë shpinën dhe as ta mbrojmë.

Nuk e mohoj se ekzistojnë problemet pastorale. Mirëpo, mendoj se duhet gjetur zgjidhje për problemet pastorale, duke mos e rrethuar me ferra Shpirtin me atë rast. Gjoni në letrën e vet thotë: "*vini në provë shpirtat*" (1 Gjn. 4,1) Dhe kjo është pikërisht ajo që po provojmë ta bëjmë duke vërtetuar besueshmërinë e tyre, e pastaj anën praktike të tyre.

Disa prej komentuesve, të cilët kritikojnë pushimin në Shpirtin Shenjt – sipas asaj që unë di – as që e kanë përjetuar ndonjëherë këtë përvojë. Mendoj se nuk është në rregull që personi, i cili nuk ka përjetuar diçka aq personale sikurse që është pushimi në Shpirtin Shenjt, ta sulmojë këtë dukuri ekskluzivisht me argumente intelektuale. Kjo është e ngjashme sikur mashkulli të shkruante për gëzimin e lindjes së fëmijës. Asnjë mashkull nuk mund ta përshkruajë drejt gëzimin e shtatzënisë, sepse është fjala për përvojën subjektive të gruas.

Megjithatë, mund t'u jemi mirënjohës atyre që janë shprehur negativisht për këtë dukuri, sepse na kanë detyruar që të shikojmë pozitivisht në të, të ofrojmë arsyetimin e fesë sonë. Negativiteti me të cilin jam takuar, më ka shtyrë që më thellë dhe më me kujdes të shikoj në qëndrimin që kam unë personalisht dhe të tjerët, të cilët i janë kushtuar krejtësisht shërbesës së shërimit, për këtë temë të rëndësishme dhe të ndjeshme.

Jetojmë në një shoqëri të karakterizuar nga dhuna: Në televizion dhe në kinema paraqiten filma të dhunshëm, përplot me vrasje, dhunime, krisma armësh, therje me thika, etj. Pushimi në Shpirtin Shenjt, të themi kështu, është "dhunë e ëmbël" – fuqia e Shpirtit Shenjt që rrëzon. Megjithatë, disa njerëz reagojnë negativisht. Disa njerëz, që shikojnë vrasjet, dhunimet, sakatosjet dhe brutalitetin dhe i pranojnë ato përmbajtje; shqetësohen kur shohin se si njerëzit bien nën pushtetin e Shpirtit Shenjt. Kjo nuk ka kuptim. Thuhet se një amerikan mesatar deri në moshën e tij 18-vjeçare sheh njëqind mijë raste dhune në televizion. Një ungjillëzues i njohur protestant ka thënë: "Sot në televizion shikojmë gjëra, të cilat para dhjetë vitesh do të ishin të paimagjinueshme. Ngadalë dhe në mënyrë të pavërejtur po futemi në paganizëm."

Njerëzit tanë sot joshen nga kultet dhe sektet nga më të ndryshmet. Me mijëra katolikë futen në kulte të ndryshme fetare, si dhe në një varg të tërë lëvizjesh para psikologjike, si mjet për të përjetuar Zotin, gjetje të qenies së brendshme vetanake, gjetje të lumturisë. Deklarata e Vatikanit mbi sektet, kultet dhe lëvizjet e reja fetare në paragrafin 2.1.3 komenton kështu: "Si duket, sektet ofrojnë këto: përvojën e këndshme fetare, shpëtimin, kthimin, vendin për ndjenja, për spontanitet (p.sh. në ritet fetare)..." Fakti se këto kulte na i marrin njerëzit, për ne paraqet sfidë që t'i bëjmë vend përvojës së kënaqshme fetare brenda kishës katolike.

E kemi Zotin, i cili dëshiron që ta ndiejmë natyrën e tij të karakterizuar nga dashuria. Ai është po ashtu Zoti që dëshiron të befasojë, i cili nganjëherë na thërret në jetën me rreze.

Para disa vitesh, në konventën nacionale karizmatike të mbajtur në universitetin Notre Dame, Ralph Martin ka komentuar se si ne, në Ripërtëritje, duhet të kemi kujdes të mos jemi "tepër të ngurtë". Ka thënë se Ripërtëritja ka funksion profetik. Na thërret të ndryshojmë, të shkojmë drejt rritjes.

Kudo që shkoj, dëgjoj meshtarët të thonë: "Kemi nevojë për diçka... njerëzit janë të uritur... njerëzit kërkojnë." Janë të ballafaquar me nevojën dhe me ndjenjën e paaftësisë që ta realizojnë ndryshimin.

Në një artikull të revistës New Covenant, ati James Hughes flet për nevojën e një formimi shpirtëror të rinjve të famullisë së tij, si dhe për mënyrën se si Zoti e ka plotësuar atë nevojë.

"...kam filluar me grupin e vogël të rinjve, të cilët kanë pranuar të shkojnë në seminar. Gjatë kohës së shërbesës së pendimit, prania e Zotit u bë aq e fuqishme sa që gati të gjithë të rinjtë ishin të vërshuar nga Shpirti Shenjt. Pranuan thirrjen për kthim të thellë kah Zoti. Shumë prej tyre e përjetuan pagëzimin me Shpirt Shenjt dhe filluan të flasin në gjuhë... të jem i sigurtë, kur i futëm disa ndryshime, u paraqitën edhe disa probleme..., por nuk u ndalëm. Së shpejti ndesha në një sfidë të pabesueshme – me një grup të madh kandidatësh për krezmimin e shenjtë, afër njëqind të rinjsh. Nxora tekstet dhe fillova seminarin, duke u mbështetur në udhëheqjen e Shpirtit Shenjt, se nuk do të më lejojë të rrëshqas nga rruga. Kandidatët për përforsimin e shenjtë këtë e pranuan mirë... posa vendosëm të mos shkojmë "në të sigurt" me atë që kishim, Zoti u përgjigj menjëherë..."

"Bërthama e programit paraqet kthimin kah Zoti. I theksoj dhuratat karizmatike dhe pagëzimin me Shpirtin Shenjt, sepse ato sjellin deri tek kthimi kah Zoti – ndryshimi i zemrës dhe mendjes. Atyre fëmijëve u duhet Jezusi! Përvoja karizmatike e bën dashurinë dhe fuqinë e tij të dukshme... Ku është fshehtësia e ndryshimit? Zotëria është Ai që e merr punën në duar të veta. Zemrat e rinjve ndërrohen, kur të gjithë tërhiqemi dhe i lejojmë Atij të veprojë."

Nevoja e kthimit kah Zoti është reale në mënyrë të barabartë, si për tetëdhjetëvjeçarin si për tetëvjeçarin. Kthim do të thotë ndryshim, e ndryshimi është jo rrallë me rrezik, frikësues dhe nga pak i "pakëndshëm".

Në të gjitha rastet e paraqitura në këtë libër, do të shohim se si në zemrat e njerëzve ujitet fara e kthimit kah Zoti. Secili tregim është shembull i dorëzimit dhe veprimit të Shpirtit Shenjt.

Në Enciklikën e vet mbi ungjillëzimin në botën bashkëkohore, papa Pali i VI thotë (n. 75):

"Kisha po rritet 'në ngushëllimin e Shpirtit Shenjt'. Shpirti Shenjt është shpirti i Kishës. Ai ua shpjegon besimtarëve kuptimin e thellë të mësimin dhe dërgimit të Jezusit. Shpirti Shenjt është ai i cili, sot, si edhe në fillimin e Kishës – vepron në secilin ungjillëzues që lejon të mbushet dhe të udhëhiqet me Të."

Ati Mathew Linn ka paraqitur me një rast vërejtjen interesante sipas të cilës ekzistojnë dy dukje të pushimit në Shpirtin Shenjt "para ungjillëzues" dhe "pas ungjillëzues". Tek jo të krishterët dhe tek të krishterët indiferentë, të cilët nuk janë shumë të dhënë pas Zotit, "pushimi" shpesh i hap zemrat e tyre për dëgjimin e fjalës së Zotit. Dukja pas-ungjillëzuese ka të bëjë me ata që e kanë pranuar Zotin dhe sjellin fryte. Pushimi i fut edhe më thellë në lutje, duke rritur po ashtu edhe dhuratën e shqyrtimit. Nevoja për kthim kah Zoti është e vazhdueshme për të gjithë ne.

Disa karizmatikë katolikë në vitin 1967. në universitetin Duquesne, kanë lejuar që t'i përfshijë dhe t'i udhëheqë Shpirti Shenjt. Pasi kanë pranuar pagëzimin me Shpirtin Shenjt dhe kanë filluar të luten në gjuhë, kanë rrezikuar prestigjin e tyre, në mënyrë që t'ia paraqesin

tregimin e tyre të veçantë kishës, e cila nuk e ka pranuar dhuratën e lutjes në gjuhë. Shpirti i Zotit, kur jep dhurata "dramatike", gjithsesi tërheq vërejtjen e katolikëve të nxehtë edhe të atyre të ftohtë. Duket se si besimtarët ashtu edhe jobesimtarët i josh me një lloj dashurie të re.

Definicioni

Ndoshta do të ishte mirë të fillojmë me gjërat më elementare dhe, para së gjithash, të definohet 'përvoja fetare'. E, për ata lexues, për të cilët edhe vetë nocioni i pushimit në Shpirtin Shenjt është i ri, do të japim disa definicione të asaj përvoje nga këndvështrime të ndryshme. Pastaj do të kthehemi tek dallimi në mes të pushimit "spontan" dhe "ndërmjetësues".

PËRVOJA FETARE: "Ndjenja dhe niveli i vetëdijes për Zotit që nxisin reagim spontan. Shpesh përcillet me ndonjë njohje, frymëzim, vizion ose kthim kah Zoti.

PUSHIMI NË SHPIRTIN SHENJT: Përvoja e rrëzimit në dysheme gjatë lutjes nganjëherë quhet "Vërshimi me Shpirtin Shenjt", "Rrëzimi nën Pushtetin e Shpirtit Shenjt", "Pushim", ose thjesht "Bekim". Për deri sa unë personalisht më së shumti e quaj "Pushim në Shpirtin Shenjt", ekzistojnë edhe shprehje të tjera, të cilat shfrytëzohen.

Si duket, nuk ekziston një përshkrim i thjeshtë, i cili do të paraqiste tërësinë e asaj përvoje. Në librin tim *Shërbesa e shërimit*, kam shkruar si në vazhdim:

"Si duket, derisa pushoj në Shpirtin Shenjt, funksionet fizike dhe psikologjike janë të ngadalësuara, ndërsa ndjesia shpirtërore është e rritur në takim me Zotin..."

Në definicionet që vazhdojnë, vërejmë një pajtim mes lëshimit, dorëzimit, ekspozimit, ose qetësimi të aktivitetit të ndjenjave dhe trupit fizik, në mënyrë që Zoti të mund t'i zbulohet natyrës sonë të brendshme.

Në librin e tij *Fuqia e shërimit*, Francis MacNutt thotë: "Aq sa shoh unë, është fjala për fuqinë e Shpirtit, e cila e mbush personin, me vetëdije të lartë e të brendshme, deri në atë masë sa që forcat e trupit tërhiqen për aq kohë sa personi s'mund të qëndrojë më në këmbë."

Ati George Montague në revistën *Catholic Charismatic* thotë: "...ju vërshon ndjenjë e thellë e kënaqësisë, e cila personin për një çast e liron deri në atë shkallë, kur ai e dorëzon mbikëqyrjen e sistemit motorik qendror dhe lëshohet, apo bie poshtë.

Ati Ralph DiOrion komenton: "... është pjesë e dhuratës së shërimit, takim i drejtpërdrejtë i qenies sonë më të thellë me plotësinë e dashurisë dhe paqes së Zotit."

Keneth Hagin në librin *Përse njerëzit i gjuhëzohen fuqisë?*, shkruan: "Kur e natyrshmja takohet me të mbinatyrshmen, njëra prej të dyjave duhet të dorëzohet."

Morton Kesley në veprën *Dallimi* komenton: "... zakonisht përshkruajnë ndjenjën e fuqisë së shenjtë ose energjisë, e cila derdhet në ta dhe bën të lëshohen dhe rrëzohen ..."

Më pëlqen po ashtu edhe përshkrimi që e ka dhënë një pediatër: "Si duket, është fjala për manifestimin e jashtëm të dorëzimit të qenies së brendshme Zotit."

Ati Ted Dobson më shumë dëshiron të ndajë plotësisht aktin e rrëzimit nga vlerësimi i shkakut të rrëzimit dhe për këtë dukuri flet thjesht si për "fenomenin e rrëzimit. Duke folur për përshkrimet e shumta dhe të ndryshme, ai thotë: "... këta emra po na fusin ngadalë në atë që vërtet po ndodh ... ne do ta quajmë atë 'fenomeni i rrëzimit' jo vetëm sepse rrëzimi në dysheme është i përbashkët për të gjitha format e kësaj përvoje, por edhe sepse ai është koncept neutral, i cili nuk paragjykon shkakun e vetë përvojës".

Ati Thomas Keating në librin *Mendja e hapur, zemra e hapur* thotë: "ndjeni 'shuarjen e ngadalshme' të punës së ndjenjave dhe ngadalë rrëshqisni kah dyshemeja. Nëse njerëzit kurrë

më parë nuk e kanë shijuar atë lloj lutjeje, lëshohen me kënaqësi të madhe dhe mbesin në dysheme sa më gjatë që munden.”

Analogjia me të cilën shërbehem, nganjëherë është ajo e të qëndruarit i shtrirë nën rrezet e diellit. Njerëzit thjesht shtrihen dhe lejojnë që ai t'i rrezitë dhe relaksojë. Pushimi në Shpirtin Shenjt është lejimi i diellit të Shpirtit Shenjt brenda qenies sonë. Derisa njerëzit pushojnë, në një numër të madh rastesh, kanë takim të drejtpërdrejtë me Zotin. Zotëria me atë rast bën shërimin e madh. Ata e ndiejnë dashurinë e Tij, kanë përvojën e bisedës me Të, prandaj në mënyrë të thjeshtë lëshohen në praninë e Tij.

Monsinjor Vincent Walsh për përvojën flet si për “pushimin”, që është fjalë, e cila na kujton gjumin dhe tërheq paralele me ekstazën për të cilën shkruajnë shenjtërit., por nuk është fjala për gjumë. Personi që pushon në Shpirtin Shenjt, është i vetëdijshëm për njerëzit përreth vetes dhe për aktivitetet e tyre, prandaj kjo përvojë dallon nga gjumi. Dëgjojnë se çka flitet rreth tyre, por ajo nuk u intereson fare. Duket se të gjitha forcat e tyre janë të orientuara te Zotëria. Është e ngjashme me preokupimin me programin televiziv në dhomën e zhurmshme me plot njerëz. Personi është i orientuar drejtpërdrejt te televizioni dhe në njëfarë mënyre i “shkyçur” nga ajo që njerëzit bëjnë përreth tij. Duke pushuar në Shpirtin Shenjt, personi është në mënyrë intensive i orientuar te Zotëria.

PUSHIMI SPONTAN DHE PUSHIMI “NDËRMJETËSUES”: Edhe një definicion që do të mund të ishte i dobishëm, është ai, i cili bën dallimin në mes të pushimit “spontan” dhe atij “ndërmjetësues”.

Pushimi spontan: rrëzimi nën pushtetin e Shpirtit Shenjt pa ndërmjetësues, ashtu sikurse që ndodh me rastin e takimeve të lutjes, ose në lutje individuale.

Pushimin ndërmjetësues (mund të quhet edhe pushimi me bashkëpunim ose pushimi i “nxitur”): pushim, i cili ndodh si rezultat i lutjes që t'i mënjanohej pengesat Shpirtit Shenjt, ose muzika, ose mësimi, ose akti trupor i ngritjes së dorës si shenjë e dorëzimit, ose shprehja e dëshirës për pushim, pasi njerëzit pranojnë vajimin me rastin e shërbesës së shërimit ose të takimit të lutjes, pas të cilit ndodh vet pushimi në Shpirtin Shenjt.

"Po e kujtojmë, o Hyj, mëshirën tënde Në mesin e Tempullit tënd. "
(Ps 48,10).

Dëshmi

“21 cigare...”

motra Linda Koontz rrëfen një tregim të veçantë

“Christen e kam njohur kur i kishte afërsisht 71 vjet. Daja i saj e kishte sjellë në Amerikë nga Kopenhaga e Danimarkës, kur ka qenë në të njëzetat e hershme. Ai kishte vdekur në tren duke e lënë krejtësisht vetëm. Qëndroi në Amerikë duke kaluar një jetë mesatarisht fatkeqe. Në martesë nuk ishte e lumtur, kështu që duroi dhe vuajti shumë. Për shkak të vetmisë së saj dhe mungesës së miqve, pasi nuk mundi të kthehej në atdhe, u bë alkooliste. Christa ishte grua e braktisur, e vetmuar dhe e ngatërruar.

“Një motër nga kuvendi im u shoqërua me të, por nuk mundi t'u qëndrojë kërkesave të saj. Një natë rreth orës një Christa e thirri atë motër në kuvend. Ishte shumë keq dhe i duhej ndihma menjëherë. Motra, për të cilën është fjala, ndihej shumë e lodhur dhe më luti që unë ta vizitoja. Shkova dhe e gjeta të ulur pranë tavolinës me revole të mbushur dhe me shishen e uiskit të zbrazët. Ishte e dehur dhe aq thellë e dëshpëruar sa që i dukej se nuk mund të duronte jetën më. Zgjedhja e saj për dëshpërimin dhe ankthin ishte të bëjë vetëvrasje.

Nuk dija se ç'të bëja dhe thirra një infermiere nga bashkësia ime e lutjes. Ajo vërtet erdhi, por as vetë nuk dinte se ç'të ndërmerre. E çova Christen në dhomën e fjetjes dhe u ula në shtratin e saj. E pashë se nuk kishte kuptim të bisedoja me të, prandaj në zemër e pyeta Zotërinë se çka duhet të bëj. Pastaj u frymëzova se duhet të lutem për të. Në atë kohë nuk kam pasur përvojë në lutjen për të tjerët dhe nuk dija se si të filloj. E dëgjoja veten se si e lutja Jezusin për ndihmë. Kur e thashë këtë me zë, Christa u rrëzua në shtrat sikur t'i binte të fikët. Motra medicinale mendoi se është fjala për atak në zemër. Në atë kohë kam ditur fare pak për pushimin në Shpirtin Shenjt. Asnjëherë nuk kisha marrë pjesë në diçka të tillë. Por, dukej se Christa po flinte e qetë, prandaj vendosa të mos e pengoj. E kalova natën me të.

Kur u zgjua të nesërmen, Christa ishte e zhdehur fare dhe plot gëzim. Tha: 'Ndjehem shkëlqyeshëm. E di se Zoti më do.' Derisa flinte, e kishte vizituar Jezusi. U luta me të që jetën e saj t'ia dorëzojë t'ia Jezu Krishtit. U mbush me Shpirtin Shenjt dhe filloi të flasë në gjuhë. Gjatë javës së njëjtë filluam të studiojmë Biblën së bashku. U bë krejtësisht person tjetër.

"Ditën e parë pas pushimit më tha 'sot nuk po më shkon cigarja'. Harxhonte 21 cigare në ditë. Christa u shërua nga alkooli dhe duhani. Qysh në rini ishte pronare e fabrikës së duhanit në Kopenhagë. Ashtu ishte mësuar në duhan.

"Derisa më parë ishte e papërshtatshme me njerëzit dhe shumë agresive, tani përnjëherë u bë e njohur me natyrën e saj të butë. Filloi të shkojë në bashkësitë e lutjes dhe u shoqërua me shumë njerëz. Pas disa kohësh filloi të japë dëshminë e vet në grupet e lutjes. U pagëzua dhe mori Kungimin e Parë dhe shumë njerëzve u dëshmonte dashurinë e Zotit dhe forcën e Tij.

Disa vjet pas kthimit kah Zoti, u zbulua se kishte kancerin. Me qetësi dhe duresë e barti vuajtjen e vet dhe nxiti të tjerët të shpresojnë në Zotin, ashtu si bënte edhe vetë. Shoqja ime ishte afër saj kur vdiq. Edhe pse mendohej se ishte në komë, Krista, me një buzëqeshje të lehtë, u çua në qëndrimin ulur dhe i shtriu duart sikur të përqafonte dikë.

Në arkivol dukej si grua e re; të gjitha ato vite vuajtjeje dhe gjurmët e kancerit e kishin braktisur trupin e saj. Njerëzit nuk pushonin së komentuari bukurinë e fytyrës së saj.

"Në vend se ditët e saj t'i kalonte në pikëllim dhe depresion, lexonte Shkrimin Shenjt, merrte sakramentet dhe lutej për njerëzit që vuanin. Veçanërisht lutej për punën time të ungjillëzimit. Christa në jetën time ishte dhuratë e madhe. Mund të them se Zoti e ka bërë këtë kthim të mrekullueshëm dhe këtë hir nëpërmjet përvojes së saj të pushimit në Shpirtin Shenjt.

"Valët e mëshirës..."

tregimi i Billy-t

"Nuk e kam pasur lehtë të pushoj në Shpirtin Shenjt, sepse dyshoja në vërtetësinë e asaj dukurie. Por, ja se si Zotëria më bëri që më në fund të besoj. E shihja atin DeGrandis dhe e kisha vështirë që gjithë atë ta pranoja: shërimin, këndimin, madje edhe lavdërimin. Afërsisht një vit më vonë, pas disa takime lutjesh dhe pasi edhe vetë disa herë e pranova lutjen, një mik i mirë më çoi ta dëgjoja ligjëratën e motrës së atit DeGrandis, Dorothe-së. Jo shumë kohë pas kësaj, i njëjti shok, më bindi që përsëri të shkoja ta dëgjoja atin DeGrandis. Më duhet të pranoj se akoma kisha disa dyshime. Ishte festa e Zonjës së Bekuar, prandaj e luta për ndërmjetësimin e Saj. Afërsisht nja dhjetë vetë prej grupit të lutjes shkuam në takim në pas ditës. Pas ligjëratës, ati DeGrandis tha të dalin përpara ata që dëshirojnë të pranojnë vajimin. Njerëzit filluan të rrëzohen njëri pas tjetrit. Kur ati u lut për personin afër meje, u përkul kah unë dhe e takoi gishtin tim të vogël, i cili ishte i ngritur lart. Në të njëjtin çast e ndjeva se 'shkova'. Mendova: 'A është kjo ajo? Dhe ishte!

"Derisa qëndroja i shtrirë dhe pushoja, ndieja se si prej kokës deri tek thembrat më kaplonin valët e mëshirës. Grupi filloi të këndojë këngën për Marinë (që e vërtetoi ndërmjetësimin e saj). Ndjehesha mrekullueshëm! Kur u ngrita, të gjithë shokët e mi thanë, 'Shikoje Billy-n, vërtet e ka 'goditur'!' Supozoj se kam rrezatuar. Ajo që vërtet më ka bindur në vërtetësinë e kësaj

përvoje, ishte lirimi nga çdo frikë. Vendin e saj e zuri njohja e vonuar e pranisë së Zotit në të gjitha rastet tjera kur kam pranuar shërimin.”

Kur ua kam nxjerrë këta dhëmbë?

tregimi i Barbares

“Një ditë pasi i nxora dy dhëmbë, shoqja ime Muriel më ftoi në Meshën e veçantë të mbrëmjes të atit DeGrandis. Muriel më kishte folur diçka për të, por kurrë më parë nuk kisha qenë në Meshën e shërimit dhe as që dija gjë për Ripërtëritjen Shpirtërore. Kurrë nuk kisha dëgjuar për pushimin në Shpirtin Shenjt, e lëre më të marr pjesë në të. Kur Mesha përfundoi, shkova me Muriel dhe atin DeGrandis kah fundi i kishës, duke kujtuar se po shkojnë. Mirëpo, ata u ndalën përnjëherë dhe u kthyen kah unë. Muriel tha: ‘Barbara, nëse dëshiron që Shpirti Shenjt të hyjë në jetën tënde, ngriti duart dhe thirrë të hyjë.’ Pas përgjegjës sime afirmative, ati DeGrandis ma leu ballin dhe filloi të lutet për mua. Në të njëjtin çast prej kokës deri te thembrat më kaploi ngrohtësi e pabesueshme e mbushur me dashuri. Edhe pse sytë i kisha të mbyllur, më dukej se isha e rrethuar me dritë shkëlqyese. Për një kohë nuk isha e vetëdijshme për askënd dhe për asgjë rreth vetes. Kur u vetëdijesova për zërat, nuk doja edhe për pak që t’i hapja sytë, sepse ndihesha aq mrekullueshëm në atë ngrohtësi dhe dritë. Kur i hapa sytë, pashë njerëzit e shtrirë përgjatë anijes anësore të kishës. Ishte hera e parë që kisha kuptuar në të vërtetë se si edhe vetë jam e shtrirë në dysheme!

“Disa ditë më vonë, përsëri shkova te dentisti për ta hequr perin. Kur ma shikoi gojën, e afroi dritën dhe shikoi më mirë. I habitur shikonte nofullën time. Në fund më pyeti, ‘Kur ua kam nxjerrë këta dhëmbë?’ ‘Para katër ditësh.’ u përgjigja. ‘Kjo është e pabesueshme. Është shëruar sikur t’i kisha nxjerrë para dy ose tre vitësh!’ “

ANKETA

(të dhëna statistikore të anketës)

Dyqind persona (148 femra dhe 52 meshkuj) janë pyetur mbi pushimin në Shpirtin Shenjt në seminarët e ndryshëm në mbarë shtetin. Shumica e tyre ka pasur përvojën e pushimit në Shpirtin Shenjt në mes 3 dhe 20 herë. 73 janë në Ripërtëritje prej 3-7 vjet; 42 janë në Ripërtëritje 7-10 vjet, derisa 50 vetë janë “veteranë” me më se 10 vjet përvojë në ripërtëritje. Përgjigjet në pyetje fillojnë këtu dhe sillen në fund të secilit nga pesë kapitujt e ardhshëm. Si do të përgjigjeshit ju në këto pyetje?

1. A i ka paraprirë përvojës së pushimit në Shpirtin Shenjt ndonjë shpjegim?

Po	62%
Jo	31%
Pa përgjigje	7%

2. A është shpjeguar pushimi në Shpirtin Shenjt si përvojë e dëshirueshme?

Po	62%
Jo	36%
Pa përgjigje	2%

3. A jeni frikësuar kur keni pushuar në Shpirtin Shenjt për herë të parë?

Po	25%
----	-----

Jo	72%
Pa përgjigje	3%

(marrë në përgjithësi, meshkujt kanë treguar më pak frikë se femrat: 18 meshkuj ndaj 28 femra.)

4. A i jeni çuditur përvojës suaj të parë të tillë?

Po	69%
Jo	28%
Pa përgjigje	3%

(përgjigjet e femrave shprehin një nivel më të lartë befasi në krahasim me ato të meshkujve: 71 meshkuj ndaj 63 femra)

...vazhdon

Pasqyrë e pikave kyçe

- * Përvoja e sotme e rrëzimit në dysheme gjatë lutjes zakonisht quhet "pushimi në Shpirtin Shenjt".
- * Pushimi mund të ndodhë spontanisht ose me ndërmjetësim.
- * Pushimi është karizëm, të cilën mund ta ketë udhëheqësi i lëvizjes karizmatike, si edhe pranuesi i lutjes.
- * Pushimi zakonisht konsiderohet pjesë e shërbesës së shërimit.
- * Gjatë lutjes, duket se ndodh mbushja me fuqi, për shkak të së cilës energjia trupore dobësohet.
- * Ndjenjat e dashurisë, brengës dhe kujdesit të Zotërisë, janë vlera të cilat zakonisht lidhen me pushimin në Shpirtin Shenjt.
- * Katolikët zakonisht i dëshirojnë përvojat kualitative të fesë.
- * Pasi pushimi në Shpirtin Shenjt për shumicën e katolikëve është përvojë e re dhe kundërthënëse, është e nevojshme të hapet për shqyrtim teologjik dhe pastoral.
- * Të gjithë jemi të thirrur në kthim të vazhdueshëm.
- * Nganjëherë Zoti shërbehet me mënyra befasuese që njeriut t'ia tërheqë vëmendjen.

Lutja

Atë Qiellor, më tërhiq më afër Vetes dhe hapi veshët e mi që të kem munsësi të dëgjoj se çka ke për të thënë për pushimin në Shpirtin Shenjt. Më dhuro shpirtin e gatshëm për të mësuar, mendjen e hapur, urtinë dhe shqyrtimin.

Atë, dëshiroj të rrezitem në diellin e dashurisë Sate dhe të lejoj të okuposh krejt vëmendjen time. Bën të ndiej kthimin e përhershëm dhe përparimin e rritjen shpirtërore personale. Largo prej meje çdo varësi, ashtu si ke bërë me Christe-n. Nëse është natyra ime luftarake, ndryshoje, bëje të butë. Ma kthe shëndetin trupor, ashtu si ke bërë me Barbar-en. Dhe më ndihmo ashtu si atit James Huges, që t'i braktis "lojërat e sigurta", në mënyrë që ta bëj të pranishme në botë Dashurinë dhe Forcën Tënde. Të falem nderit, Atë Qiellor, në emër të Jezusit. Amen.

"E Zoti do të të prijë gjithmonë, do të të ngijë në vende të thata...do të jesh porsì kopsht i ujitur..."

(Is 58,11)

2. Më mballon kullotave të gjelbra

*"Ejani ta adhurojmë, të biem përmbys para tij,
të biem në gjunjë para Zotit, që na krijoi!
Sepse ai është Hyji ynë,
ne jemi popull i kullosës së tij,
grigja që ai ruan.*

(Ps 95,6-7)

Themelet biblike

Sa më shpesh që takohemi me fenomenin e pushimit në Shpirtin Shenjt, njëra prej pyetjeve të para që paraqitet, është se ku mund ta gjejmë në Shkrime. A ekzistojnë paralele biblike ose ngjashmëri? Morton Kesley thotë kështu:

Si duket, në kohën biblike nuk ka pasur asgjë që do të mund të krahasohej me atë që ndodh sot në shërbesat tona, kur njerëzit i afrohen altarit dhe, kur mbi ta shtrihen duart, rrëzohen në dysheme. Në anën tjetër, edhe në Besëlidhjen e Vjetër dhe të Re ka shumë shembuj kur njerëzit janë rrëzuar para Zotërisë dhe është dukur se i rrëzon Shpirti i Tij."

Ekzistojnë pjesë në Shkrime që përshkruajnë rrëzimin në praninë e Zotit, me qëllim ose pa qëllim, në rrethana pozitive ose negative.

I. Rënie të vullnetshme

A. Në shenjë falënderimi. Përkulje para Zotit në lavdërim dhe falënderim. Shembull gjejmë në Ungjillin e Lukës 17,15-16, tek shërimi i të gërbulurve. *"Njëri prej tyre, si pa se u shërua, u kthye duke e lëvduar Hyun me zë të madh. Ra përmbys para këmbëve të Jezusit dhe ju falënderua."*

B. Në lutje të thellë. *"Për këtë arsye i përkuli gjunjët e mi para Atit, prej të Cilit merr emrin e vet çdo atëri në qiell e mbi tokë, të denjohet, në saj të begatisë së Lavdisë së vet, t'ju forcojë më anë të Shpirtit të vet në fuqi për të mirën e njeriut të brendshëm..."* (Ef 3,14-16).

Po ashtu në Ungjillin sipas Mateut 26,39 Urata në Gjetseman *"Pastaj u largua pakëz, ra me fytyrë për dhe e lutej: 'Ati im, nëse është e mundur, largoje prej meje këtë kelk mundimesh! Megjithatë, le të bëhet, jo si dua unë, por si do ti.'"*

II. Rënie pa qëllim

A. Konflikt shpirtëror

"...- e ishte pika e mesditës - kur, qe, o mbret, shoh se po vjen prej qiellit një dritë më e shndritshme se dielli – më mbuloi me dritë mua dhe bashkudhëtarët e mi. Të gjithë ramë përtokë e unë dëgjova një zë që më tha hebraisht: 'Saul, Saul, pse po më salvon?'" (Vap 26,13-14)

Jer. 46,15: "Pse u rrëzua i forti yt? S'mundi të qëndrojë në këmbë, sepse Zotynë e flaku përdhe!"

Kur e kapën Jezusin, Juda i solli ushtarët në Gjetseman. Gjn 18,4-6: "Jezusi që e dinte mirë se çka kishte për t'i ndodhur, u doli para dhe u tha: 'Kë kërkon?' 'Jezu Nazarenin!' i përgjigjën ata. 'Unë jam!' - u tha Jezusi. Me ta ishte Juda që po e tradhtonte. Kur, pra, Jezusi u tha : 'Unë jam!', ata u zbrapsën dhe ranë për dhe."

B. Vërshimi me praninë e Tij në një lloj ekstaze.

Në Besëlidhjen e Vjetër, me rastin e kushtimit të tempullit të Salomonit.

2 Kro. 5,13-14: "kështu, pra, ndërsa të gjithë së bashku e me bori e me zë e me cimbele e me vegla të ndryshme muzikore, duke u rënë e duke e lartësuar njëherësh zërin, ia filluan me një zë ta lavdërojnë Zotin e thanë: 'Lëvdojeni Zotin sepse është i mirë, sepse e amshueshme është dashuria e tij, shtëpia e Hyjit u mbush me re dhe priftërinjtë për shkak të resë nuk mundën të vijoje shërbesën: Lavdia e Zotit e mbushi shtëpinë e Hyjit!"

Dan. 10,8-9: "Unë mbeta vetëm dhe po e vrojtoja këtë pamje të madhërueshme. Pikë fuqie s'më mbeti, deri edhe fytyra mu zbeh, u shëmtova e mbeta pa fuqi fare. E dëgjova zërin e fjalëve të tija. Duke dëgjuar zërin e fjalëve të tija u paka e rashë me fytyrë përdhe."

Ez. 1.28: "E tillë mu paraqit duka e lavdisë së Zotit. E pashë e rashë me fytyrë përdhe dhe dëgjova një zë që më fliste."

Ez. 43,3: "Unë atëherë pata një vegim të ngjashëm me vegimin që pata kur erdhi për të shkatërruar qytetin, vegimi ishte sipas dukjes së vegimit që e pata në brigjet e lumit Kobar. Atëherë rashë me fytyrë përdhe."

Gjoni në Patmos ka hyrë në ekstatë, kur pa: "dikend si birin e njeriut (...) Kur e pashë, rashë para këmbëve të tija pors i vdekur (...) Zb 1,17

Kur Zoti e rrëzon njeriun përmbys (ose në shpinë), përse e bën këtë? Ati John Hampsch, CFM, jep disa arsye të mundshme:

"Tek Pjetri (Vap 10,10) dhe Pali (Vap 9,4), ka qenë qëllimi të sigurohet se personi, të cilit i shfaqet të ketë përshtypjen e ndërhyrjes së Zotit. Tek Danieli (Dan 10,8-9) qëllimi ishte që ta bind në vërtetësinë e vizionit dhe të profecisë ...në Patmos Gjoni ka qenë i rrëzuar kur ka pranuar zbuluesën të cilën është dashur që ta shndërrojë në tërë librin e Zbuluesës (1,17). Për sa u përket ushtarëve tek varri (Mt 28,4), Zoti e ka treguar forcën e vet të pathyeshme.

"Zoti mund të bëjë që edhe miqtë edhe armiqtë e Tij të bien për tokë dhe qëllimi është i ndryshëm në secilin rast. Në një rast tregon se forca njerëzore s'mund ta mbizotërojë forcën e Zotit e në rastin tjetër – kur është fjala për miqtë – fuqia e Zotit e rrit forcën ose talentet e njeriut. Qëllimi kryesor i kësaj dukurie është të bëjë ta dukshme forcën hyjnore, ashtu si shkruan në Veprat e Apostujve 1,8: 'Por ju do të merrni fuqinë e Shpirtit Shenjt, i cili do të zbresë në ju (...).' Fuqia mund të kuptohet si mundje nga ana e Zotit ashtu si ishin ushtarët të mundur nga prania e Jezusit dhe u rrëzuan në Shpirtin Shenjt kur donin të kapnin.' (Gjn 18,6). Në të tjera

raste fuqia kuptohet si dukje e natyrës dhe mirësisë së Zotit, sikurse nëpërmes të shërimit të brendshëm, pranimit të paqes së brendshme etj.”

"Jezusi u afrua e u tha: "Më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë!" (Mt 28,18)

Tregimi për Shën Augustinin dhe për disa shenjtër të tjerë

Ati John Hampsch ka gjetur një rast interesant që e ka sjellë Shën Augustini në *Shtetin e Zotit*: "Jetonin një herë shtatë vëllezër dhe tri motra në Cezarenë e Kapadokisë, të cilët i kishte mallkuar e ëma që kishte mbetur e vejë, jo shumë kohë më parë, për shkak të një të keqeje që ia kishin bërë. Ajo ua kishte zënë shumë për të madhe, e ata i kishte gjetur dënim i tmerrshëm prej qiellit dhe të gjithëve kishin filluar t'u dridhen gjymtyrët. Pasi në atë gjendje nuk kishin mundur të takohen me bashkëqytetarët e vet, bridhnin gati nëpër mbarë botën romake, secili në drejtimin e vet. Dy prej tyre kishin ardhur në Hipon: vëllai dhe motra, me emrat Pali dhe Paladia, të njohur në shumë vende për fatkeqësinë e tyre.

"Kishin arritur pesëmbëdhjetë ditë para Pashkëve. Çdo ditë vinin në kishë sidomos te reliktet e Shën Shtjefnit, duke u lutur që hidhërimi i Zotit të zbutet dhe t'iu kthehet shëndeti. Kudo që shkonin – pra edhe këtu – tërhiqnin vëmendjen e të gjithëve. Ata që i kishin parë më herët dhe kishin qenë të njoftuar për shkaqet e ndodhisë së tyre, u tregonin të tjerëve, kur u jepej rasti për këtë. Erdhën Pashkët. Në atë Ditë të Zotit, në praninë e një numri të madh njerëzish, djaloshi mbahej për gardhin pas të cilit ruheshin reliktet dhe në lutje e sipër, përnjëherë, u rrëzua dhe u shtri sikur flinte, por duke mos u dridhur më – që përndryshe nuk pushonte as në gjumë. Të gjithë të pranishmit mbetën të habitur. Disa edhe u frikuan tepër, e disave u dhimbsej. Derisa disa donin ta ngrinin, të tjerët i pengonin, duke thënë se është më mirë të presin dhe të shohin rezultatin. Dhe ja! U ngrit dhe nuk dridhej më, sepse ishte shëruar dhe qëndronte në këmbë duke shikuar të pranishmit që nuk ia ndanin sytë.

Kush do të përmbahej atëherë për të mos e lavdëruar Zotin? Mbarë kisha ishte e mbushur me zërat e atyre që klithnin dhe uronin. Vrapuan deri tek unë, që isha ulur dhe prisja çdo moment të hyja në kishë. Vinin njëri pas tjetrit dhe secili përsëriste lajmin që tanimë e kisha dëgjuar. Derisa gëzohesha dhe në vete falënderoja Zotin, hyri edhe vetë ai djalosh, me shumë të tjerë, u hodh te gjunjët e mi, e pastaj u ngrit të pranojë puthjen time. Pastaj dolëm të gjithë së bashku: kisha ishte përplot dhe ushtonte nga klithjet: 'Faleminderit Zotërisë! Lavdia Zotërisë! Nga të gjitha anën ngriheshin klithjet 'E kam shëruar popullin tim' dhe përsëri dhe përsëri. Kur më në fund mbretëroi qetësia, vazhduan leximet e Shkrimit Shenjt. Dhe, kur fillova të predikoj i paraqita disa vërejtje që shkonin me situatën e gëzimit dhe lumturisë, duke mos dëshiruar të më dëgjojnë, por të shqyrtojnë një vepër aq të madhe të Zotit.

"Djaloshi hëngri darkë me ne dhe na rrëfeu tregimin fatkeq të familjes së tij. I premtova se të nesërmen, pas predikimit, popullit të tubuar do t'ia lexoj ato që tha. Kur e bëra këtë, të tretën ditë të Pashkëve, i thirra vëllanë dhe motrën të qëndrojnë në shkallë të ngritura pak, prej të cilave zakonisht flisja. Unë lexova derisa ata qëndronin atje. Të gjithë patën mundësi ta shohin djaloshin se si qëndron krejt i qetë derisa të gjitha gjymtyrët e motrës së tij dridheshin akoma. Ata, të cilët më parë nuk e kishin parë djaloshin, mund të shihnin në motrën e tij se çka ka hequr nga ai mëshira e Zotit. Në te shihnin nevojën e urimit e në motrën e tij nevojën e lutjes.

"Në ndërkohë, i drejtova të largohen nga shikimet e njerëzve. Atëherë fillova ta shqyrtoj ngjarjen pak më me kujdes, kur ja! Nga varri i martirit u dëgjuan zëra të ri, urime të reja! Të gjithë të pranishmit u kthyen, derisa unë vetë vrapova te varri. Motra, prej shkallëve ku pat

qëndruar, ishte drejtuar kah varri për t'u lutur te reliktet e shenjta. Posa e kishte prekur gardhin, në të njëjtën mënyrë si edhe i vëllai, ishte rrëzuar – si të flinte – dhe ishte ngritur e shëruar. Dhe derisa pyetnim se çka ka ndodhur dhe çka e nxiti atë zhurmë të gëzueshme, hynë në bazilikën në të cilën gjendeshim edhe ne: dhe derisa me vajzën largoheshin nga varri i martirit, ajo tani ishte me shëndet të përsosur. Kjo nxiti britma gëzimi dhe dukej se klithjeve dhe lotëve të gëzimit nuk do t'u vijë fundi.”

E, Allison Peers paraqet përvojën në vazhdim të Shën Terezës nga *Veprat e zgjedhura të Shën Terezës së Jezusit*:

“...Zotëria e merr këtë zog të vogël dhe e vendos në çerdhe të pushojë... Duke kërkuar Zotin në këtë mënyrë, shpirti bëhet i vetëdijshëm se gati krejtësisht humbet, në një lloj pavetëdije, me një kënaqësi të pamasë dhe të ëmbël... Në atë gjendje zhduket krejt forca e jashtme, derisa forca e shpirtit rritet...”

Francis MacNutt në *Forcën e shërimit* sjell këtë të kuptuar të rrënjëve të pushimit në Shpirtin Shenjt nga tradita Kishtare.

“Përvoja e Terezës, sigurisht, ishte si pasojë e lidhjes së saj të ngushtë me Zotin – ajo vërtet ishte shenjtëreshë e veçantë, por më kujtohet se çka u ka ndodhur njerëzve të rëndomtë nëpërmjet shërbesës së John Tauler-it, dominikanit gjerman, predikuesit nga shek. i 14.

Tregimin për te e kam lexuar qysh në vitin 1950, si seminarist në qytetin Winon, shteti Minnesota dhe kurrë nuk e kam harruar. John ka qenë predikues i njohur dhe një ditë në sakristi ka biseduar me një laik, i cili i shënonte pjesët e predikimit të tij. Kur John e ka pyetur se çka mendon për predikimet e tij, ai hezitonte të fliste. Më në fund ishte i detyruar të thotë se John ishte i ngjashëm me farisenjtë, të cilët vepronin më shumë nga krenaria e mendjes se sa nga drita e Shpirtit Shenjt. Natyrisht John ishte i goditur në zemër. Pas luftës së brendshme u përcaktua për hapin jo të zakonshëm, (sidomos për atë kohë), të ndjek udhëzimet e atij laiku. Ai laik e këshilloi që një kohë mos të predikojë, por të fillojë të mësojë. Kur e bëri këtë, vëllezërit e tij kujtuan se po e humb arsyen dhe filluan që ta përqeshin. “Thuhet se John Tauler përjetoi takim të thellë me Zotin (me pushimin në Shpirtin Shenjt, si duket) dhe “...kishte fituar dhuratën e kuptimit të gjërave të cilat më parë i kishte shumë të pakuptueshme.”

Ai laik i kishte thënë se “Zotëria e kishte prekur për të parën herë, se prej tani mësimet e tij do të vijnë nga Shpirti Shenjt Zot.” Kur iu kthye predikimit, ishte aq i fuqishëm sa dyzet vetë kishin pushuar në Shpirtin Shenjt.

Francis MacNutt vazhdon:

“Në bazë të kujtesës se këtë e kam lexuar në literaturën shpirtërore tradicionale të Kishës Romake, e kisha më të lehtë të mos çuditem risisë së kësaj dukurie, i vetëdijshëm se këso gjërash të jashtëzakonshme mund t'u ndodhin edhe njerëzve të thjeshtë...”

Francis MacNutt komenton më tutje se si rasti i Taulerit e ka bërë të ditur vlerën e mundshme të ekspozimit publikut në të mirë të meshtarisë, si dhe nevojën që meshtari të pushojë në mënyrë të mbushet me Shpirtin Shenjt.

Në mbarë botën në mesin e pentakostalëve

Pushimi në Shpirtin Shenjt është paraqitur në shërbesën e John Wesley-t, themeluesit të metodizmit, është paraqitur te rilindësi Charles Finney dhe është bërë pjesë përbërëse e kishave historike pentakostale. Më vonë filloi pak a shumë më shpesh të lajmërohet në kishat e krishtera. Në çdo periudhë të kishës, duket se ka pasur paraqitje të ngjashme të Zotit.

Stanley Frodshman në veprën *E vërtetonte me shenja përcjellëse* jep shembuj të shumtë nga mbarë bota:

Anglia e re, më 1870, duke folur për vajzën e re të drejtuar nga shpirti, e cila merrte pjesë në shërimin e të motrës së paralizuar, "... u përmbys nën dorën e Zotit dhe kur u ngrit, ia dorëzoi zemrën e vet Zotit."

Arkansas, 1879, - Një djalosh dëshmon: Nganjëherë me rastin e shërbesës së Zotit, e nganjëherë kur jam vetëm në lutje, bie përtokë, nën pushtetin e madh të Zotit."

Ruga Asuza, Los Angeles, 1906. - "Ashtu si vinin njerëzit, rrëzoheshin prej fuqisë dhe mbarë qyteti ishte i shqetësuar."

Indi 1905. - "Disa njerëz u rrëzuan, kur panë dritën e fortë. Derisa drita e Zotit ishte e ndezur, para saj kalonin gjymtyrët e trupit të ngarkuar me mëkat, krenari, me dashuri ndaj tokësorës, egoizëm, papastërti, etj..."

Pennsylvania, 1907. - "...përnjëherë ra në dysheme, u mbush me Shpirtin Shenjt dhe filloi të lutet në gjuhë."

Kanada, 1907. - "Një kohë kam qëndruar i shtrirë afër këmbëve të tij të bekuara, duke drejtuar shikimin në Te, ashtu i okupuar me lavdinë e Tij të pashpjegueshme, aq sa ndihesha i humbur për të gjithë dhe për çdo gjë përveç për Të. E preku tempullin në të cilin dëshiroi të banoj dhe e lëvizi në mënyrën e vet."

Ohio, 1908. - "...I kam parë së paku 50-75 vetë të cilët në të njëjtën kohë rrinin të shtrirë nën fuqinë e Zotit."

Amerika Jugore, 1908. - "...vëllai, i cili ishte me vite në kishë, por, i cili ishte si i krishterë plotësisht i padobishëm, u ngrit dhe kërkoi lutjen. Mezi e shprehi kërkesën e vet dhe u rrëzua, si ta kishte goditur dikush. Derisa më parë nuk kishte qenë në gjendje të lutej, tani fjalët i dilnin nga goja rrëke... prej asaj ditë u bë njeri i lutjes dhe fuqisë."

Amerika jugore, 1909. - "...katër zonja të reja (prej të cilave tri këndonin në kor) ranë në dysheme nën fuqinë e Shpirtit... njëra u ngrit dhe filloi të flasë me fuqi dhe bindshëm."

Amerika Jugore, 1909. - "...dukej sikur njerëzve t'u ishte dhënë opium. Disa nuk mund të ngriheshin pas lutjes së fillimit, e cila ishte si 'zëri i shumë ujërave' dhe të gjithë ishin të mahnitur për së tepërmi...Skenat e përmendura e të çuditshme joshnin numër përherë e më të madh kureshtarësh, kështu që numri i besimtarëve u rrit shumë shpejt..."

Kinë, 1914. - tregimi për një grua të verbër: "Pas lutjes së shkurtër, u mbush me Shpirtin Shenjt. Nuk e njihje gjuhën anglishte, por Shpirti Shenjt përnjëherë foli nëpërmes saj në anglishte dhe fjala e parë ishte "LAVDIA". Derisa gjendej e shtrirë në dysheme, Shpirti i Zotit e tha atë fjalë nëpër të ndoshta nja njëzet herë. Pasiuan edhe fjalë të tjera në anglishte, e në mes tyre fjala "I TIJ", pastaj fjala "PAQE". Edhe vetë shprehja të drejtonte kah paqja.

Pushimi në Shpirtin Shenjt paraqitej rregullisht në shërbesën e ungjillzueses protestante Kathryn Kuhlman. Ajo e komenton reagimin e njerëzve mbi fuqinë e Zotit në librin e saj *Shikimi në Lavdi*:

"...trupat tanë nuk janë të 'pajisur' të pranojnë tërë atë fuqi... Nuk e kanë pajisjen për qiell... Kur dikush ballafaqohet me Te, është tepër shumë për trupin fizik... Zoti është i gjallë...Ai është vetë bërthama e fuqisë. Ai nuk është vetëm Krijuesi i fuqisë, por vetë Fuqia.

Kur mendoni se Shpirti Shenjt mund ta shërojë trupin e sëmurë dhe me atë rast askush të mos e prekë me gisht - ajo është fuqia. Prandaj, a nuk është e logjikshme të besohet se ekziston kufiri se sa ky trup mund të pranojë atë fuqi, e që mos të ndodhë 'lidhje e shkurtë' në të?"

Ajo e sjell tregimin për profesorin e teologjisë i cili, me miqtë e vet, kishte ardhur një ditë në zyrën e saj, për ta pyetur mbi këtë aspekt të veprimtarisë së saj. Zoti ia dha demonstrimin personal:

"...posa e bëra një hap përpara dhe e shtrina dorën që ta vë mbi krahun e tij dhe të lutem për të, këmbët iu lakuan përnjëherë ...dhe ra me shpinë në tokë... u duk si të ishte mbushur krejt dhoma me Lavdinë e Zotit..."

Miqtë i ndihmuan të ngrihet dhe u nis kah dera, ende duke dridhur kokën, me shkëlqimin e fytyrës që duhet të ketë qenë si ai i Moisiut kur është kthyer nga mali Sinaj..."

Charles dhe Frances Hunter në veprën *Horizontet e mbinatyrshe* flasin për pushimin në Shpirtin Shenjt në takimet e lutjes të Kathryn Kuhlman:

"Pasi u kurorëzuam Charles-i dhe unë, derisa udhëtonim nëpër mbarë shtetin duke ndarë me të gjithë dashurinë e Jezu Krishti, dëgjuam disa gjëra të çuditshme për gruan me emrin Kathryn Kuhlman.. Dëgjuam se njerëzit te ajo përjetojnë shërime dramatike dhe se ajo i 'rrëzon' kur vinë të dëshmojnë! Mirëpo, kjo nuk na frikojë. Përkundrazi, në zemër na mbolli dëshirën të shohim çka është ajo që po flasin njerëzit..."

"Ishim në krahinën e Pittsburgut...dhe zbuluam se ajo është në kishën prezbiteriane. Në takimin e lutjes pamë disa gjëra për të parën herë. Pamë shërime dramatike nga më të ndryshmet... Kur njerëzit vinin të dëshmojnë shëndetin e tyre, vërejtëm se si Kathryn Kuhlman, thjesht, vë dorën mbi ta, e ata rrëzohen në shpinë..."

Frances Hunter flet se si Kathryn Kuhlman është nisur kah anija anësore e kishës dhe përnjëherë e ka drejtuar gishtin kah ajo dhe e ka thirrur.

"Në mënyrë të thjeshtë vendosi duart e saja të buta në kokën time dhe e luti Zotin të më bekoi. Ai vërtet më bekoi, sepse – a dëshironi të dini ku kam qenë? Drejt e në dysheme! Dhe, meqë ra fjala, me fustanin tim më të mirë, sepse atë ditë gjatë drekës është dashur të kem një fjalim të shkurtër. Por, aq më bënte. Ndjehesha si të isha në qiell. Më fryni Shpirti i Zotit dhe, derisa rrëzohesha u ndjeva e lehtë si pupël...Jeta ime kurrë më nuk ishte i njëjtë, prej asaj dite kur forca e Zotit kaloi nëpër mbarë qenien time.

"...Pak kohë më vonë – pasi më përfshiu fuqia e Zotit, Charles-i e përjetoi të njëjtën dhuratë mbinatyrore të Zotit. As jeta e tij – pikërisht si e imja – kurrë më nuk ishte e njëjtë, pasi Zotëria e preku personalisht. Qysh atëherë Zoti na dha rastin të shohim me qindra dhe mijëra njerëz se si bien nën fuqinë e Shpirtit Shenjt.

"Shumë vetë, gjatë vitesh na bënë pyetje se çfarë dobie nga krejt kjo. Kur ta përjetosh një herë këtë përvojë, kurrë më nuk do të jesh i njëjtë, sepse është fjala për prekjen e jetës suaj nga ana e Zotit të gjithëpushtetshëm!

Ndryshimi i jetës së individëve, të cilët e kanë përjetuar këtë është dëshmia më e mirë që është e njohur në lidhje me këtë ngjarje."

*"Të mëdha janë veprat e Hyjit,
Për t'u shqyrtuar prej atyre që i duan"*
(Ps 111,2)

Dëshmi

"Ndodhi në Romë..."

Ati Arnulfo paraqet dëshminë e tij:

Ati Arnulfo Arandia është ish udhëheqësi i lëvizjes për Ripërtëritjen e Shpirtit në Ekuador. Përvoja e tij e parë e pushimit në Shpirtin Shenjt ka ndodhur në tubimin karizmatik që është mbajtur në Romë me 1984.

"Jam shuguruar për meshtar në Ekuador me 1980. dhe katër vitet e para meshtaria ime ka qenë krejtësisht e padobishme. Meshja ime zgjaste 15 minuta, 'me vrap'. Gjatë meshës më hapej goja si një laiku të thjeshtë. Isha vërtet meshtar i dobët.

"Me 1984. udhëtova në New York, duke bartur me vete të gjitha vështirësitë dhe dëshpërimet e mia. Gjatë atij udhëtimit mendova madje edhe për braktisjen e thirrjes sime.

"Në atë udhëtim takova një çift bashkëshortor karizmatik. Pandërprerë e përmendnin Përtëritjen. Flisnin për Zotin kur zgjoheshin, për Zotin gjatë mëngjesit, për Zotin gjatë drekës, për Zotin gjatë darkës – gjithmonë dhe gjithkund për Zotin. U drejtoja fjalë fyese dhe të rënda, 'Ah, flisni për Zotin! As nuk e keni studiuar teologjinë, e mua më flisni për Zotin!

(Unë kam studiuar teologjinë dhjetë vite).

Më thirrën të shkoja me ta në Romë. Thashë me vete: Do të argëtohem mirë dhe do ta shfrytëzoj biletën që më ofrojnë.' Kalova tërë javën në Romë, duke fjetur dhe gërhitur gjatë ligjëratave. Përsëriteshin të gjitha ato që i kisha studiuar në teologji e filozofi. Ishte aq e mërzitshme! Atëherë erdhi çasti i shtrirjes së duarve, e unë i thashë zonjës: 'Nuk e kam pasur përvojën e Zotit' e ajo më tha: 'Amullfo, provo të jesh pak i përbujtë.'

"Gjendeshim në vendin ku papa dhe kardinali Suenens, përcillnin lutjen për njerëzit. Atje ishte edhe Nëna Tereze. Gjendesha në mesin e gjithë këtyre, kur një rregulltare pushoi në Shpirtin Shenjt. U ktheva drejt saj dhe fillova të qeshi. I thashë gruas, e cila më kishte çuar atje: 'Shikoje këtë motër. Ra si dardhë.' Ajo mu përgjigj: 'Shiko, bir, ky është çast i shenjtë. Po i shtrijnë duart.' U ktheva të shikoj dhe sikur të më kishte goditur dikush. Bum! Rashë në dysheme. U ngrita më vonë dhe ishte si të kisha qenë pa vetëdije. Nuk e dija se çka më kishte ndodhur në atë çast. I hapa sytë dhe pashë shumë gra se si po qanin. Mendova se kam vdekur. Shikova lart dhe pyeta atë zonjën se çka më ka ndodhur. 'Ky është veprimi i Zotit – pushimi në Shpirtin Shenjt.'

"Pas kësaj çdo gjë më dukej e re. Më parë dëshiroja predikimet e gjata, në atë moment ndjeva dëshirën që t'i largohem çdo gjëje që kishte të bënte me shkencën dhe metodat. Dhe thashë, 'prej tani, e vetmja metodë me të cilën do të shërbehem në predikimet e mia, do të jetë Fjala e Zotit dhe përvoja e Zotit.' "

"Në qiell nuk ka orë..."

Tregimi i Mateut

"Derisa shëtisja nëpër kishë, duke pritur lyerjen time të parë me vaj, dukej se po zgjaste sa amshimi. Dëshiroja të më vijë radha. Thashë, 'Zotëri, dëshiroj të ndiej praninë Tënde. Dëshiroj të di se Ti je i vërtetë, se je këtu. Më duhet kjo të di dhe të besoj.' Ishte kjo me 1981, me rastin e Meshës për shërim të atit Robert DeGrandis. Fliste për faljen, e zemra ime filloi të mbushet me dashuri ndaj të gjithëve, të cilët më kanë lënduar në jetë. Pastaj, kur foli për pushimin në Shpirtin Shenjt (Anketa ka treguar se -pyetja 1-. se si 62% e njerëzve ka pasur informatë para përvojës), ndjeva se si brenda meje po rritet shqetësimi. Kam jetuar në mesin e atyre që kanë mësuar shpejt dhe kurrë nuk kam qenë i kënaqur. Kam parë kaq shumë gjëra, aq sa kam menduar se asgjë nuk mund të më befasojë. Isha i gatshëm të shoh se çka ka Jezusi për të ofruar,'

"Ati DeGrandis na tha se Shpirti Shenjt do të na prekë nëse vërtet dëshirojmë. Duhej që vetëm ta lejojmë veten t'i biem në dorë. Na tha se Shpirti Shenjt është një Zotëri i madh, i cili kurrë nuk imponohet. Derisa shëtisja, i dëgjova në kokë fjalët: 'Kurrë këtë nuk do ta bëj për , Matte. Nuk je i veçantë. Duhet të jesh i shenjtë.' Por, edhe më tej mbeta në radhë. Këndoja dhe lutesha, derisa ati afrohej. Kur pranova lyerjen me vaj, rreth meje u paraqit reja e bardhë që më mbuloi. Mendimi im i parë, derisa isha i shtrirë në dysheme ishte se e gjithë kjo është qesharake dhe se jam rrëzuar sepse kam dashur të rrëzohem.' Por, edhe derisa isha duke menduar këtë, e

dija se nuk është e vërtetë. Jezusi ishte aty, afër meje. Zemra filloi të më rrahë me shpejtësi dhe gjaku në damarët e mi u nxeh, që nga zemra, e deri tek pjesët më të largëta të qenies sime. Thashë, 'Zotëri, të lutem, më fal. I mohoj të gjitha. E di se je këtu.'

"Ndieja se me orë të tëra jam i shtrirë në dysheme. Pushimi im me Jezusin ishte aq i mrekullueshëm dhe plotësues. E dija se do të duhej të ngrihem dhe t'ia liroj vendin dikujt tjetër. Kur provova të ngrihem, mezi qëndroja në këmbë. Me vështirësi shkova pas deri në karrige, derisa vjehrra ime rrinte dhe më shikonte, duke u qeshur vesh më vesh. Më vonë më pyeti përse u ngrita aq shpejt (mendoja se kisha qëndruar në dysheme së paku gjysmë ore). Më tha se kam qëndruar i shtrirë krejtësisht tre minuta! "Prandaj mendoj se në qiell nuk ka orë..."

"Kur pashë se si Jezusi është i afërt..."

Tregimi i Karin-ës

"Përvoja ime e parë e pushimit në Shpirtin Shenjt ndodhi në tubimin e rreth 5000 vetëve në Kaliforninë Jugore. Në atë kohë vuaja nga sëmundje të shumta shpirtërore që ishin pasoja të fatkeqësisë automobilistike, të cilën e kisha përjetuar dy vjet më parë dhe pandërprerë kisha dhembje. E kisha qafën e shtrembëruar, skoliozën, përkuljen e kombikut, kështu që njërin këmbë e kisha më të gjatë se tjetrën.

"Fillimisht nuk isha e sigurt se a do të mund të shkoj në tubim, sepse njerëzit, të cilët kishin premtuar të më çojnë, nuk ishin të sigurt se do të shkojnë. Mirëpo, u luta për atë qëllim me disa miq dhe në vizion pashë mindilin. Me të pranova edhe këto fjalë të Shkrimit *'Hyu, përmes duarve të Palit, bënte mrekulli të jashtëzakonshme, aq sa vinin façoleta e petka prej trupit të Palit përmbi të sëmurë dhe prej trupit të tyre zhdukeshin sëmundjet e dilnin shpirtrat e ndytë...'*" (Vap 19,11-12) E dija se duhet të shkoj.

"Në tubim dola përpara të luteshin për mua, e vetëdijshme se Zotëria e ka përgatitur takimin hyjnor. Njëra prej anëtareve të ekipit më vonë më tha se ishte lutur që Zotëria t'ia dërgojë 'personin e vërtetë' të lutet për të. Më leu me vaj dhe hollësisht u lut për çdo sëmundje. Kjo është diçka që personalisht e quaj 'lutje në pikat kyçe'. Derisa pushoja në Shpirtin Shenjt, në tërësi u shërova nga të gjitha vështirësitë trupore.

"Kur pashë se si Jezusi është i afërt, se si i intereson çdo detaj i jetës sime, fillova ta thelloj hulumtimin tim. Një muaj më herët isha mbushur me Shpirtin Shenjt, derisa akoma isha e tejet e pikëlluar dhe vuaja nga dhembjet e mëdha. Ky takim i ri me dashurinë e Tij, në qenien time krijoi dëshirën për afërsi më të madhe, por edhe për disiplinë më të madhe. Ishte ky fillimi i dorëzimit tim të vërtetë Jezu Krishtit."

ANKETA

(edhe pak statistikë)

5. A je i vetëdijshëm për ndonjë shërim që ka ndodhur kur ke pushuar për të parën herë në Shpirtin Shenjt?

Po	66%
Jo	31%
Pa përgjigje	3%

(Përqindje më e madhe e grave janë të vetëdijshme për shërim. Shënimet tregojnë: 63% të meshkujve në krahasim me 68% të grave.)

6. Në vazhdim pasojnë llojet e sëmundjeve për të cilat është dëshmuar me rastin e përvojës së pushimit në Shpirtin Shenjt:

Meshkujt*

Femrat*

Marrëdhëniet ndërnjerëzore	18%	15%
Trupore	11%	13%
Psikike	28%	30%
Shpirtërore	57%	48%

*Përgjigjet japin shumën më të madhe se 100%, sepse të anketuarit shpesh kanë shënuar më shumë se një kategori.

7. A je i vetëdijshëm për ndonjë shërim, i cili ka ndodhur kur ke pushuar të TRETËN herë në Shpirtin Shenjt?

Po	66%
Jo	19%
Pa përgjigje	15%

(dhe përsëri më shumë femra janë të vetëdijshme për shërim, 69% femrat në krahasim me 60% meshkujt.)

8. Në vazhdim pasojnë llojet e sëmundjeve për të cilat është dëshmuar me rastin e pushimit në Shpirtin Shenjt të TRETËN herë:

	Meshkujt*	Femrat*
Marrëdhëniet ndër njerëzore	16%	20%
Trupore	4%	12%
Psikike	23%	28%
Shpirtërore	41%	45%

*Përgjigjet japin shumën më të madhe se 100% sepse të anketuarit shpesh kanë shënuar më shumë se një kategori.

Pasqyrë e pikave kyçe

*Në Shkrime ekzistojnë shumë pjesë ku flitet se si njerëzit janë rrëzuar në praninë e Zotit, me qëllim ose pa qëllim dhe për arsye të ndryshme.

*Disa shenjtër nga historia katolike na flasin për gjendje ekstaze në të cilën forca fizike humbet, përderisa ajo shpirtërore rritet.

*Duket se gjendja e ekstazës është e ngjashme me përvojën e sotme të pushimit në Shpirtin Shenjt, por nuk është e njëjtë.

*Pentakostalët në mbarë botën flasin për kthimin dhe për pranimin e fuqisë nga ana e individëve duke rënë përdhe para Zotërisë.

Kur dëgjojmë për shërimet dramatike, zemrat na mbushen me uri edhe më të madhe për Zotin.

Lutja

Atë Qiellor, të lutem, më dhuro kuptimin e thellë biblik të pushimit në Shpirtin Shenjt. Dëshiroj ta kuptoj këtë nëpërmes fjalës sate, si edhe nëpërmes përvojës personale.

Nëpërmes pushimit në Shpirtin Shenjt, bën të njoh më mirë natyrën dhe mirësinë Tënde, ashtu si me njerëzit në *Shtetin e Zotit*. Më lejo të kem përvojën e tyre të gëzimit dhe të mahnitjes.

Ashtu si tek John Tauler-i, unë dëshiroj që aftësitë e mia të brendshme dhe të jashtme të bëhen të vetëdijshme për fuqinë e re; dëshiroj kuptimin e qartë të gjërave të panjohura deri tani, dëshiroj mësimin, i cili vjen drejtpërdrejt nga Shpirti Yt, dëshiroj dhuratën e kuptimit, dëshiroj të jem mjet i përshtatshëm për veprat Tua.

Ashtu si te pentakostalët, edhe unë dëshiroj një zemër që dhurohet dhe pastrimin nga mëkatet, nga krenaria dhe nga egoizmi. Më ndihmo, Atë, të bëhem njeri i lutjes.

Së bashku me atin Arnulfo Arandin, dëshiroj që puna ime të jetë e frytshme dhe e fuqishme. Së bashku me Mattinë, edhe unë dëshiroj dashuri të thellë për ata që më kanë lënduar. Në fund, si edhe Karina, edhe unë dëshiroj afërsi më të madhe me Ty dhe disiplinë më të madhe në jetën time. Le të jetë ky çast fillimi i dorëzimit të vërtetë.

Atë Qiellor, bëj të pushoj në Shpirtin Shenjt Tëndin dhe bëj që puna të fillojë. Në Emër të Jezusit. Amen.

*"Sepse i mirë është Zoti,
e amshuar dashuria e tij
nga breznia në brezni besnikëria e tij.
(Ps 100, 5)*

3. Më prin në ujëra të qeta

*"...pse do t'u prijë Ai që ka mëshirë për ta
dhe do t'i mrizojë ndër gurra të freskëta."
(Iz. 49,10)*

Qëllimi i kësaj pjese është të ofrojë një pasqyrë të thjeshtë se si duket dhe çfarë është ndjenja e pushimit në Shpirtin Shenjt – nga ana e jashtme dhe e brendshme.

“Të gjithë ata njerëz që rrinë të shtrirë atje...”

Dukja nga jashtë

Pushimi në Shpirtin Shenjt është, si duket, një prej mënyrave në të cilat Zoti na vë në pozitë, ose në qenien tonë e rregullon dinamikën, që të kemi mundësi ta pranojmë shërimin. Ati John Hampsch përshkruan disa nga metodat e shërimit nëpërmes të të cilave mund të arrihet pushimi në Shpirtin Shenjt.

“Shërimi ndërmjetësohet në shumë mënyra. Kjo mund të bëhet me vetë shtrirjen e duarve, me shtrirjen e duarve mbi grupin, bekimin e të sëmurëve me lutje nga libri i riteve, ose bekimin me të Shenjtërueshmin. Mbarë grupi mund t'i shtrijë duart mbi supe ose mbi kokë të personit për të cilin lutet, ose mund të lutet në të njëjtën kohë për më shumë persona që formojnë rrethin dhe mbahen për duarsh.

Pushimi në Shpirtin Shenjt mund të ndodhë në cilindo prej këtyre rasteve. Zakonisht ndodh me shtrirjen e duarve ose lyerjen me vajin shenjt.”

Ambienti

“Kam qenë vetëm, duke pushuar në pauzën e seminarit. Gjatë 15-30 minutash ndieja një prani aq të fuqishme të Zotërisë (rrymë, dridhërimë, paqe) sa që e dija se duhet të qëndroj në vend. Madje mendoja se nuk jam në gjendje të lëviz fare.” (shitësja e librave).

“Shpesh pushoj në Shpirtin Shenjt në takimet e shkurta në shtëpi. Zotëria në ato raste bën shërime të thella të brendshme...” (bashkëshortja dhe nëna).

“Shumica e përvojave të mia të pushimit në Shpirtin Shenjt ka të bëjë me tubimet e mëdha 200-1000 vetë: megjithatë, kur jam në dysheme, atëherë jam vetëm me Jezusin. Ai më drejtohet dhe më do sikur të isha vetëm unë aty.” (grua afariste).

Pozita

"Isha me një grup dhe luteshim për një tjetër person të pranojë pagëzimin me Shpirtin Shenjt, kur dëgjova udhëheqësin që tha: "Mbajeni se po rrezohet!" Mendova se po flet për dikë tjetër dhe u gjenda në dysheme..." (ndërtimtar).

"Shpesh kam pushuar në Shpirtin Shenjt e ulur në karrige..." (rregulltare benediktime).

"Një mik lutej mbi mua derisa qëndroja i shtrirë dhe pushoja thellë gjysmë ore." (mësues).

Mjeti

"Ati DeGrandis më pyeti se a dëshiroj të pagëzohem me Shpirtin Shenjt. Kur u përgjigja në mënyrë afirmative, më preku lehtë dhe unë rashë në dysheme." (informaticien).

"Ka raste kur më duket gati e pamundur të qëndroj në këmbë, edhe pse askush nuk më prek dhe nuk i shtrin duart." (amvise).

Ndjenja gjatë rënies

"Ndjem jashtë gravitetit, si astronaut..." (zyrtar).

"...si fleta në ajër, duke fluturuar deri në tokë..." (nënë).

"Dukej si të kishte rënë diçka e fortë brenda meje..." (informatior).

Ndryshime në kuptimin trupor gjatë qëndrimit në dysheme

Në bazë të dëshmive që i kam dëgjuar, duket se shpesh shkaktohet "anestezioni" i butë dhe i pjesshëm i ndjenjave trupore, që mundëson zhvendosjen e qendrës së rëndimit nga jashtë e përbrenda. Kur arrihet ky ndryshim, duket se si bota shpirtërore ngjallet në një mënyrë më të fuqishme.

Manifestimet trupore

Paqe, shqetësim (kryesisht nënkupton prekjen e plagëve të thella emocionale ose zëvendësimin e përvojave negative me praninë e Jezusit: më gjerësisht për këtë në kapitullin 6.), qeshje, qarje.

Koha e qëndrimit në dysheme

Koha mund të jetë prej disa minutave deri në orë të tëra, varësisht, me gjasë, nga thellësia dhe veprimi i brendshëm që duhet të kryhet. "Përvoja ime shtrihet prej pushimit të lehtë deri tek pushimi i gjatë. Kam ndjerë se Shpirti vjen me butësi dhe shpejt, me intensitete të ndryshme" (sekretarja).

"I kam parë gjithë ata njerëz që rrinë të shtrirë atje dhe pyeta veten: athua se çka është duke bërë Zoti..." (mësuese).

"Përqaftime të kujdesshme dhe përkundje..."

Shikimi nga brenda

Ashtu si kam thënë në *Shërbesën e shërimit*, Zotëria shpesh na flet në nivele të thella, derisa pushojmë në Shpirtin Shenjt:

"Shumë njerëz kanë pasur përjetime, se e shkuara u ka kaluar para syve... Besoj se kur kjo ndodh në ambientin e lutjes, kemi të bëjmë me shërimin e brendshëm..."

Të anketuarit kanë përmendur shumë mënyra në të cilat Zotëria i ka prekur zemrat e tyre. Komentet tjera përshkruajnë ndjenjat e paraqitura në anketë dhe në të njëjtën kohë shprehin atë që dëgjoj kudo në botë, me rastin e kurseve për aftësim dhe seminarët e shërimit. I kemi ndarë përgjigjet e meshkujve dhe femrave.

Përvojat e meshkujve

"Kjo më afron te Zotëria. Është nxitje e vërtetë rritjes sime shpirtërore" (maknist i pensionuar).

"Kur pushoj në Shpirtin Shenjt kam përvojë të pabesueshme të pranisë së Zotit. Nuk e di kur kam pushuar dhe pranuar ndonjë shërim të caktuar, por gjatë viteve jam shëruar nga gjashtë sëmundje trupore dhe nga disa probleme emocionale. Gjatë tetë viteve të kaluara lutem për të tjerët dhe kam parë shumë vetë se si pushojnë në Shpirtin Shenjt" (ndërmarrës i përcaktuar si gjakon i përhershëm).

"Pushimi në Shpirtin Shenjt më ka bërë të aftë të mbështetem në Zotin" (punëtor publik).

"I ka ndihmuar ngjalljes së fesë sime. Ndiej se kurrë nuk do të kisha arritur këtë nivel të kuptimit po të mos kisha pushuar në Shpirtin Shenjt. Zotëria atëherë ka rastin të veprjës e që unë të mos e pengoj" (Shiko pyetjet e anketës së 12.: 94% e njerëzve konsideron se pushimi në Shpirtin Shenjt është dhuratë e Zotit) (drejtor shkolle).

"Është koha e përtëritjes shpirtërore, që liron nga frika dhe tensioni" (avokat).

"Është e ngjashme me të dashuruarit. Paqa dhe dorëzimi janë të pabesueshme. Mbetet kujtimi si freskim shpirtëror në kohërat e thatësisë" (kontabilisti).

"Të parën herë isha vetëm në shtëpi (Shiko pyetjen e 10. të anketës: 54% të njerëzve kanë pushuar në Shpirtin Shenjt derisa kanë qenë vetëm). E kam ndjerë praninë e sigurt të Shpirtit Shenjt dhe për mua ka filluar një marrëdhënie e re me Zotërinë" (mësues).

"Kam parë njerëz që kanë pushuar në Shpirtin Shenjt se si vijnë te Zotëria dhe kthehen në Kishë (nëpunës poste).

"Për mua është një relaksim i plotë. Nganjëherë jam i vetëdijshëm për atë që ndodh rreth meje, e nganjëherë jo. Ndiej një pajtim të plotë me Krijuesin tim" (bujk).

"Kam pushuar në Shpirtin Shenjt në një seminar kur kemi shkuar të lutemi për shërimin e birit tim. Mendimet e mia të para kanë qenë negative, por gjatë kohës së pushimit në Shpirtin Shenjt e kam lutur Jezusin që t'i ndihmojë birit tonë. Vërtet kam filluar të ndiej paqe kur jam lutur për personin tjetër, i cili po ashtu ka pushuar në Shpirtin Shenjt" (mashkull anonim).

"Ai ka qenë njëri prej çasteve më të mbushur me paqe, dashuri dhe afërsi të Zotit, që më kujtohet" (shitës).

"Përvoja ime e pushimit në Shpirtin Shenjt deri tani nuk ka qenë interesante (inxhinier).

"Të parën herë kam pushuar në Shpirtin Shenjt pas vdekjes së motrës sime më të vjetër. Isha i hidhëruar dhe i pikëlluar thellë. Shoqja dhe unë shkuam në varrim. Ajo vuante nga artriti në kërdhokull. Pas pushimit në Shpirtin Shenjt u ngrit e shëruar. Unë u ngrita me vizionin se si motra ime ecën dorë përdore me Jezusin" (voztës kamioni).

"Përvoja e parë plotësisht e ndërroi jetën. Përsëri shkova në Meshë dhe u bëra baba më i mirë për fëmijët e mi dhe në përgjithësi njeri më i mirë" (inspektor).

"Pushimi në Shpirtin Shenjt më ofron ndjenjën e paqes, e cila më ka munguar tërë jetën" (informaticien).

"Është fjala për ndjenjën e pabesueshme të dashurisë së Zotit e ngjashme me përqaftimin e prindit" (administrator).

"I lumi ai që shpreson në të!"
(Ps 34,9)

Përvojat e femrave

"Kam pasur frikë që t'i afrohem Zotërisë. Duke pushuar në Shpirtin Shenjt, i them Zotërisë, 'Më merr, jam e Jotja. Dëshiroj çdo gjë që Ti dëshiron për mua'" (motër medicinale).

"Nuk kam pasur dëshirë të pushoj në Shpirtin Shenjt derisa qëndroja dhe pritja në radhë, me frikë se a do të më mbajë dikush kur të rrëzohem" (rregulltare).

"Jam ndjerë e shëruar në trup, në mendje dhe shpirt; e pastruar; e përtërirë" (rregulltare)

"...kam shkuar e shqetësuar dhe të nesërmen ato këngë që i këndoj gjithmonë, përnjëherë kanë pasur kuptim" (amvise).

"Nganjëherë akoma nuk mund të pajtohem me këtë" (nëpunëse).

"U denjova ta shoh veten në një mënyrë të re dhe kuptova se qasja kontemplative ndaj problemit është më konstruktive se sa ajo kritike" (motër medicinale).

"Do të dëshiroja që këtë ta pranoj më mirë. Nëse gjendem në shoqëri me njerëzit, të cilët nuk janë karizmatikë, nuk ndjehem mirë. Por, pas pushimit në Shpirtin Shenjt ndjehem aq mirë aq sa do të dëshiroja të më ndodh më shpesh" (motër medicinale).

"Ndiej se si fundosem në dashurinë e Zotit" (disenjatore).

"Dikur kam dashur që t'i dorëzohem Shpirtit, por kam ndjerë se si i rezistoj me qëllim" (zyrtare gjyqi).

"Çdo herë kam ndjerë paqen e Zotit, forcën dhe praninë" (mësuese).

"Kjo e ka përparuar jetën time të lutjes" (shiko pyetjen e 13 të anketës: 82% e të anketuarve konsideron se si përvoja e pushimit në Shpirtin Shenjt e ka përparuar jetën e tyre të lutjes) (amvise).

"Në kuptimin intelektual i kam bërë rezistencë pushimit në Shpirtin Shenjt, por gjatë këtyre nëntë muajve jam bërë shumë e hapur kësaj përvoje. Tani kam raport më të ngushtë me Jezusin dhe Ai më ndihmon që t'i kuptoj ngjarjet në jetën time" (mësuese).

"Njëra prej shërimeve më të thella që kam pranuar me rastin e pushimit në Shpirtin Shenjt kanë të bëjnë me raportin me atin tim tokësor, por edhe me Atin qiellor" (amvise).

"Isha e befasuar (shiko pyetjen 4 të anketës: 69% të njerëzve kanë qenë të befasuar) kur kam pushuar të parën herë në Shpirtin Shenjt, sepse mendoja se kjo është vetëm për njerëzit, të cilët janë të mbushur me Shpirt më shumë se unë! (pastruese).

"Kur kam pushuar të parën herë në Shpirtin Shenjt jam shëruar nga artriti në këmbë, shpinë dhe duar, prej të cilit kam vuajtur disa vite. Mendoj se dhurata më e madhe që fitohet me rastin e pushimit në Shpirtin Shenjt është raporti i përtërirë dhe i afërt me Zotërinë' (drejtoreshë e pensionuar e shkollës).

"Në fillim nuk më pëlqente mendimi të qëndroj e shtrirë në dysheme e rrethuar me njerëz. Tani Zotëria e ka marrë atë ndjenjë dhe e ka zëvendësuar me paqe të thellë të mbushur me dashuri sa herë që pushoj" (gjellëbërëse).

"Kam qenë shumë e prekur kur kam parë fëmijët e mi duke pushuar në Shpirtin Shenjt. Reagimi i tyre shquhet me besim të thjeshtë dhe gjithmonë është i mbushur me dashuri" (amvise)

"Ndiej se Zoti më do" (praktikante medicinale)

"Kam pranuar dhuratë të dashurisë aq të madhe, aq sa mezi kam mundur ta duroj" (punëtore në hoteleri).

"Kur jam kyçur në Ripërtëritje, kam ndjerë një pasiguri të pabesueshme dhe nuk mund të besoja se dikush më do. Të parën herë kur kam pushuar në Shpirtin Shenjt, e kam takuar dashurinë e Jezusit" (shtëpiake).

"Para nja dhjetë vitesh, pas lutjes dhe pushimit në Shpirtin Shenjt, u shërova nga diskutët e përdredhur" (shiko pyetjen 11 të anketës: 54% të të anketuarve dëshmon për shërime të mëdha që kanë ngjarë gjatë pushimit në Shpirtin Shenjt" (bibliotekiste).

"Mendoj se është hyrje e plotë në lavdinë e Zotit para se të shkojmë në qiell!" (manekine).

*"...Ne e pamë lavdinë e tij,
atë lavdi që prej Atit i përket Birit të vetëm
plot hir e të vërtetë."*

(Gjn 1,14)

Dëshmi

"Më kujtohet se çka thoshte nëna..."

Tregimi i Vincent-it

"Edhe pse Ruth më kishte folur për pushimin në Shpirtin Shenjt, kisha vendosur të mos rrëzohem. Para se gjithash, sepse i kisha veshur rrobat më të mira që kisha dhe nuk doja që t'i bëj të papastra në dyshemenë e sallës së sporteve. Së dyti, e konsideroja si shenjë dobësie për një shef të shërbimit social të shtrihet në dysheme. Si pikë e tretë, më kujtohet se çka thoshte nëna për 'halelujat e çmendura'. Në vitin 1936, jetonim përballë kishës baptiste ku njerëzit e thërrisnin njëri tjetrin 'vëlla' e 'motër', luteshin në gjuhë dhe binin në dysheme. Nëna thoshte, 'ja shiko, këto janë ato 'halelujat e çmendura'. Kurrë mos ki punë me ta. Dhe ja, kështu edhe ne, shumë vite më vonë, bënim pikërisht të njëjtën gjë në takimet e lutjeve të katolikëve. Arsyeja e katërt për shkak të së cilës kisha vendosur të mos bie, ishte sepse veten e dija për "burrë". Si i tillë, konsideroja se në dysheme mund të më rrëzojë vetëm një tjetër "burrë" sikurse unë., por Shpirti Shenjt ishte "burrë" e shkuar burri. Nuk jepte pesë para se sa jemi të mëdhenj. Nuk i interesonte statusi ynë. Do të na rrëzojë vetëm nëse pak e hapim derën. Ai e ka atë fuqi. U gjeta në dysheme. Nuk e kisha më me rëndësi "burrërinë", gjendesha në duart e Jezu Krishtit, i cili më ledhatonte, më shëronte dhe më donte. Çdo urrejtje dhe hidhërim, sa çel e mbyll sytë, u zhduk nga zemra ime. U shndërrova në person të ri. Vincenti i vjetër mbeti në dysheme, e Vincenti i ri u ngrit me Jezu Krishtin. E ndërpreva alkoolin. E braktisa duhanin. E braktisa mënyrën botore të jetesës. U ktheva në kishën katolike..." (shiko pyetjen 5: 57% të meshkujve janë shëruar shpirtërisht me rastin e pushimit të parë në Shpirtin Shenjt).

*"...sepse Ti je bërë ndihma ime,
prandaj do të brohoris nën hijen e krahëve të tu."*
(Ps 63, 7-8)

"Prekja e mirësisë..."

Tregimi i Irenës

"I kam parë njerëzit se si 'rrëzohen nën Shpirtin Shenjt' në një Meshë për shërime dhe kjo më mahniti. Çka u ka ngjarë? Nuk kam menduar shumë për këtë, sepse iu kushtova kënaqësisë së këndimit të këngëve derisa prisnim, duke e bindur me atë rast miken time Barbie se do të jetë çdo gjë mirë me të dhe se unë nuk do të rrëzohem. Derisa qëndronim para altarit, fillova të lutem, duke u përqendruar në Kryqin e Jezusit mbi altar dhe duke lutur Shpirtin Shenjt të lejojë që Drita e Tij të hyjë në zemrën, mendjen dhe shpirtin tim. Thashë, 'Të dorëzohem

plotësisht. Bëj me mua çka të duash.' E përsërisja këtë pandërprerë, e atëherë ndjeva se si ati Mathew po afrohet. Ndjeva një shqetësim të veçantë. E shikova Barbien, se a i duhet ndihma ime. Pastaj ati Mathew e vendosi njëren dorë mbi kokën time e tjetrën mbi krahun tim. Fillova të them lutjen për Dritën dhe ndjeva se si diçka po më tërheq prapa dhe po e humbisja kontrollin. E kapa meshtarin për dore të mbahesha. Nuk e ndieja fare trupin tim, si të mos isha aty.

"Kur u ngrita nga dyshemeja dhe u ktheva në karrige, nuk munda të ulem në gjunjë, por rrëshqita anash: Këmbët i kisha aq të dobëta, aq sa nuk më mbanin. Ia plasa vajit dhe me dihatje ia shpreha dashurinë time Zotërisë dhe pa pushuar e falënderoja me fjalët, 'Të faleminderit Zotëri që më ke prekur'. U ula, duke ndjerë ngrohësi, por edhe dobësi. Kisha përshtypjen e një dridhjeje të brendshme dhe mendoja se sigurisht po më dridhen duart, por kur i shikova, pashë se qëndronin në prehër të qeta. Njerëzit rreth meje bisedonin, por unë nuk doja që t'i bashkëngjitem bisedës. Dëshiroja që vetëm të rrij dhe të kënaqem në atë ndjenjë.

"Në rrugën për në shtëpi, ndjehesha e rraskapitur, si të mos doja të flas. Kur fola, fola ngadalë. Kur shkova në shtëpi, bisedova me bashkëshortin tim Willis-in. Dëshiroja që t'i tregoj për ndjenjat e mia. Isha e plotësuar dhe e rrethuar me mirësi të cilën dëshiroja për ta ndarë me të. Para se të shkojmë në gjumë, përsëri biseduam.

"E dija se përse Zoti prek në ndjenja. Nuk ka fjalë në fjalorin tonë me të cilat do të mund të përshkruhej kjo, kështu që, në të vërtetë është e pamundur të përcillet me fjalë. Për këtë arsye ka kaq shumë fshehtësi, gjëra të cilat nuk mund t'i kuptojmë. Gjuha e Zotit është aq shumë mbi ne. Prandaj themi se në qiell do t'i kuptojmë të gjitha në praninë e Trinisë së Shenjtë. Atëherë do të flasim të gjithë me të njëjtën gjuhë.

"E gjeta përshkrimin e asaj se si ndjehesha: shqetësim i qetë. Nuk ishte ai shqetësim që nuk të len të flesh, por pranim i qetë i dhuratës së Zotit...Shqetësim me dhuratën që pikërisht e kisha pranuar. Para se të flija kisha të njëjtën ndjenjë që e kisha në universitetin *Notre Dame* kur duke qëndruar para të Shenjtërueshmit, e kisha ndjerë aq fuqishëm praninë e Zotërisë.

Atë natë isha e përgatitur plotësisht të vdes, sepse isha në gjendje hiri., por mendova në familjen time dhe thashë, 'Ndoshta është më mirë që edhe pak të rri, por Ti Zotëri mos më rri larg.' Më vonë, kur u zgjova natën, isha e vetëdijshme se si nëpër kokë po më kalon një këngë kishtarë. Buzëqesha, sepse kuptova, se – si duket – kisha kënduar dhe lutur në gjumë. Lavdi Zotit!

Ajo ndjenjë e këndshme më ka përcjellur tërë ditën e ardhshme. Ndjehesha e veçantë, por kjo nuk ishte nga unë, por nga Zoti në mua. Kisha përshtypjen se po rrezatoj mirësinë dhe dashurinë e Tij dhe se të gjithë do të vërejnë se jam ndryshe. Mirëpo, si duket, nga jashtë nuk jam dukur ndryshe, por ndjehesha e re. Asgjë nuk ka mundur ta turbullojë paqen time atë ditë. Iu gëzova shkuarjes në kishë në mbrëmje... jo pse prisja ndonjë mrekulli të madhe, por thjesht të jem aty. Posa arrita në ulëse, iu falënderova Zotërisë se mund të jem aty. Meshtari i vërtetoi ndjenjat e mia. Sado e padenjë që isha, vërtetë ndodhi. Më preku!"

"Unë? Aq të duhem unë?"

Tregimi i Evelyn-ës

Para se të pushoja në Shpirtin Shenjt më mundonin shumë pyetje dhe brenga. Zotëria më dërgoi një rregulltare me të cilën u shoqërova dhe, e cila me durim përgjigjej në ato pyetje. Duke iu falënderuar durimit të saj, para se të shkoja në Meshën e parë për shërim, isha e përgatitur për atë përvojë. *(shiko pyetjen 1. të anketës: 62% të njerëzve të anketuar kanë qenë të njoftuar paraprakisht.) Ajo më shpjegoi se do të ma lyejnë ballin me vaj dhe sigurisht do të ndjehem si e pa peshë dhe e relaksuar. Më tha se nëse rrëzohem prapa, dikush do të më mbajë dhe se nuk duhet të frikohem se do të lëndohem. Më tha se edhe nëse nuk pushoj në Shpirtin Shenjt kjo nuk do të thotë se me mua diçka nuk është në rregull. Isha e përgatitur për vajim.

Meshtari, e bëri shenjën e kryqit, me vaj, në ballin tim, duke thënë: 'Po në Të edhe ju që e dëgjuat fjalën e së vërtetës – Ungjillin e shëlbimit tuaj – mbasi besuat në Të, u vulosët me Shpirtin Shenjt – të Premtuarin –' (Ef 1,13). E ndjeva se si ngadalë dhe pa peshë po rrëzohem prapa në duart e bashkëshortit tim, i cili më lëshoi ngadalë në dysheme.

"Edhe pse mendja ime ishte e përgatitur për këtë përvojë, zemra ime nuk ishte e përgatitur për ndjenjën vërsuese të pranisë dhe dashurisë së Zotit. E ndjeva se si më flet, 'Evelyn, aq po brengosesh për nevojat e të tjerëve. Tani vetëm lëshohu, erdhi radha në ty. Më lejo të të tregoj sa të dua dhe kujdesem për ty.' U ndjeva si fëmijë në duart e nënës, objekt i kujdesit të përgjithshëm. Ndjeva se si Krishti në mua derdh kujdesin e tij të mbushur me dashuri. Depërtoi deri te thellësitë më të mëdha të zemrës sime. Ndjenja e befasisë nga gjithë ai kujdes më shtynte në pyetjen, 'Unë? Aq të duhem unë?'"

*"Lëshoni në dorën e tij të gjitha kujdeset tuaja,
sepse Ai kujdeset për ju"*

(1 Pjt. 5,7)

ANKETA

(edhe pak statistikë)

7. A keni dëshiruar të pushoni në Shpirtin Shenjt herën e parë?

Po 48%

Jo 50%

Pa përgjigje 2%

(55% të meshkujve ka dëshiruar të parën herë këtë përvojë, krahasuar me 45% të femrave)

8. A keni dëshiruar të pushoni në Shpirtin Shenjt të TRETËN herë?

Po 63%

Jo 25%

Pa përgjigje 12%

(68% të meshkujve, ka dëshiruar të TRETËN herë këtë gjë, krahasuar me 61% të femrave).
...vazhdon

Pasqyrë e pikave kyçe

*Pushimi në Shpirtin Shenjt mund të ndodhë derisa jemi vetëm, në grupe të vogla ose të mëdha.

*Pushimi mund të ndodhë derisa jemi në këmbë, ulur ose të shtrirë.

*Pushimi mund të ndodhë me ndërmjetësues ose pa të.

*Rrëzimi shpesh përcillet me ndjenjën e "mungesës së gravitetit".

*Pushimi shpesh përcillet me bartjen e qendrës së rëndimit prej botës së jashtme, brenda.

*Përvoja shtrihet prej ndjenjës së butë të paqes deri te shërimi dhe transformimi i thellë.

Lutja

Atë Qiellor, dëshiroj të të njoftoj në asisoj, si nuk të kam njohur deri më tani. Sikurse njerëzit tek anketa, dëshiroj të kem vetëdije më të thellë për praninë Tënde, freskim dhe lirim nga ankthi, lidhje më të afërt me Ty dhe njohje të dashurisë Sate të pamasë.

Sikurse gratë te anketa, dëshiroj të ndjehem i pastruar, i ngazëllyer, në afërsi me Ty, i shëruar thellë, i qetë dhe i vetëdijshëm për fuqinë Tënde.

Sikurse Vincent-i, dëshiroj të humb interesimin për botën; sikurse Irena, dëshiroj vërtet të mësoj gjuhën Tënde; sikurse Evelyn, dëshiroj të kem kujdesin tënd të gjithëmbarshtëm.

Të falem nderit, Atë Qiellor, për mënyrat e mrekullueshme të veprimit Tënd në jetën time. Më bën vegël të shërimit për të tjerët. Në emër të Jezusit. Amen.

*"...sepse e madhërueshme është deri në qiell mëshira jote,
Deri në re e vërteta jote!"*

(Ps 108,5)

4. E freskon shpirtin tim

*"Hyu, burimi i çdo hiri,
i cili na grishi në lumturinë e vet të amshuar në Jezu Krishtin,
Ai, mbasi të vuani për pak kohë, do t'ju përsosë, do t'ju përforcojë,
do t'ju japë fuqi dhe do t'ju bëjë të pa trandshëm."*

(1 Pjt. 5,10)

Dëshmi dhe mendime të meshtarëve dhe të rregulltarëve

Në këtë kapitull meshtarët dhe rregulltarët dëshmojnë për pushimin në Shpirtin Shenjt, kryesisht si ndërmjetësues të kësaj përvoje.

"Ndoshta keni të drejtë, por..."

ati Jack raporton nga Australia

Ati Jack Soulsby nga Queenslandi mendon për përvojat e tij:

"Të parën herë kam dëgjuar për këtë dukuri më 1957, kur studioja në Nemi, në afërsi të Romës. Disa njerëz dëshmonin për pushimin në Shpirtin Shenjt në takimin e bashkësisë së lutjes dhe paraqitnin përvojat e veta të dyshimit dhe të frikës. Nuk kishte kurrfarë shpjegimesh që nxiste hezitime të mëdha në lidhje me vetë përvojën. Ajo situatë vërtetonte nevojën për udhëzime të mira.

Në seminarin karizmatik për meshtarët, të mbajtur më 1987 në Sydnej, ati DeGrandis këshillonte bashkësinë tonë mbi pushimin në Shpirtin Shenjt. Rezultatet ishin fenomenale. Ajo që e kam mbajtur mend mirë, ishte që jo vetëm se duhet të jemi të hapur, por që duhet ta dëshirojmë këtë përvojë. Me rastin e vlerësimit të ushtrimeve shpirtërore, shumica e meshtarëve kanë dëshmuar se kanë shijuar paqe. Personalisht kam përjetuar praninë e Zonjës, e cila më ka thënë: 'Më sjell shumë gëzim sepse dëshiron të kryesh vullnetin e Birit Tim.' Dhjetë muaj më vonë, ajo përvojë ishte ende e qartë dhe e gjallë.

"Kur njerëzit pushonin në Shpirtin Shenjt me rastin e shërbesës sime, ndodhte të vinin disa të tjerë dhe më thoshin: 'Nuk besoj se krejt kjo është prej Zotit' Shpesh ua ktheja me fjalët: 'Ju lutem, prisni pak këtu!' Pastaj i thirrja disa nga ata që kishin pushuar, 'Pjetër, a do t'ia shpjegoje mikut tim se çfarë ka qenë përvoja jote?' Ai përgjigjej: 'Ah, çfarë paqe!' Atëherë thosha: 'John, a do t'ia tregoje mikut tim përvojën tënde?' 'E kam parë Jezusin...' Pas nja katër-pesë përvojash, iu ktheja atij që kishte kritikuar dhe i thosha. 'Pra, ndoshta keni të drejtë se e gjithë kjo nuk është prej Zotit, por në teorinë tuaj duhet të fusni edhe këtë që pikërisht keni dëgjuar!'"

"Përqendrimi në ndryshim..."

raport i një meshtari nga Minnesota

Ati Robert Voight nga Holdingfordi raporton mbi përvojën e vet:

"Fenomeni i pushimit në Shpirtin Shenjt ka ardhur në St. Cloud në Minnesotë rreth 1980-ës, kur ati Luke Zimmer nga Kalifornia ka mbajtur misionin në Gilman. Pas Eukaristisë, i bekoj njerëzit me reliktet e Kryqit të Vërtetë dhe ata filluan të "palosen" njëri pas tjetrit. E pashë këtë, u mrekullova dhe dëshirova që edhe vetë ta përjetoja. Një mbrëmje shkova në Gilman, u luta për atë përvojë dhe pranova bekimin e atit Luke. Asgjë nuk ndodhi as jashtë as në zemrën time, së paku aq sa unë isha i vetëdijshëm. Më përfshiu dëshpërimi.

"Një vit më vonë ati Luke mbajti misionin në famullinë time të Engjëjve të Shenjtë në St. Cloud. Dhe përsëri pas Meshës të gjithë i bekoj me relikte. Filloi nga meshtarët në presbiter. Ati Mark u rrëzua me zhurmë të qartë të rënies. Ati Luke mu afrua. U rrëzova para se të më prekte. Ishte me nguti, shpejt dhe papritmas. Në njëfarë mënyre nuk e ndieja vetin mirë para besimtarëve, por megjithatë e ndieja paqen. Dëshirova që ashtu të qëndroj gjatë. Kur u ngrita, isha i kënaqur se e përjetova atë përvojë. Në ndërkohë ky fenomen u përsërit edhe disa herë. Shpesh kur i bekoj njerëzit dhe i vërshon Shpirti Shenjt, më dëshmojnë se si janë shëruar.

"Kam vërejtur se Shpirti Shenjt gjatë asaj kohe mund të veprojë më shumë për të mirën e personit. Ashtu si Shpirti Shenjt në mënyrë të efektshme mundet të veprojë kur njeriu është në gjumë, kur mendja është e qetë, po ashtu mund të veprojë më mirë kur trupi është i qetë. Ashtu si tha një autor, 'Kur Zoti bën operacion, dyshemeja është tavolina e Tij e operacionit.'

"Personalisht e konsideroj ngushëllim të madh praninë e këtij fenomeni në Kishën tonë. Në kohën kur feja është shumë e dobët, kemi nevojë për dhurata të veçanta sikurse kjo. Nuk e kam zakon të lutem për pushim në Shpirtin Shenjt në tubime të mëdha ku të gjithë nuk kanë besim të fortë, por në grupet karizmatike ose me individët, e lus Zotërinë që kjo dhuratë të bëhet e dukshme. Njëkohësisht përkujtoj se nuk duhet që theksi të bie mbi vetë dhuratën aq sa në atë që ndodh përbrenda. Rritja e besimit, rritja e dashurisë hyjnore, shërimi i shpirtit dhe trupit – këto janë vlera të vërteta. Duke mos e nënvlerësuar vetë shenjën, përqendrohëm në ndryshimin e zemrës."

"E thërrasin 'motra Haleluja' ..."

rregulltarja nga Portoriko sjell tregimin e vet

Motra Carmen Parilla punon në kopshtin e fëmijëve Montessori në Menlo Park, Kaliforni, merret me udhëheqjen e bashkësive spanjolle të lutjeve dhe viziton spitalet dhe burgjet me qëllim lutjeje dhe shërbese të shërimit. Si e vetmja motër karizmatike në rregullin e vet, ka marrë nofkën 'motra Haleluja' nga motrat tjera në kuvendin e vet. Këtu paraqet disa përvoja të pushimit në Shpirtin Shenjt.

"Isha anëtare e bashkësisë së lutjes nja gjashtë muaj, kur shokët e mi më çuan në takim me një laik të shërbesës së ungjillëzimit në një kishë katolike në San Francisko. Ai ishte seminar i shërimit dhe njerëzit që i afroreshin për lutje, binin në dysheme. Kurrë askush nuk ma ka përmendur atë fenomen dhe mendoja se ai vetë po i shtyn në dysheme. Mendova, 'Unë nuk shkoj atje!'

Dikush në bashkësi tregoi vizionin në të cilin engjëlli i Zotit zbriti dhe i spërkati njerëzit me vaj. E pashë vajin në disa Bibla dhe e dita se po ndodh diçka e fuqishme.

"Dikush më nxiti të shkoja në lutje. Në fillim u përmbajta, por, megjithatë, më vonë vendosa të shkoj. Ai ungjilltar, shumë lehtë, m'í vuri tre gishtërinj në ballë dhe tha, 'U shërove.' Rashë në dysheme. Një njeri më mbuloi me batanije dhe më la të shtrirë ashtu.

"Derisa qëndroja e shtrirë në dysheme, kisha vizionin se si rreth meje qëndrojnë njerëz të veshur në të bardha. I pashë engjëjt se si zbresin dhe bekojnë njerëzit. Tërë kohën e dija se jam e zgjuar, por kurrsesi nuk mund të ngrihesha.

"Kisha ishte gati e zbrazët, kur një njeri mu afrua dhe më ndihmoi të zgjohem. 'Si ndihesh?' – më pyeti. 'Mirë jam.' 'Duhet të shkosh tani. Ke pushuar gjatë. Zoti të bekoftë.'

"Ajo ishte përvoja më e bukur që e kam përjetuar ndonjëherë. Ndjehesha mrekullueshëm! Qysh atëherë jam e sigurt në dashurinë që Zotëria ka për mua. E di se më do me të vërtetë.

Pak kohë më vonë kam marrë pjesë në seminarin e Jetës në Shpirtin Shenjt në gjuhën spanjolle dhe fillova të lutem për njerëzit. Ndjenin se si prej duarve të mia dilte ngrohtësia dhe hynte në ta. Edhe ata atëherë pushonin në Shpirtin Shenjt, ashtu si ishte rasti me mua.

Nganjëherë thoshin, 'Lutu për mua, por nuk dëshiroj të rrëzohem.' Përgjigjesha, 'Është me rëndësi të mos i rezistosh Shpirtit Shenjt. Por të lëshohesh në dorë të Zotit që fuqia e tij të veprojë, pikërisht kjo është me rëndësi. Nuk është e domosdoshme të pushosh në Shpirtin Shenjt të shërohesh, por ji i hapur të pranosh shërimin.' Në bazë të përvojës sime, shumica e njerëzve që pushon pranon njëfarë lloj shërimi, sepse i janë hapur dhe e kanë lënë veten në duart e pushtetit të Tij shërues. Nganjëherë njerëzit në vete kanë mëkate dhe nuk dëshirojnë të falin, e atëherë Zotëria vështirë mund t'í lirojë. Kur i dorëzojnë të gjitha dhe e lejojnë Atë të veprojë, diçka në ta i nxiti t'iu bëjnë mirë të tjerëve.

"Një ditë më erdhi një grua dhe më tregoi se si mjeku i ka thënë se nuk mund të ketë fëmijë. Kur u luta për të që t'í krijohej mundëdis të ngjizej, pushoi në Shpirtin Shenjt. Vitin tjetër, kur erdha në Shtëpinë e takimit Vallombrosa në Menla Park, mu afrua një grua me një vajzë të mrekullueshme sy kaltër. Më pyeti se a jam unë motra Carmen. Kur pohova, më tregoi se jam lutur një herë për të që të kishte mundësi të ngjizej. Pak kohë më pas, vërtet mbeti shtatzënë.

"Kam shumë dëshmi të mrekullueshme të lirimit nga shortitë, nga droga dhe xhindosjet, pikërisht nëpërmes të pushimit në Shpirtin Shenjt pas lutjes sime. (Në shumicën e rasteve është fjala për shërimin shpirtëror dhe emocional.) Nuk e di se si e bën Zotëria këtë, nuk ka shpjegime për atë që bën, por dëshiroj të jem 'motra Halleluja' dhe të shikoj se si Zoti vepron në mënyrë të mrekullueshme."

"Zoti në mirësinë e Tij..."

mendime dhe dëshmi të atë Ralph DiOrio

Atë Ralph DiOrio në veprën *Mrekullia që duhet predikuar* mendon për urinë universale të njerëzimit për prekjen e Zotit të gjallë.

"...Njerëzit vijnë (në Meshët e shërimit) për shkak të fuqisë dhe pushtetit të shërimit të Shpirtit Shenjt, i cili banon te qenia e nxënësve të sotëm. Nuk është me rëndësi se sa është numri i të tubuarve, i vogël apo i madh - mbetet fakti që Zoti është i gjallë, se fëmijët e Zotit varen nga fuqia e Tij.

"Kur jetët njerëzore tubohen së bashku në praninë e Shpirtit Shenjt, Zoti i prek në një mënyrë pozitive. Ata njerëz atëherë do ta pranojnë mirësinë e Zotit. Në çdo njeri ka njëfarë besimi. Ai besim mund të jetë i ngulfatur, i mbuluar me "pluhurin" e pakujdesisë gjatë viteve, i hutuar dhe i paqartë, madje edhe i fikur me qëllim, por është aty! Pret vetëm momentin të zbulohet me një lloj pohimi. Njerëzit janë njësoj gjithandej. Të gjithë kanë të njëjtën etje dhe të njëjtin reagim si në ungjillëzimin individual si në atë masiv. Dëshirojnë me gjithë shpirt 'Lajmin e Gëzueshëm'.

Në atë libër atë DiOrio sjell edhe dëshmitë e ardhshme mbi shërimet gjatë pushimit në Shpirtin Shenjt.

“Shtatëmbëdhjetëvjeçari me kancerin në gju: ...Kur Dani u ngrit dhe u mbështet në paterica, babai iu afrua dhe i ndihmoi të shkonte deri te anija qendrore e kishës... Derisa meshtari lutej, djali im ra në shpinë dhe pushoi në Shpirtin Shenjt... Më vonë Dani ka treguar si i ka kaluar ngrohtësia nëpër këmbë.” (Dani u shërua).

Djaloshi me tumor të pa operueshëm në tru: “Derisa të gjithë luteshin (në Meshën për shërim në Massachusetts) ...e ledhatova djalin dhe fillova që në ballin e tij të vendosja këtë kryq që atë DiOrio e kishte bekuar. Derisa e lutsha Jezusin që ta shërojë, kryqi mu hoq nga dora dhe mbeti si i gozhduar në ballin e djalit tim... ai u rrëzua prapa dhe pushoi në Shpirtin Shenjt. Kur u ngrit, tha se dhembjet në kokë ishin të padurueshme. Kjo nuk ishte e zakonshme, sepse para pushimit nuk kishte dhembje fare. ‘Më dukej se mesi i kokës po më eksplodon’ na tha. Pikërisht në mes të kokës kishte tumorin...Tumori i tij jo vetëm se nuk u rrit më, por edhe u zhduk fare...”

Rregulltarja me krah të lënduar dhe me nevojë të shërimit të brendshëm. Derisa pushonte në Shpirtin Shenjt në Meshën e shërimit, kishte përvojë të thellë të Zotërisë. “...kur erdha në vete atë Ralph kishte shkuar, por Zoti në mirësinë e Tij ishte kujdesur që aty të jetë atë Mike. Ashtu si bariu i mirë përqafton delen e humbur, ashtu edhe ai më përqaftoi me butësi derisa qaja pa pra. Atë mbrëmje e pranova shërimin e brendshëm, Zoti i kishte shëruar plagët e zemrës sime.” Të nesërmen në meshën private atë Ralph, u lut përsëri për të dhe ajo përsëri pushoi. “Kur u ngrita shkëlqejta, e krahu më ishte shëruar. Ai në dashurinë e Tij të amshuar e kishte shëruar krahun tim. Dhe çka është më e rëndësishme e kishte shëruar besimin tim të dobët!”

*“Bekoje shpirti im Zotin
dhe krejt qenia ime Emrin e tij të shenjtë!”
(Ps 103,1)*

“Argumenti qëndronte në përvojë...”
një skeptik irlandez sjell tregimin e vet

Ati John Kenny, SS.CC. nga Oakland në Kaliforni paraqet përvojën e vet:

“Përvojën e pushimit në Shpirtin Shenjt të parën herë e kisha në ushtrimet shpirtërore të bashkësisë sonë. Një pjesë e ushtrimeve shpirtërore përfshinte lutjen për ata anëtarë të bashkësisë, të cilët e dëshironin këtë. Derisa nga fundi i kishës shikoja njerëzit tanë që shkonin në lutje, isha i vendosur se unë nuk do të shkoj. Vendimi im ishte i përforcuar kur pashë se si një nga vëllezërit tanë ra në dysheme dhe vazhdoi të qëndrojë i shtrirë në shpinë. Më kujtohet se mendoja se dikush e kishte shtyrë. Sikur ta kisha ditur se kjo do të ndodhë edhe në ushtrimet tjera shpirtërore, kurrë nuk do të kisha shkuar.

“Herën tjetër kjo ndodhi në seminarin të cilin e mbajti ati DeGrandis. Në seminar shkurtimisht e shpjegoi pushimin në Shpirtin Shenjt e atëherë na ftoi që ta provojmë duke iu dorëzuar asaj karizme. I dha disa citate nga Bibla, - p.sh. atë kur Shën. Pali ka rënë për tokë. Nuk i kushtova shumë rëndësi atij predikimi, sepse nuk e kisha ndërmend të bie në shpinë. Megjithatë, konsideroja se është detyra ime kur shikoja meshtarët tjerë se si shkojnë. U nisa përpara duke mos pritur asgjë, përkatësisht, ndoshta do të më shtyjnë, do ta humbë drejtpeshimin dhe do të rrëzohem. Me falënderim vëreja si pas meje e vendosi njërin, i cili do të duhej të më mbante. Derisa lëvizte përgjatë radhës, vëreja se shumë vetë ranë. Mendoja se sigurisht janë nën ndikimin e sugjestionit. Aq shumë kanë dëshiruar aq sa tani shtiren. Kur erdhi radha te unë isha nervoz: për shkak të rënies, si edhe për shkak të mungesës së rënies. Nëse nuk bie, a do të thotë kjo se kam ndonjë të metë? Ati DeGrandis mu afrua dhe filloi të lutet për mua duke mbajtur dorën e djathtë disa centimetra nga balli im. Ndjeva se po bie prapa, - gati si pezull, ndërsa ai nuk më

preku as me gisht. Disa minuta pushova në dysHEME, plotësisht i qetë, krejtësisht i vetëdijshëm për çka po ndodhte rreth meje.

“Qysh atëherë kam pushuar shpesh herë në Shpirtin Shenjt dhe gjithmonë kam pranuar shërim. Shpesh, kur lutem për njerëz, ata pushojnë në Shpirtin Shenjt. I gëzohem fuqisë së Shpirtit Shenjt në vepër. Për mua argumenti qëndron në vetë këtë përvojë.

“Është interesant, se shumica e meshtarëve kanë qëndrim negativ për pushimin në Shpirtin Shenjt, për deri sa edhe vetë nuk e kanë provuar. Ndoshta është kështu për shkak se e tërë qasja e tyre ndaj Zotit është më shumë intelektuale se sa nga përvoja. Shumë meshtarë më kanë thënë se gjatë shkollimit kurrë nuk kanë mësuar të luten. Ati Karl Rahner, jezuit, teolog i njohur gjerman, ka thënë se i krishteri i ardhmërisë do të jetë mistik, ose nuk do të ekzistojë fare. Si duket, kjo do të thotë se të krishterët do të jenë njerëz të përvojës së thellë fetare. Kisha e ardhmërisë do të jetë Kisha e përvojës së thellë fetare. Pushimi në Shpirtin Shenjt do të jetë pjesë e atij stili të jetës.

“Do të përkulet çdo gju...”

raste nga shërbesa e atë Rick Thomas në El Paso

Në vendin El Paso në Teksas, në kufirin meksikan, aktiviteti i atit Rick Thomas është legjendar. Rene Laurentin, teolog i njohur, për te flet në veprën e tij *Mrekulli në El Paso?* Në vazhdim sjellim dy dëshmi.

“Diku në vitin 1978., drejtori i burgut të Juarez, Jesus Galindo Fernandes, ka ardhur në qendrën e Zonjës për të rinj të kërkojë ndihmën e Rick Thomas – it.

“Ata njerëz nuk kanë shpresë, janë të papërmirësueshëm’, tha ‘vetëm forca e Zotit mund t’i ndërrojë. Dëshirojmë të vini dhe të na ndihmoni ashtu si të dini.’

Që të jemi të përgatitur për këtë mision, bashkësia ka zhvilluar ushtrimet shpirtërore në pronën e Zotit prej 17.-19. gusht 1979.

“Takimi i parë ishte i papërskrueshëm - Shkruan Rick Thomas. Vendi kundërmonte me qelbësirën e urinës. Të burgosurit çirreshin kundër nesh, na përqeshnin dhe na shanin. Përkundër altoparlantëve që i kishim marrë me vete, zërat nuk na dëgjoheshin nga ajo zhurmë e madhe.”

“I bindur se Zotëria mund të bëjë të pamundurën, kori që kishte ardhur me ne filloi të këndojë këngën e bazuar në Letrën dërguar Filipianëve 2,10-11: (...) se në emër të Jezusit do të përkulet çdo gju të atyre në qiell, në tokë dhe në nëntokë dhe çdo gjuhë do të dëshmojë: Jezu Krishti është Zot! – në nder të Hyut Atë.”

“Pas një orë e gjysmë ato fjalë u realizuan. Një numër i madh të burgosurish qanin të gjunjzuar. Tendosja që mbretëronte në fillim ia liroi vendin qetësisë së gjithëmbarshme, - njëfarë lloj ‘pavetëdijeje’ të lehtë dhe të butë. Disa prej tyre shijuan këtë, e cila në lëvizjen karizmatike quhet ‘pushim në Shpirtin Shenjt’.

“Në këtë situatë, rojet, të cilët në fillim ishin shumë të kujdesshëm, ia hapën vizitorëve një qeli. Të burgosurit ‘vërshuan’, duke kërkuar të lutemi mbi ta, për ta dhe me ta. Rreth nesh u tubuan nja tridhjetë e pesë dhe shumë prej tyre e përjetuan Zotin në mënyrë të thellë.’

“Drejtori ishte i mahnitur dhe tha se të parët janë afruar pikërisht të burgosurit më problematikë.”

"Prandaj edhe Hyu e lartësoi tesve

Dhe i dha emrin që është mbi çdo emër

Që në emër të Jezusit

Të përkulet çdo gju

I atyre që janë në qiell, në tokë e në nëntokë"

(Fil 2, 9-11)

Ati Rick Thomas tregon gjithashtu për ndërmarrjen e Zotit në mesin e delikenteve të rinj.

"Me datën 9 shkurt 1981, erdhi drejtori i Shkollës për rehabilitimin shoqëror të të miturve me kërkesën për ndihmë. E pranuar. Ajo ishte 'shtëpi' për 'të mbrojturit e rinj meksikanë pranë lumit Rio Grande, afër kufirit që ndan Meksikon me Teksasin. Atje shkojmë çdo të hënë. Fillojmë lutjen përjashta, akoma pa hyrë në ndërtesën e bardhë. Pastaj i biem ziles dhe fillon aksioni. Janë nja shtatëdhjetë djelmosha dhe disa vajza: me rastin e numërimit të fundit ishin saktësisht shtatë. I ndajmë në tri grupe, ashtu si janë të ndarë aty ku i mbajnë. Vazhdojmë në mënyrë të ngjashme sikurse bëjmë në burg, me disa përshtatje.

"Së pari i nxisim fëmijët të këndojnë dhe lavdërojnë Zotin. Pastaj, u tregojmë se si Zoti i do, e si dëshiron t'ju ndihmojë, me qëllim që ta ndërrojnë jetën e tyre. Pastaj e marrim secilin veç e veç - së paku ata që dëshirojnë - dhe i mësojmë të luten. E lusin Zotërinë që t'ua ndërrojë zemrën dhe çdo javë jemi dëshmitarë të përvojave të thella të Zotit. Kjo është ana e ndritshme e dërgimit tonë.

"Çdo të hënë, 80% të të mbrojturve të rinj në ndërtesën e bardhë i dorëzohet lutjes.

Është pamje mahnitëse t'i shikosh ata fëmijë, që përndryshe janë të tendosur dhe të pikëlluar, se si pushojnë në Shpirtin Shenjt. Qëndrojnë të shtrirë në dyshtet e betonit, nganjëherë edhe nga një orë e më tepër. E kur të ngrihen, janë ndryshe, të mbushur me shpresë dhe qetësi. Pas një shërimi të tillë të brendshëm, dëshmitë e tyre janë pikërisht 'infektuese'. Doktor R. P. Lopez, drejtor i shkollës për rehabilitim shoqëror, është shumë i kënaqur me rezultatet dhe bashkëpunon me ne. Klima është ndërruar krejtësisht aty.

"Drejtori na ka lutur të vijmë çdo ditë e jo vetëm një herë në javë., por ku ta marrim kohën? Deri tani nuk kemi mundur ta bëjmë këtë."

*"...Do të galdojë për ty hareshëm,
i përmalluar nga dashuria..."*

(Sof. 3,17)

"Kuptimi im i pushimit në Shpirtin Shenjt ..."

Raport i një ipeshkvi të kujdesshëm nga Kalifornia

Ipeshkvi Donald Montrose nga Stocktoni në Kaliforni është i kyçur në Ripërtëritjen Shpirtërore që nga viti 1978. Në famullinë, në të cilën ka shërbyer më parë, një herë në javë tubohej në lutje, një numër bukur i mirë njerëzish. Komentet e ardhshme mbështeten në vërejtjet e tij, si pjesëmarrës i rregullt i atyre takimeve.

"Nuk e konsideroj pushimin në Shpirtin Shenjt të dobishëm për grup të madh të lutjes. Ka aq shumë njerëz që pyesin vetveten se çka po ndodh dhe aq pyetje paraqiten në kokat e atyre që janë të rinj ose që kanë ardhur jo shumë kohë më parë, sa që mendoj se efekti është shumë i zvogëluar. Prandaj jam përpjekur t'i shmangem pushimit në Shpirtin Shenjt aq sa ka qenë e mundur. Kur takimi i lutjeve përfundonte dhe kur përfundonin koha e rregullt e lutjes dhe Meshja, gjithmonë pasonte lutja e veçantë. Zakonisht njerëzit, të cilët vinin në lutje të veçantë, i drejtoja të gjunjëzohen para altarit ose të ulen në bankë apo karrige. Me këtë, pushimi në Shpirtin Shenjt reduktohej në minimum. Mirëpo, edhe në ato rrethana kishte njerëz që pushonin në Shpirtin Shenjt.

"Për këtë arsye, besoj se është fjala për përvojë të denjë për t'u besuar. Nëse Zotëria do që dikush të pushojë në Shpirtin Shenjt, nuk mund të bëhet asgjë, përkundër të gjitha masave të kujdesit që ndërmerren. Ajo që ndodh kur njerëzit pushojnë në Shpirtin Shenjt, nuk është

gjithmonë e qartë. Përgjithësisht mendoj se ndodh shërim i brendshëm dhe njerëzit pasi 'zgjohen' janë shumë më të qetë.

"Ka edhe disa gjëra negative, të cilat ndodhin kohë pas kohe kur njerëzit pushojnë në Shpirtin Shenjt... Nuk jam i sigurt cili është shkaku i atyre paraqitjeve (shiko kap. 6 për komente të tjera në lidhje me gjërat 'negative' të cilat mund të ndodhin me rastin e pushimit në Shpirtin Shenjt.) Mirëpo, konsideroj se njerëzit janë të ngathët (të paaftë) në aspektin shpirtëror me rastin e pushimit në Shpirtin Shenjt (nuk mund të kundërshtojnë, mbrohen) dhe nëse në ndonjë kuptim ka prirje të tilla, paraqiten ndikime negative shpirtërore. Kjo është edhe një arsye për shkak të të cilës mendoj se pushimi në Shpirtin Shenjt kryesisht nuk është i dobishëm në grupe lutjesh të mëdha."

"Me siguri është fjala për sasinë e sheqerit në gjak..."

atë Tom raporton nga New Yorku

Atë Tom McCormic nga Medfordi në shtetin New York paraqet mendimet dhe përvojat që pasojnë:

"Të parën herë kur kam dëgjuar shprehjen 'pushim në Shpirtin Shenjt' ishte pranvera e vitit 1974. Duke qenë se kisha fituar pagëzimin në Shpirtin Shenjt disa vite më herët dhe pasi kisha kaluar katër vjet në forcat ajrore, përfundoja semestrin e dytë të vitit të parë në njërin prej fakulteteve të këtushme. Disa prej nesh vendosën të marrin pjesë në tubimin e universitetit Notre Dame të mbajtur me 1974. Për deri sa udhëtonim atje, një vajzë që ishte me ne na tregoi përvojën e vet të 'pushimit në Shpirtin Shenjt' në kishën e afërt fundamentaliste. Reagimi im i parë ka qenë pyetje e pakëndshme: Athua për çka është fjala?"

"Më ka shpjeguar se në një moment gjatë shërbesës njerëzit kanë qenë 'të vërshuar me Shpirtin Shenjt', ashtu si u shpreh vetë. Reagimi im ka qenë i shënjuar me pyetje dhe brengë. Sa më shumë që ajo grua fliste për përvojën e vet 'të pushimit në Shpirtin Shenjt', aq më shumë ne hutoheshim. Na tha se njerëzit bien në dysheme dhe të tjerët i mbajnë. Ishte e vështirë për t'u kuptuar. Në fillim dyshova se ajo duhet të jetë diçka karakteristike për kishat protestante. Sa gabim e paskam pasur!

"Të parën herë kam parë se si duket pushimi në Shpirtin Shenjt në një tubim në Atlantic City më 1977. Ishte një pasdite e kthjellët me diell. Njerëzit e lavdëronin Zotërinë në shëtitore. Miku im Richie dhe unë vendosëm të shëtisim dhe të kënaqemi në praninë e Zotit. Nuk ishte e pazakontë të takoje grupe të vogla, të cilat këndonin së bashku, lavdëronin Zotin dhe luteshin. Mirëpo, vëmendjen ma tërhoqi një grup, i cili lutej për një grua. Derisa ata luteshin, pashë se si u rrëzua dhe u shtri në shëtitore. Reagova, duke vrapuar për t'i ndihmuar. Miku im Richie më tërhoqi prapa dhe më tha se ajo është e vërshuar me fuqinë e Shpirtit Shenjt. Më shpjegoi se çka ka ndodhur. Atëherë, përfundimisht kuptova se si Zotëria Jezu Krishti, nganjëherë vepron me forcë në ata, të cilët e përjetojnë atë përvojë.

"Me kohë e kam parë, madje edhe para shugurimit tim për meshtar, se Zoti vërtet vepron në atë mënyrë të veçantë në takimet e lutjes. Më kujtohen rastet kur jam lutur me disa njerëz të tjerë, se si e kam ndjerë një mbushje me forcë derisa luteshim. E kam ndjerë fuqinë e veprimit të Zotërisë me mijëra herë.

"Kam përjetuar po ashtu edhe shumë kritika nga vëllezërit meshtarë, si edhe nga disa intelektualë katolikë, të cilët e kanë pasur shumë vështirë të kuptojnë se diçka po u ndodh pikërisht atyre individëve. Deklaratat si: 'këto janë vetëm ndjenja', 'shtiren' dhe 'me siguri është fjala për sasinë e sheqerit në gjak', jo rrallë i kam takuar gjatë këtyre viteve kur lutem me njerëzit. Personalisht besoj se Zotëria ynë Jezuie vërtet vepron tek njerëzit, të cilët pushojnë në

Te. Kam parë njerëz se si pushojnë edhe nga një orë, qoftë dhe vetëm disa minuta. Kam parë se si u ndërrohet shprehja e fytyrës, për deri sa Zoti vepron në ta.

“Më ka ndodhur që njerëzit të pushojnë në Shpirtin Shenjt në rrëfyestore, derisa i pranoin mëkatet e tyre dhe kërkonin falje nga Zoti. Lutjet e thjeshta të Kishës u kanë bërë përshtypje të thellë dhe janë liruar, në heshtje, ulur në karrige. Më ka ndodhur po ashtu të lutem për njerëzit nëpërmes të telefonit dhe ata të pushojnë në Shpirtin Shenjt. Por, gjithsesi, dëshiroj t’u tërheq vërejtjen atyre që e lexojnë këtë, se, para së gjithash, nuk është fjala për ne, sepse ne jemi të gjithë mëkatarë, edhe vetë kemi nevojë për ndihmën e Zotit dhe shërimin e Tij. Por, nëse Zoti vendos ta vërë veten në shfrytëzim nga një situatë të caktuar, qoftë nga bisedë, rrëfim ose shërbesë eukaristike, Ai do ta bëjë pikërisht këtë.

“Jam i sigurt se do të mund të paraqisja edhe shumë raste përvojash që i kam pasur me njerëzit gjatë këtyre viteve. Mund të them thjesht se Zoti vërtet vepron në këtë lëmi. Mirëpo, njerëzit duhet mësuar dhe duhet t’iu ofrohet kujdes i nevojshëm pastoral.

“Më së shumti më brengos fakt, pse disa njerëz pikërisht kërkojnë këtë përvojë. Duket se anojnë kah ajo. Duan të bien dhe ta përjetojnë atë ndjenjë, duke lënë mënjanë të vërtetën, besimin dhe qëndrueshmërinë që vjen nga të jetuarit e vazhdueshëm me Jezu Krishtin.

“Shumë njerëz, pastaj, duke shikuar meshtarit dhe grupin që lutet, mendojnë me vete: ‘Të shkojmë te ata. Ata kanë forcën.’ Ose: ‘Të shohim se sa do t’i rrëzojë.’ Vështirësia që shoh në këtë kuptim është mbikëqyrja e nevojave reale dhe ndjeshmëria e tepruar që është e lidhur nganjëherë me dukurinë e pushimit në Shpirtin Shenjt. Shumë njerëz janë të tërhequr të shkojnë në seminarët e shërimit, por janë pak, të cilët janë të gatshëm të vendosin - për shembull - për takimet javore të lutjeve. Shumë njerëz vijnë në seminare ose Meshë të shërimeve të shikojnë e të shohin, të presin dhe të vështrojnë, para se të vendosin që ta vërtetojnë vetë se për çka është fjala. Disa njerëz më kanë thënë se kanë ardhur vetëm pse dikush u paska treguar se këtu njerëzit ‘bien’. Pasi e kanë pasur vështirë të besojnë, kanë ardhur të binden vetë.

“Besoj se duhet të përqendrohemi në Atë që e jep atë dhuratë, e jo në atë që lutet për të tjerët. Besoj se Zotëria, edhe njëherë po na tregon se duhet të jemi të varur prej Tij si prej Zotërisë dhe Shpëtimtarit tonë personal.

“Lutja ime është e njëjtë si gjithmonë: që ta shijojmë jetën, frymën dhe dhuratën e Jezu Krishtit si Zotëri, që ta shohim në çdo gjë që bëjmë. Të shohim forcën e Kryqit e jo ndjenjën momentale, sado e fortë të jetë. Lutja ime është që të kuptojmë se Jezu Krishti vepron edhe në situatat më të thjeshta dhe në rastet më të rëndomta.

“Më kujtohet kujdesi dhe brenga që e ka shprehur në lidhje me pushimin në Shpirtin Shenjt, atë George Maloney në revistën *Crux of the News* rreth 1980. Pajtohem dhe ia shtoj kësaj brengën dhe vërejtjen personale. Nëse njerëzit shkojnë në seminare dhe në Meshët e shërimit vetëm për të përjetuar atë ndjenjë të lartësuar dhe asgjë tjetër, do t’i lusja që ta shqyrtojnë qëndrimin e tyre. Zotëria le të jetë Zotëri. Le të veprojë Zotëria në zemrat e popullit të vet. Zoti edhe do ta bëjë këtë. Nuk e bën këtë asnjë meshtar, asnjë rregulltar, asnjë laik, por Zotëria. Të gjithë jemi të thirrur të lutemi njëri me tjetrin dhe njëri për tjetrin dhe do të dëshiroja të shtoj se lutja ime është që të kërkojmë misteret, të kërkojmë të vërtetën dhe të lusim Nënë tonë Marinë të ndërmjetësojë për ne.”

“Rrëzimi nuk është pushim...”

atë Jim nga Skotlanda sjell një vërejtje

Në letrën botuesit të këtij libri, atë Jim McManus, teolog redemptorist nga Skotlanda, edhe vetë autor i disa librave, mendon në lidhje me qasjen e autorit të këtij libri përdorimit të karizmave dhe për paraqitjen e pushimit në Shpirtin Shenjt:

"...(Atë DeGrandis) është i vetmi mësues që njoh në kuadër të Përtëritjes në Shpirtin Shenjt, i cili e përshkruan këtë karizëm dhe flet se si të pranohet dhe si të shërbehemi me të. Na mëson që, si njerëz, të bëhemi të hapur për pranimin dhe realizimin e asaj dhurate. Më duket se shumica e njerëzve e lut Zotin për dhurata e atëherë pret nga Ai që t'ua bëjë me dije se i kanë pranuar. Ky vërtet nuk është besim. Besim ka, kur veprimi në harmoni me fjalët e Jezusit: 'kërkoni e do të merrni'. Dhurata e atit DeGrandis është që t'i bind njerëzit se dhuratat jepen pikërisht ashtu dhe si ato vepron. Kërkojmë e pastaj shërbehemi me to.

"Pushimi në Shpirtin Shenjt për mua ka qenë gjithmonë problematik. Vetë fjala tregon se ajo që ndodh është vepër e Shpirtit. Dy vetë i qasen lutjes. Njëri bie e tjetri qëndron. Nëse për të parin thuhet se 'pushon në Shpirtin Shenjt', a nuk do të mund të themi për të dytin se 'qëndron në Shpirtin Shenjt'?

"Kësaj çështje dëshiroj t'i qasem në mënyrë përshkuese. Përshkruaj se çka ndodh. Njerëzit rrëzohen në shpinë. (Kjo vetvetiu ngjall hutesë). Ashtu si ka thënë John Richards, teolog anglikan, 'jemi ballafaquar me fenomenin e rrëzimit!' Tani duhet të dallojmë se çka po ndodh. Njerëzit zakonisht thonë se si e posedojnë përvojën e një paqeje të thellë, e një dëshire për lutje dhe afërsie të Zotit. (Edhe vetë e kam provuar). Nxitja në lutje gjithsesi është dhuratë e Shpirtit dhe, kur e përjetojmë këtë ndjenjë të afërsisë së Zotit, të shtrirë në dysheme, gjithsesi mund të themi se personi pushon në Shpirtin Shenjt.

"Problemi im qëndron në barazimin e dukurisë fizike të rrëzimit me veprimin e Shpirtit. Çdo dukuri në jetën shpirtërore, qoftë dhurata e gjuhëve ose dhurata e profecisë, në thelbin e vet është shumë kuptimore. Është i nevojshëm dallimi. Mund të burojmë nga Shpirti Shenjt, mund të vijë nga nënvetëdija, e mund të jetë edhe nga shpirti i keq. Ashtu si shkruajnë Ann dhe Barry Ulanov në veprën *Religjioni dhe nënvetëdija*:

'E pranojmë se "nënvetëdija" si term është shumë i kufizuar, por për momentin nuk kemi më të mirë. Shumë gjëra që feja ia përshkruan shpirtit, sigurisht se mund të gjenden në atë gjë që psikologjia e thellë e quan nënvetëdije.'

"Nuk shoh përse termi 'pushimi në Shpirtin Shenjt' të mos përdoret për personin, i cili është i shtrirë në dysheme, shumë i vetëdijshëm për dashurinë dhe praninë e Zotit. Ai person pushon në Zotin. Por, përdorimi i këtij termi për vetë dukurinë trupore, do të thoshte prejndikim i vetë çështjes. Rrëzimi nuk është pushim. Për të rënë, njeriu duhet të jepet i tëri dhe të dorëzohet dhe ai akt i dhënies së vetes dhe i dorëzimit rrjedh nga dhurata e mëshirës ose nga nënvetëdija.

Duke qenë se mund të burojmë nga nënvetëdija, personalisht nuk lutem për njerëz në mënyrë që ta nxisin këtë. Me fjalë të tjera, nuk i nxis njerëzit të më vijnë në lutje duke qëndruar në këmbë dhe me duar të hapura.

"Disa njerëz i sjellin shembujt biblikë të 'pushimit në Shpirtin Shenjt'. Më duhet të them se ato shpjegime më duken shumë të tendosura. Nuk konsideroj se ka në Bibël madje edhe vetëm një shembull të asaj që njerëzit në Ripërtëritje e quajnë sot 'pushim në Shpirtin Shenjt'.

"Duke i thënë të gjitha këto, dëshiroj të përsëris, se, kur jam rrëzuar dhe kam qëndruar i shtrirë në shpinë, kam shijuar paqe të madhe dhe nxitje në lutje."

/Atit Jim McManus do t'i përgjigjesha kështu: është e natyrshme të kemi frikë nga rënia në shpinë. Prandaj, nëse dikush bie në shpinë, për deri sa është i përqendruar në Jezu Krishtin, ka të ngjarë se është fjala për veprimin e Shpirtit Shenjt. Të dhënat tona statistikore flasin në dobi të këtij qëndrimi./

"Të lutem, a do të pushosh të thithësh pëlqerin?..."

Mendime personale dhe tregime nxitëse të motrës Fransis Clare

"Kur kam udhëtuar njëherë me Charles dhe Frances Hunter, thashë, 'nëse ekziston diçka që do të më frikësonte në shërbesën time të shërimit, atëherë kjo është që Zoti të më përdorë që njerëzit t'i fus në pushimin në Shpirtin Shenjt. Nuk konsideroj se ajo gjë është shumë katolike.' Kur fillova të lutem për ta, gjatë programit, që Zoti t'i prekë 'secilin dhe çdo gjë', pashë se si u derdh fuqia e mrekullueshme e Zotit. Shumë njerëz pushuan në fuqinë e Shpirtit. Fshehurazi dëshiroja që kjo të ndodhte pa Hunterët. Më vonë, kur u luta me grupet e lutjes të fakultetit në Minnesota, pashë të njëjtën dukuri. Fillova të vëreja dhe të kuptoja se kjo nuk ka lidhje me vetitë njerëzore..."

"...të përkujtoj ta ringjallësh dhuratën e hirit të Hyut që është në ty..."
(2Tim 1, 6)

Motra Francis Clare komenton vlerën e pushimit në Shpirtin Shenjt atje ku ka udhëheqje shpirtërore:

"Duhet të jemi shumë të ndjeshëm në kufizimet personale dhe të hapur ndaj dëshirës së Zotit për veprim sovran. Kur filloj të lutem, e bëj këtë me trurin tim natyror, por kur dëgjoj se Jezusi më thotë që t'i lejoj që Ai ta marrë udhëheqjen, i them personit për të cilin lutem se më duket se tani Jezusi do të dëshironte ta marrë çështjen në duar të Veta dhe do Ta lus të shtjerë në pushimin në Shpirtin Shenjt të japë vizion, fjalë dhe drejtim. Duke vepruar ashtu, unë tërhiqem dhe i lejoj Zotit të veprojë. Jam dëshmitare, se, shpesh, Ai brenda dy sekondash bën diçka që mua do të më duhej dy orë, dy ditë, dy javë, dy muaj ose dy vjet.

"për deri sa njerëzit pushojnë, duket se janë në gjendje të vetëdijes së lartësuar shpirtërore, në vendin ku mund të rrinë me Zotin dhe mund ta dëgjojnë. Nganjëherë shohin gjëra të cilat nuk mund t'i shohin nëse nuk janë nën fuqinë e Zotit. Prandaj i nxis njerëzit që t'i jepen pushimit, madje edhe nëse u duket se nuk po ndodh asgjë. Ndoshta do t'u vijë vetëm një mendim i vogël. I nxis që pastaj të jepen me atë mendim në bisedë. 'Zot, a po e bën Ti këtë?' Pastaj le të dëgjojnë. Ose Zoti mund t'u tregojë diçka, e ata atëherë mund Ta pyesin se çka do të thotë ajo.

"Lutem që Zoti t'i hapë në mënyrë sovrane për atë që Ai dëshiron të bëjë. I nxis të lëvizin në kahen që Ai u tregon. Shumë gjëra mund t'i zbulojnë nëse lejojnë që Shpirti Shenjt t'i udhëheqë prej hirit në hir dhe prej lavdisë në lavdi."

"E ne të gjithë, të cilët, me fytyrë të zbuluar, bredhim lavdinë e Zotit, me anë të Shpirtit të Zotit, shndërrohemi në të njëjtën trajtë – nga lavdia në lavdi."

(2 Kor 3. 18)

Ja një përvojë nga Gjermania:

"Më thirrën të marr pjesë në një tubimin të 1200 të rinjsh. Titulli i ligjëratës ishte: 'A do t'i lejonit Zotit t'iu dalë në ndihmë pikërisht aty ku jeni tani?' Derisa flisja me përkthim, ata u përgjigjën duke u ngritur në këmbë dhe duke thënë, 'Zot, të lejoj të më ndihmosh këtu ku jam tani.' E kjo 'tani' nënkuptonte shumë gjëra të ndryshme: disa e dinin se njerëzit e dinë se Zoti ekziston, por as ata vetë nuk e kishin shijuar kurrë. Disa bartnin në kokë një varg të vërtetash të veçanta. Disa kishin pasur ndonjë përvojë personale me Jezusin. Disa e kishin përjetuar plotësinë e Shpirtit Shenjt. Gjendeshin vërtet në situata të ndryshme.

"Pas ligjëratës, qenë të thirrur në vazhdimin e programit në katin tjetër. Së shpejti dhoma vlonte nga të rinjtë. Në pyetjen time se çka dëshirojnë, u përgjigjën 'Të gjitha!' U luta që ta njohin Jezusin, që ta njohin plotësinë e dhuratave, si dhe frytin dhe fuqinë e Shpirtit Shenjt. Për shkak të kufizimeve kohore dhe gjuhësore, u thashë se do të bëj që t'jë qëndrojë i ngritur Jezusi i Kryqëzuar, i cili është urtia e Zotit dhe fuqia e Zotit. U thashë se do t'i bekoj me Trininë –

Atin, Birin dhe Shpirtin Shenjt. U thashë se do ta lartësojmë Jezusin dhe do T'i lejojmë të bëjë çdo gjë që është e nevojshme në jetën e secilit prej tyre. I radhita dhe fillova t'i lyeja me vaj me fjalët, 'E lartësoj Jezusin.' Një nga një binin nën fuqinë e Shpirtit Shenjt. Jemi lutur pesë orë, e fuqia e Zotit vepronte në mënyrën, e cila do t'i hutonte edhe teologët. Nuk e kisha të vështirë të besoja se Zoti ashtu vepron në Gjermani. Nevojat ishin shumë të mëdha. Kur shoh veprimin superior të Zotit, me fuqinë që huton dhe mrekullon, vetëm them: 'Kjo është vepra e Zotit.'

"Kam parë se si Zoti vepron me fuqi të njëjtë nëpër kishat në mbarë Gjermaninë. Me qindra njerëz pushonin në Shpirtin Shenjt, derisa Zoti në secilin prej tyre bënte pikërisht atë që ishte e nevojshme. Edhe sikur të dija gjermanisht, kurrë as për afërsisht, nuk do të mund të kënaqja nevojat e gjithë atyre njerëzve.

"Njëherë tjetër, në Amerikë, mu afrua një rregulltare të lutesha për te. Nuk kisha kohë të lutem me te, prandaj ia sqarova këtë, duke i thënë se do të lutem shkurt dhe do ta lus Zotin që ta shtie në pushimin në Shpirtin Shenjt. I thashë të mos ngrihet pa e pyetur Zotërinë për këtë. Dhe ashtu u luta, e ajo u rrëzua nën fuqinë e Shpirtit. Tri orë më vonë erdhi të më tregojë se çka ka ndodhur. Më tha se së pari i ka thënë Zotërisë se është e uritur. Ai ka thënë, 'Psssst...' e pastaj ka filluar që t'i japë vizione, një pas një si në film. Pastaj më pyeti se çka do të thotë 'lirim' (nuk ishte e njoftuar me Ripërtëritjen). Në pyetjen time se përse dëshiron ta dijë këtë, mu përgjigj se Zotëria i ka thënë se po i ndodh pikërisht ajo gjë. 'Jam liruar nga frikët e mia, nga zemërimi, hidhërimi dhe inati.'

"U lirua nga gjërat të cilat e udhëhiqnin sjelljen e saj, e kjo ishte shkollë e vërtetë edhe për mua. Prej atëherë, kur lutem për njerëzit të pushojnë në Shpirtin Shenjt, i përkujtoj se mund të shkohet shumë më larg nga përvoja e fuqisë dhe pranisë së Zotit; ngrohtësisë dhe butësisë. Mund të kalojë nga përvojat pozitive në lirinë prej gjërave negative në jetët e njerëzve."

*"Kthehu, shpirti im, në qetësinë tënde,
sepse Zoti është bamirësi yt!"*

(Ps 116, 7)

"Kur jam lutur me familjet në një bashkësi, të rriturit kërkuan të lutem që fëmijët të pushojnë në Shpirtin Shenjt. Derisa lutesha për ta, vërejtja se një vajzë nëntëvjeçare një kohë të gjatë po pushonte me butësi. Kur u ngrit, e pyeta se a e ka parë Jezusin. U përgjigj pozitivisht. Kur e pyeta se çka i ka thënë, më shikoi pak dhembshëm dhe tha se Jezusi e kishte pyetur se 'a do të pushonte së thithuri pëlqyerin?'

Kur ma tha këtë, ishte vërtetim i bindjes sime se Jezusi njeh çdo instinkt të fshehur në jetët tona. Jo vetëm se i njeh, por dëshiron të na lirojë nga ato. Nuk kemi nevojë T'i themi. Madje nuk ka nevojë as ta dimë këtë derisa lutem të tjerët për ne, por Jezusi do të na vetëdijesojë për këtë. Do të thotë, 'A do të pushosh të thithësh pëlqyerin? A dëshiron të jesh i liruar nga ai perversion seksual, ose nga ajo urrejtje e gëposur thellë, ose nga diçka tjetër që të robëron?' Pasi e pashë këtë tek ajo vajzë, e pashë edhe tek shumë të tjerë në mosha të ndryshme. Atë të cilin e liron Biri, ai vërtet është i lirë. Pushimi në Shpirtin Shenjt është njëra prej mënyrave të shumta me të cilat njerëzit lirohen nga fuqitë e errëta, e sidomos ata, të cilët udhëhiqen nga hidhërimi, urrejtja dhe depresioni."

"Ngulni e shikoni se si sot do t'ju shpëtojë Zoti..."

(Dal 14, 13)

ANKETA

(edhe pak statistikë)

9. A keni pushuar në Shpirtin Shenjt pa u lutur dikush për ju?

Po	50%
Jo	47%
Pa përgjigje	3%

(Shihet për qindje më e madhe femrash se sa meshkujsh që kanë pushuar në Shpirtin Shenjt pa u lutur dikush për ta. Numrat tregojnë se 43% të meshkujve janë përgjigjur pozitivisht përkundër 50% të femrave.)

10. A keni pushuar në Shpirtin Shenjt kur keni qenë vetëm?

Po	41%
Jo	54%
Pa përgjigje	5%

11. A jeni të vetëdijshëm për ndonjë shërim më të madh që u ka ndodhur gjatë kohës së pushimit në Shpirtin Shenjt?

Po	54%
Jo	41%
Pa përgjigje	5%

(Numrat që kanë të bëjnë me meshkujt dhe femrat janë përafërsisht të njëjtë.)

...vazhdon

Pasqyrë e pikave kyçe

Ati Jack Soulsby

*Duhet të jemi të hapur dhuratës së pushimit në Shpirtin Shenjt dhe ta dëshirojmë sa më shumë.

*Është me rëndësi të lidhet teoria me përvojën personale dhe me dëshmitë.

*Shpirti Shenjt mund të veprojë mirë brenda nesh, kur jemi të liruar.

*Kur feja është e dobët, na duhen dhurata të veçanta, siç është pushimi në Shpirtin Shenjt.

*Rritja e fesë dhe dashurisë që ndodh kur pushojmë në Shpirtin Shenjt, mund të jenë me vlerë të madhe.

*Pushimin në Shpirtin Shenjt do të duhej mundësuar vetëm brenda bashkësisë që dallohet me besim.

Motra Carmen Parilla

*Duhet të jemi të hapur për shërim, pushuam apo s'pushuam në Shpirtin Shenjt.

*Shumica e njerëzve që rrëzohen, do të pranojë ndonjë lloj shërimi, sepse ia kanë dhënë veten dhe i janë hapur fuqisë së Tij shëruese.

Ati Ralph DiOrio

*Kur njerëzit tubohen në praninë e Shpirtit Shenjt, Zoti i prek fuqishëm.

*Besimi i mbuluar me "pluhur", i pashfrytëzuar, mund të ngjallet në rrethana të volitshme.

*Dëshmitë për shërim na ndihmojnë për të besuar se Zoti është i gjallë.

Ati John Kenny

*Duhet të përjetojmë pushimin në Shpirtin Shenjt, para se të sjellim çfarëdo gjykimi personal.

Ati Rick Thomas

*Edhe njerëzit më problematikë shkrihen para dashurisë së Jezusit

Ipeshkvi Donald Montrose

*Nuk besoj se pushimi në Shpirtin Shenjt është i dobishëm për tubime të mëdha.

*Përgjithësisht, duket se, me rastin e pushimit në Shpirtin Shenjt, ngjajnë shërime të brendshme dhe paqe e thellë.

*Me rastin e pushimit në Shpirtin Shenjt mund të vërehen edhe ndikime negative.

Ati Tom McCormick

*Jezusi shpesh vepron me fuqi e forcë, kur njerëzit pushojnë në Shpirtin Shenjt.

*Duhet të kemi kujdes në keqpërdorimet e mundshme.

*Ka nevojë e madhe për mësimin dhe ofrimin e kujdesit pastoral në këtë fushë.

*Duhet të përqendrohemi në Atë që jep dhuratën.

Ati James McManus

*Nuk është i nevojshëm barazimi i domosdoshëm i përvojës fizike të rënies me veprimin e Shpirtit.

*Në veprimtarinë time nuk i nxis ngjarjet e tilla.

*Personalisht, me rastin e pushimit në Shpirtin Shenjt, kam përjetuar paqe të madhe dhe frymëzim për lutje.

Motra Francis Clare

*E lus Jezusin që njerëzit t'i pushojë në Shpirtin Shenjt, kur ndiej se dëshiron ta marrë kontrollin.

*Derisa njerëzit pushojnë në Shpirtin Shenjt, Jezusi i liron nga gjërat negative në jetën e tyre.

*Dëshiron të na lirojë nga ajo që e kontrollon jetën tonë dhe veprat tona.

Lutja

Atë Qiellor, dëshiroj Të të dorëzohem në një nivel më të thellë. Bashkë me atin Jack Soulsby-rin, dëshiroj të jem i hapur pushimit në Shpirtin Shenjt. Bashkë me atin Robert Voight-in, dëshiroj të përqendrohem në ndërtimin e fesë. Me motrën Carmen Parilla, dëshiroj të jem i hapur fuqisë Sate shëruese. Bashkë me njerëzit për të cilët flet ati Ralph DiOrio, dëshiroj që t'i shijoj mrekullitë, shërimin dhe lirimin nga ngarkesa. Së bashku me të burgosurit për të cilët flet Rick Thomas, dëshiroj të jem ashtu i prekur, të qaj i gjuhëzuar dhe ta shijoj ndërrimin e zemrës. Bashkë me ipeshkvin Donald Montrose-n, dëshiroj të arrij drejtpeshimin e hapjes dhe të kujdesit të arsyeshëm. Bashkë me atë Tom McCormick-un, dëshiroj të përqendrohem në Atë që e jep dhuratën. Bashkë me atin James McManus, dëshiroj dhuratën e nxitjes për lutje. Në fund, së bashku me motrën Francis Clare, dëshiroj të jem i hapur krejtësisht ndikimit Tënd sovran në jetën time. Të falem nderit, Atë Qiellor. Të falem nderit, Jezus. Të falem nderit, Shpirti Shenjt. Amen.

“...që Hyu i Zotit tonë Jezu Krishtit, Ati i Lavdisë, t’ju japë Shpirtin e dijes e të zbulesës për ta njohur Atë; t’ju japë syve të zemrës (së tuaj) dritë, të mund ta kuptoni shpresën e madhe që e

jep thirrja e tij, begatinë e pakufishme të trashëgimit të tij ndër shenjtër dhe madhërinë e pamasë të fuqisë së tij kundrejt nesh që besojmë,...

(Ef. 1, 17-19)

5. Ai më prin shtigjeve të drejta

*"O Zot, ti më shqyrton e më njeh,
ti di kur rri e kur ngrihem,
prej së largu i njeh mendimet e mia.
Si në shtegtoj si në pushoj, ti më vëren,
ti i di të gjitha udhët e mia."*

(Ps 139,1-3)

Në këtë kapitull do t'i sjellim disa mendime mbi lidhjen e dinamikës psikologjike me pushimin në Shpirtin Shenjt. Punëtorët shëndetësorë do të përgjigjen në disa pyetje të anketës, do të japin disa rekomandime dhe do të ndajnë me ne përvojat e tyre personale.

"Shqyrtoni pushimin tim..."

disa lëmi kundërthënëse

Disa udhëheqës të Ripërtëritjes shpirtërore brengosen se pushimin në Shpirtin Shenjt nuk e nxit Shpirti Shenjt, por është fjala për një përzjerje të caktuar. Autori i një artikulli në revistën New Covenant kështu e komenton atë qëndrim:

"...Njerëzit tjerë kanë rezerva të caktuara në lidhje me këtë dukuri. Kjo përvojë i përkujton shumë në gjendjen e hipnozës dhe autosugjestionit që nuk janë domosdo të lidhura me Shpirtin Shenjt. Dyshojnë seriozisht në themelet e kësaj dukurie në Shkrimin Shenjt dhe kanë rezerva serioze përkitazi me faktin se sa qëndron arsyeja e mbështetjes në kuptimin pastoral.

Kardinali Suenens në veprën *Dukuria kontraverze, pushimi në Shpirtin Shenjt*, përfundon se tendenca kah rrëzimi mund të lidhet më shumë me dinamikën psikologjike se sa me veprimin e Shpirtit Shenjt dhe në këtë kuptim sjell vërejtjen: kam prirjen të besoj se shumica e përvojave të pushimit (por jo të gjitha) janë përvoja të Jezusit.

Atë Richard Bain nga San Francisco sjell këtë mendim: "Ndoshta është e vërtetë se shumicën e pushimeve në Shpirtin Shenjt i shkakton dinamika psikologjike. Ndoshta mjaft njerëz thjesht dëshirojnë të rrëzohen. Mirëpo, nuk konsideroj se kjo është arsye për brengosje, sepse, kur një herë të gjenden në dysheme, vërtet mund t'i hapen prekjes së Zotit. Mua personalisht nuk më intereson aq shumë fakti pse rrëzohen, por çka u ndodh kur janë poshtë.

"Kisha nuk është Zot, sakramentet nuk janë Zot. Rruzarja nuk është Zot., por secila prej tyre nxit dinamikën, e cila na ndihmon që ta takojmë Zotin. Besoj se edhe pushimi në Shpirtin Shenjt mund të na ndihmojë të takojmë Zotin. Të gjithë, me të cilët kam biseduar e kanë përjetuar si përvojë pozitive.

"Përvoja ime e parë e pushimit, tek ati Dennis Kelleher nga New Yorku, i ka hapur derën shërbesës sime të shërimit."

Tek pushimi në Shpirtin Shenjt, sipas gjasës, ekziston përzierja në mes të dinamikës psikologjike dhe shpirtërore, për shkak të lidhjes në mes të trupit mendjes dhe shpirtit. Ati George Maloney në artikullin "Si të kuptohet dhe të vlerësohet përvoja më e re e karizmatikëve: 'pushimi në Shpirtin Shenjt' thotë: "Dukurinë e pushimit në Shpirtin Shenjt nuk duhet vlerësuar se a është 'natyrore' ose 'mbinatyrore', e nxitur vetëm nga psika njerëzore ose shfaqje e plotë e fuqisë së Shpirtit Shenjt në mes njerëzve..."

Është edhe një lëmi kontradiktore që ka të bëjë me pushimin 'spontan' përballë atij 'të ndërmjetësuar'. Pushimi spontan kryesisht nuk është objekt kritike. Lëmi i konfliktit ka të bëjë me faktin se çka është e pranueshme në kuptimin e nxitjes së njerëzve që t'i hapen përvojës së pushimit me 'ndërmjetësim'. Konflikti shkaktohet, kur dinamika psikologjike kyçet në procesin e pushimit.

Besoj, se, t'iu ndihmohet njerëzve që t'i jepen Zotit, është akt pozitiv dhe konstruktiv. Mund të shtrojmë pyetjen se kujt ata ia dorëzojnë zemrën e vet dhe çfarë qëllimesh kanë. Pjetri e ka bërë hapin të ecë mbi ujë (Mt. 14, 29), e atëherë Zotëria e ka marrë çështjen në duar të veta. Zoti thotë, "O ju të gjithë që jeni të etshëm, ejani tek ujët..." (Is 55, 1). Ai thotë, "Ejani... e unë do t'ju çlodh" (Mt 11, 28). Kjo ardhje është përgjigje e natyrshme në thirrjen e Tij. Ai na thërret gjithmonë të dorëzohemi, e, kur ta bëjmë këtë, atëherë na shpie në sferat shpirtërore. Tek dhurata e gjuhëve, hapim gojën tonë trupore, e Ai na jep shprehje shpirtërore. Na thotë që t'i nxisim dhuratat. Ky është akt natyror në fazën fillestare. Ne atëherë bëjmë zgjedhje të brendshme, me të cilën nga veprimi në sferën natyrore, kalojmë në veprim në sferën shpirtërore. Kur vendosim të jepemi me besim, është si të themi, 'Më ço në shtëpinë tënde, Zotëri!' Ai e respekton zgjidhjen tonë.

Me vite jam lutur për njerëzit dhe i kam nxitur të jenë të hapur dhe t'i dorëzohen Shpirtit Shenjt. Në këtë kuptim ndoshta janë të dobishme disa nga mendimet që pasojnë:

1. Shumë katolikë u frikohen përvojave të jashtme fetare, duke i vendosur ato menjëherë në kategorinë e "ndjesive". Disa vëzhgues thonë se janë të nevojshme ndjenjat në fe, si kundërpeshë kundruall dimensionit mental. Shën Augustini thotë se feja kërkon kuptim. Duhet t'ia hapim zemrën tonë dashurisë dhe fuqisë së Zotit.

2. Shumica e njerëzve nuk janë në gjendje të rrëzohen në shpinë pa asistim. Kur njerëzit kanë vënë në pikëpyetje pushimin, i kam lutur të rrëzohen në shpinë pa asistim dhe asnjëri prej tyre nuk ka qenë në gjendje ta bënte këtë. Nën fuqinë e Shpirtit Shenjt, njerëzit bëjnë atë që përndryshe është e pamundur.

3. Shumë vetë që pushojnë në Shpirtin Shenjt, janë të arsimuar dhe profesionalistë, dëshira e fundit e të cilëve është të gjenden në dysheme. Madje, edhe më të "ngurtësuarit", nuk mërzhiten fare derisa pushojnë në Shpirtin Shenjt.

4. Të kërkohet shqyrtimi nga ana e bashkësisë. Në letrën e parë Gjoni 4,1 na mëson "vini në provë shpirtat". Bashkësia, lutësit dhe ata që pranojnë lutjen, zakonisht ndjenjë praninë ose mungesën e Zotërisë gjatë lutjes. Pjesa më e madhe e bashkësisë praninë e Shpirtit Shenjt zakonisht e ndien gjatë pushimit në Shpirtin Shenjt.

5. Një numër i madh meshtarësh, të cilët i janë kushtuar plotësisht shërbesës së shërimit, pajtohen për frytet e mira që i sjell pushimi në Shpirtin Shenjt. Ipeshkvijtë, të cilët kanë marrë pjesë në ato tubime dhe në disa raste edhe vetë kanë pushuar, e mbështesin më shumë këtë formë të shërbesës së shërimit.

6. Zoti ynë është Zoti i befasive. Duhet të jemi të hapur për rrugët në të cilat ndoshta Shpirti do ta çojë trupin. Kur terri është më i dendur, drita bëhet më e shkëlqyeshme. Përkundër të gjitha të këqijave që na rrethojnë, ndoshta duhet që edhe më shumë t'i dorëzohemi në dorë

udhëheqjes së Zotërisë. Ai na thotë: *"Ashtu të shndrisë edhe drita juaj para njerëzve, që t' shohin veprat tuaja të mira e ta lëvdojnë Atin tuaj që është në Qiell."* (Mt 5,16)

7. Duhet që njerëzit, parimisht, t'i konsiderojmë të sigurtë dhe të ndershëm, për deri sa nuk dëshmohet e kundërta. Disa do të thonë se të gjithë që bien, nuk pushojnë në Shpirtin Shenjt. Kjo është, sipas gjasës, e vërtetë, por unë do të thosha se shumica e tyre është nën pushtetin e Shpirtit Shenjt. Për këtë arsye, nuk hezitoj të shfrytëzoj terminologjinë e përmendur.

8. Shumica e dukurive keqpërdoren. I njoh disa njerëz që kanë agjëruar tepër dhe kanë shkatërruar shëndetin e vet. Nganjëherë mund të gjenden prindër që çdo ditë shkojnë në Meshë në dëm të familjes së tyre. Mirëpo, ne jemi përqendruar në përdorimin dhe jo keqpërdorimin e tyre.

9. Gjithmonë duhet të mbahet rendi dhe sjellja e mirë. Konsideroj se, në kuptimin pastoral, duhet penguar çdo lloj keqpërdorimi, sikurse që është pushimi në Shpirtin Shenjt me rastin e marrjes së Kungimit Shenjt, ose në mes të Meshës së të dielës, ose në vend publik. Është e qartë se është fjala për keqpërdorime, të cilat duhet përmirësuar në kuptimin pastoral.

"Hipnoza, histeria dhe pushimi – terapi..."

Përgjigjet e mjekëve dhe psikologëve në anketë

Në anketë janë 10 psikologë dhe 12 mjekë që kanë pasur përvojë personale të pushimit në Shpirtin Shenjt, të cilët i kanë paraqitur pikëpamjet e tyre. Kur i kemi pyetur se a e shohin pushimin në Shpirtin Shenjt si histeri masive apo hipnozë, janë përgjigjur si vijon:

Shtatë prej dhjetë psikologëve janë përgjigjur se, sipas mendimit të tyre, pushimi në Shpirtin Shenjt nuk është as hipnozë as histeri masive. Disa nga përgjigjet janë si vijon:

*"Gjendja pjesërisht të përkuqton transin."

*"Më shumë histeri masive se sa hipnozë. Sa më shumë njerëz rrëzohen, tendenca për pushim rritet edhe tek të tjerët."

*"Përvoja ime personale shkon në dobi të bindjes sime se është e denjë për t'u besuar."

*"Jam shumë rezistues në hipnozë dhe nuk kam simptome të histerisë në strukturën time psikologjike."

Dy psikologë nuk janë përgjigjur në pyetjen specifike në lidhje me histerinë masive ose hipnozën, por kanë dhënë komentet që pasojnë:

*"Komponentët hipnotikë me ose pa histeri."

*"Valët e trurit mund të ishin të afërta me ato të hipnozës."

Tetë nga dymbëdhjetë mjekët kanë komentuar në mënyrë të prerë, se nuk është fjala as për histeri masive as për hipnozë. Ja dy përgjigje të tilla në vazhdim:

*"Më shumë forcë pritjeje se sa ndikim të vërtetë të Shpirtit."

*"Pushimi i vërtetë në Shpirtin Shenjt nuk është as histeri masive as hipnozë, por ekzistojnë raste kur duket i dëshirueshëm pushimi, që mund të paraqesë problem."

Dy mjek nuk janë përgjigjur prerazi, por kanë dhënë këto komente:

*"Do të mund të ishte edhe hipnozë edhe histeri masive."

*"Do të mund të ishte edhe hipnozë edhe histeri masive, që në të shumtën e rasteve edhe është."

I kam pyetur psikologët se a do ta preferonin pushimin në Shpirtin Shenjt si shërues. Tetë prej dhjetëve janë përgjigjur pozitivisht, duke dhënë me atë rast këto arsye:

*"Përgjithësisht, çdo prekje e Shpirtit me rrezet e tij sjell shërim. Besoj se disponimi i personit (gjendja e hapur), shumë shpesh është çelësi. Kur personi dorëzohet dhe kur është i hapur për pranim, e me atë rast nuk e kontrollon rezultatin, konsideroj se është shëruese. Në të kundërtën, dyshoj në vlerën e tij. Mirëpo, përvoja e vërtetë, sipas natyrës së vet, është shëruese."

*"Kam përjetuar shërim të fuqishëm."

*"Lirimi nga qëndrimi mbrojtës dhe ankthi mund t'i lejojë Zotërisë veprim të papenguar."

*"Sjell paqe. Mirëpo, paraprakisht, pacientin e painformuar, duhet përgatitur."

*"Zotëria e udhëheq procesin, kështu që arrihet më shumë se sa në terapi të zakonshme."

Një psikolog nuk ka qenë i sigurt se a do ta preferonte pushimin në Shpirtin Shenjt si shërues, sepse mendon se në 'thelb është i paparashikueshëm', me fjalë të tjera mundet, por s'është e thënë të rezultojë me shërim."

Një tjetër psikolog pushimin nuk e preferon si shërues, sepse 'është shumë herët të thuhet se në çfarë mase është shërues'. Është ndjenjë e këndshme, njerëzit dëshirojnë ta përsërisin, por nuk jam i sigurt se është shërues."

Gjashtë nga dymbëdhjetë mjekë e rekomandojnë pushimin në Shpirtin Shenjt si shërues për këto arsye:

*"Pikërisht për faktin se besoj me gjithë zemër se Zotëria na prek thellë kur dorëzohemi thellësisht."

*"Atëherë i shikojmë gjërat në perspektivë të drejtë."

*"Është fjala për proces shërimi dhe duhet shfrytëzuar për atë qëllim."

*"Së paku është shumë lirues, qetësues dhe të lartëson."

*"Është fjala për lutje shërimi."

*"Sepse qëndrimi mbikëqyrës është pengesë për rritjen shpirtërore."

Katër mjekë nuk kanë qenë të sigurt se a do ta preferonin pushimin. Njëri prej tyre komentoi se 'nuk është diçka që duhet kërkuar, por çdo gjë duhet lejuar Zotërisë.'"

Një mjek tha se, për sa i takon kësaj, 'nuk do të deklarohej as për as kundër pushimit në Shpirtin Shenjt'.

"...Zoti e bekon popullin e vet me paqe"
(Ps 29, 11)

"Shikoni mirë këtë..."

mendime psikologësh dhe mjekësh

*"Kjo dukuri ka histori të gjatë."

*"Kjo është njëra prej mënyrave të shumta me të cilat Zoti na ndihmon."

*"Është fjala për shenjë të jashtme të dorëzimit të qenies së brendshme Atij."

*"Nuk është fjala për një gjë prej së cilës do frikuar. Nuk ka nevojë për frikë në dorëzimin Shpirtit Shenjt."

*"Pranojeni atë si dhuratë të Zotit, si ndihmë të Zotit. Nuk është fjala për dhuratë të ndonjë personi."

*"Ekzistojnë çështje psikologjike, por edhe forcat njerëzore mund të luajnë rol të caktuar në atë përvojë."

*"Mund të mësohet me veprim ose me përpjekje."

*"Jini të hapur, por mos tentoni domosdo."

*"Nuk duhet të bësh as të presësh diçka."
 *"Fuqia e Shpirtit Shenjt është në vepër dhe jo fuqia njerëzore. Është fjala për fuqinë e Zotit dhe veprën e Zotit."
 *"Është fjala për thirrjen që t'i dorëzoheni krejtësisht Zotit."
 *"Hiqni dorë nga kontrolli i vetëdijshëm derisa pushoni, që Zotëria t'i udhëheqë gjërat."
 *"Le të rrjedhë prej Zotit."
 *"Përqendrohuni në Jezusin."
 *"Ka shumë përvoja të pushimit si me rezultate specifike, ashtu edhe me të përgjithshme."
 *"Niveli i shërimit në ato çaste zakonisht është shumë i thellë, madje themelor."
 *"Edhe nëse nuk ka shenja, Zoti është i pranishëm."
 *"Me atë të jepet liria të jesh ai që je."
 *"Shëron."
 *"Nuk janë të gjithë mjaft të lirë ta pranojnë atë, edhe pse nuk është fjala për fajin e tyre."
 *"Nuk është e domosdoshme të pushojmë në Shpirtin Shenjt të na prekë Shpirti."

Dëshmi

"Shpesh më kanë hipnotizuar..."

psikiatri nga Florida "krahason shënimet"

"Si psikiatër, merrem me fenomenet psikologjike si histeria kolektive. Po ashtu, shpesh më kanë hipnotizuar, për shkaqe të ndryshme. Kam qenë në Meshë të atë DeGrandis me nxitjen e vajzës, që e dinte se nuk jam mirë. Kam qenë i tërhequr dhe krejt i pakënaqur me jetën time, e ajo mendonte se shkuarja në bashkësinë karizmatike të lutjes do të më ndihmojë të mos ndjehem ashtu i vetmuar.

"Si mund të bëj dallimin në mes të përvojës së pushimit dhe histerisë masive? Mund të filloj në bazë të bisedës dhe të sjelljes së njerëzve. Kjo ishte një përvojë krejtësisht ndryshe. Ishin të pranishëm nja 200-300 vetë. Qëndronim në rrallë të pranojmë vajimin, e, pasi salla ishte aq e madhe nuk kisha ide se çka po ndodh në anën tjetër. Pasi sytë i kisha të mbyllur, nuk e dija se kur atë DeGrandis do të më afrohej. Këndoja qetë këngë të devotshme, derisa ndjeva se diçka po më shtyn prapa. Në mënyrë të thjeshtë u lëshova. E dija se jam i shtrirë në dysheme, por e kisha ndjenjën se qëndroj pezull në ajër. Ndieja një lehtësim të madh dhe paqe. Në një moment ndjeva valët e ngrohtësisë se si lëvizin prej këmbëve kah koka. Në asnjë moment nuk kam ndjerë takim me atë DeGrandis dhe në asnjë moment nuk kam ndjerë praninë e tij fizike afër meje. U ngrita kur desha dhe isha shumë i befasuar që ndiej atë paqe.

"Dallimi në mes të kësaj përvoje dhe hipnozës është se në rastet kur më kanë hipnotizuar gjithmonë isha në lidhje me personin që më hipnotizonte. Gjithmonë ndiqja urdhërat e caktuar, më tregonin se çka duhet të bëj kur të zgjohem.

"Pushimi në Shpirtin Shenjt ishte përvojë e mrekullueshme që dëshiroj ta ndaj me të tjerët."

"I kriposur' dhe i gatshëm..."

mendimet e mjekut nga Viskonsini

Kur kam dëgjuar të parën herë për pushimin në Shpirtin Shenjt, kam menduar se është gesharake, e tepruar dhe artificiale. Pastaj, thjesht, nuk e ndieja veten mirë dhe isha i tendosur. Dyshoja se kjo mund të më ndodhë mua. Kur ndodhi, 'notova' dhe rashë i rrethuar nga drita e qetë, e butë dhe liruese.

Në kuptimin afatshkurtër, konsideroj se, pushimi në Shpirtin Shenjt është mënyra e shpejtë të lirohemi nga barra dhe tendosja. Ai më 'kripos' në njëfarë mënyre dhe më përgatit për atë që Zotëria dëshiron të bëjë.

"Në kuptimin afatgjatë, shohim shërim të madh të brendshëm. Gjithmonë i afrohem Atit nëpër Jezusin. Derisa qëndroja i shtrirë, me sytë e shpirtit e kam parë Jezusin se si më prin si fëmijës, pastaj si adoleshentit, pastaj djaloshit dhe në fund, në këtë moment dhe, më sjell para Atit. Ai më vinte në prehrin e Tij secilën herë. Kjo më dha një ndjenjë të vlerës, pranim të vetvetes."

"Dashuria që vërshon..."

letër e mjekut nga Louisiana

"I dashur atë DeGrandis:

"A mund ta ndaj me ju përvojën e dashurisë së Zotit që vërshon? Pas lutjes suaj për falje në seminarin e fundjavës, sinqerisht jam lutur për babin tim të ndjerë që ishte alkoolist. Me vite të tëra jam përpjekur të mos i ngjaj atij. Më vinte turp prej tij. Derisa në seminar, gjatë kohës së Meshës, qëndroja më rrallë për Kungim, ndjeva se dukem si babai, por nuk dëshirova të ndryshoj, por ajo ndjenjë, përkundrazi, ishte shumë e këndshme. Disi e kuptova për të parën herë atë dhe mirësinë e tij. Isha krenar se jam si ai.

"Derisa qëndroja në rreth dhe prisja vajimin, mendova për gjashtë javët, gjatë të cilave jemi obliguar të lusim lutjen e faljes dhe pyesja veten se a duhet kërkuar nga Zotëria farë vuajtje që ta paraqes për babin derisa lutem. Në atë moment zëri i brendshëm më tha, 'Ajo gjë nuk është e nevojshme, Joe. Tanimë e kam vuajtur unë.' Atëherë ju më keni lyer me vaj dhe kam pushuar në Shpirtin Shenjt. Nuk mund të ndalesha së qari duke u takuar edhe një herë me dashurinë e Zotit që vërshon."

"Zot, ndjehem keq, i shtrirë këtu... unë jam mjek!"

dëshmi mbi 'riparimin e përgjithshëm' të ndërmarrë nga Shpirti Shenjt

Motra Francis Clare sjell rastin që vijon:

"Më kujtohet kur jam lutur për grupin në të cilin ishte një mjek. Ai dëshmoi përvojën e tij. Tha se kishte menduar se kurrë nuk do të rrëzohej dhe kishte qenë shumë i sigurt derisa afrohej për lutje, por para se të kuptojë ndonjë gjë, u gjend i shtrirë në dysheme. Më vonë ka dëshmuar. 'E para punë që kam bërë, ka qenë që ta pyes Zotërinë se a guxoj të ngrihem. Ai tha : 'Jo. Pas pak e përsërita pyetjen dhe përgjigja ishte e njëjtë. Të tretën herë i thashë, 'Zot, ndjehem keq i shtrirë këtu... unë jam mjek!', Ai u përgjigj, 'Megjithatë!'. Kur më në fund është dorëzuar dhe i ka thënë Zotërisë të bëjë atë që duhet, fuqia e Zotit ka filluar të veprojë në te. Më vonë ka dëshmuar se si ka kaluar 'riparimin e përgjithshëm'. Nëse jeni mjek, këtë vërtet mund ta vlerësoni mirë!"

"Njëherë kur meshtari lutej për mua, filloi të rrëzohet. M'u desh që ta përdor tërë fuqinë që ta mbaj në pozitë vertikale!" (mjek).

ANKETA

(edhe pak statistikë)

12. A konsideroni se pushimi në Shpirtin Shenjt ka qenë për ju dhuratë e Zotit?

Po 94%

Jo 2%

Pa përgjigje 4%

(përgjigjet e meshkujve dhe të femrave kanë qenë gati identike).

13. Sipas asaj që dini, kjo përvojë, a e ka përparuar jetën tuaj të lutjes?

Po 82%

Jo 13%

Pa përgjigje 5%

14. A ju ka ndihmuar përvoja e pranisë së Zotit në jetën e përditshme?

Po 86%

Jo 5%

Pa përgjigje 9%

(përgjigjet e meshkujve dhe femrave kanë qenë përafërsisht të njëjta).

...vazhdon

Pasqyrë e pikave kyçe

- * Janë dy mënyra të të menduarit në lidhje me shkakun dhe vlerën e pushimit në Shpirtin Shenjt.
- * Njëra palë mendon se është fjala për dhuratë të Zotit që shëron dhe jep forcë.
- * Tjetra palë tërheq vërejtjen se pushimi në Shpirtin Shenjt mund të ketë burime dhe dukje psikologjike, madje edhe djallëzore.
- * Në përvojën e pushimit në Shpirtin Shenjt shumë lehtë mund të ketë përzierje psikologjike dhe shpirtërore.
- * Zotëria mund të na prekë thellë nëse i jepemi.
- * Kur të lirohemi prej plagëve të thella dhe shpirtëve të këqij, që, nëpërmes plagësh, kanë hyrë brenda nesh, mund shkaktohet rrebesh i vërtetë i ndjenjave.
- * Kur personi dorëzohet dhe është i hapur për pranim dhe nuk e kontrollon rezultatin e gjërave, pushimi në Shpirtin Shenjt mund të jetë shërues.
- * Pushimi mund ta lirojë personin nga qëndrimi mbrojtës.
- * Qëndrimi mbikëqyrës në personin mund të jetë pengesë për rritjen shpirtërore.
- * Kur pushojmë në Shpirtin Shenjt dhe i lejojmë Zotërisë që ta marrë në dorë procesin e shërimit, mund të arrihet më shumë se sa me shërim të zakonshëm.

Lutja

Atë Qiellor, të lutem zbuloji motivet e mundshme të fshehura dhe ndikimet psikike në përvojën time të pushimit në Shpirtin Shenjt. Së bashku me psikiatrin nga Florida dhe mjekët nga Viskonsin dhe Louisiana, dëshiroj të të takoj thellësisht. Së bashku me ta, dëshiroj të ngrihem mbi çdo depresion, mbi çdo plagë nga fëmijëria ose mbi çdo mendim të keq mbi veten, në mënyrë që të fitoj "riparimin e përgjithshëm të Shpirtit Shenjt".

Atë Qiellor, bëj prej meje mjet të pastër dhe të fuqishëm të lirit të asaj dhurate tek të tjerët. Le të përjetojnë ata, për të cilët lutem, përvojën e Dashurisë Sate që ndryshon jetën. Të faleminderit, Atë Qiellor. Të falem nderit Jezus Zot. Të falem nderit Shpirti Shenjt. Amen.

"...mos e përbuz veprën e duarve të tua!"
(Ps 138, 8)

6. S'trembem nga e keqja, sepse ti je me mua

*"Malet e rrethojnë Jerusalemin:
edhe Zoti rreth e rreth i rri popullit të vet
qysh tash e për amshim."*
(Ps 125, 2)

Nuk është secili i lirë në vetvete për ta pasur mundësinë t'i dorëzohet përvojës së pushimit në Shpirtin Shenjt. Francis MacNutt kështu e shqyrton këtë mungesë të lirisë:

"Ekzistojnë tipa të caktuar njerëzish që duket se e pengojnë këtë përvojë – sidomos ata, të cilët në jetën e tyre në përgjithësi i mbikëqyrin ndjenjat e tyre. Disa njerëz vërtet frikohen të jepen. Ky nuk është aq fort problem shpirtëror sa është problem ndijesor: i frikohen çdo gjëje që nuk mund ta kontrollojnë me arsye... janë njerëz, e kanë humbur aftësinë e të reaguarit spontan ndaj jetës."

Shpesh intelektualët do t'i jepen më vështirë pushimit në Shpirtin Shenjt edhe pse ky nuk ishte rast me profesorin tim, të dikurshëm, të Shkrimit Shenjt, në teologji. Ai njeri është bartës i diplomës së shkencave të Shkrimit Shenjt të entit Biblik të Jerusalemit dhe doktor i psikologjisë. Krejtësisht i hapur, tri herë pas lutjes për të, momentalisht është rrëzuar nën fuqinë e Shpirtit Shenjt. Është shumë i ditur, e megjithatë cilësohet si shumë i hapur. Kjo është një gjë e rrallë.

Në përgjithësi konsideroj se më lehtë pushojnë njerëzit, të cilët përndryshe janë të lirë, të hapur, të guximshëm dhe të kenë prirje të dorëzimit. Zakonisht ata janë njerëz me një masë të caktuar të thjeshtësisë. Ata që janë më tepër tipa intelektualë, të tërhequr dhe konservativë, zakonisht i rezistojnë më shumë pushimit në Shpirtin Shenjt. Nga kjo rrjedh që, si duket, është nevoja për një hapje psikologjike dhe shpirtërore.

Në këtë kapitull do ta shqyrtojmë dhe do të lutemi për disa nga mënyrat me të cilat njerëzit i mbyllën pushimit në Shpirtin Shenjt. Do të zbulojmë një varg të tërë problemesh pastorale të lidhura me këtë dhe do të japim disa propozime, të cilat mund të jenë të dobishme për individët para pushimit, gjatë pushimit dhe pas kësaj përvoje.

Lista e Dorothesë të problemeve psikologjike të pushimit në Shpirtin Shenjt

Në shërbesën e saj të shërimit të brendshëm, motra ime Dorothea DeGrandis Sudoj, ka njohur një varg të tërë pengesash që mund të paraqiten në rrugën e pushimit në Shpirtin Shenjt. Ato janë:

- Qëndrimi skeptik

- Qasja intelektuale ndaj besimit
- Frika nga e panjohura
- Frika nga rrëzimi
- Frika nga humbja e vetëdijes
- Frika nga humbja e kontrollit
- Mungesa e dëshirës
- Frika nga afërsia e Zotit
- Frika nga dorëzimi
- Vështirësitë fizike (p.sh. sulmet epileptike, nevoja për përdorimin e shkopit, etj.)
- Asociacionet negative të lidhura me qëndrimin e shtrirë në shpinë (sëmundja, operacioni, dhunimi)
- Traumë serioze e lidhur me vdekjen e dikujt tjetër
- Mungesa e besimit në Zotin
- Mungesa e besimit në njerëz
- Ndjenja e pakëndshme për shkak të madhësisë së trupit
- Shtatzënia (frika nga lëndimi i fëmijës së pa lindur)
- Ndjenja e inferioritetit
- Frika nga përvoja mistike

Lutja të mënjanohen pengesat:

Atë Qiellor, Të lutem më liro nga të gjitha pengesat e pushimit në Shpirtin Shenjt. Mënjano çdo rrënjë të skepticizmit, cinizmit ose rezistencës intelektuale. Dërgo dashurinë tënde në rrënjën e çdo frike, pakënaqësie dhe pasigurie. Prek çdo mungesë të besimit. Më ndihmo Të të afrohem dhe Të ta hap zemrën time. Në emër të Jezusit. Amen.

"...aty ku është Shpirti i Zotit, aty është edhe liria"
(2 Kor. 3, 17)

Nëse Zotin e thërrasim thellë në rrënjën e problemit tonë dhe (nëpërmes të faljes) i lejojmë të veprojnë në emrin tonë, mund ta fitojmë lirinë. Çdo gjë që Ai prek, e shpengon.

Përmbledhje e disa preokupimeve pastorale

Një person i njohur ka thënë se për pushimin në Shpirtin Shenjt nuk ka probleme teologjike, por ka shumë probleme pastorale. Kam prirjen të pajtohem me këtë deklaratë. Disa nga lëmenjtë themelore në këtë kuptim janë:

KU TË PËRDORËT: konsideroj se duhet të jemi të kujdesshëm se në çfarë vendi lejojmë të ndodhë pushimi në Shpirtin Shenjt. Për shembull, nuk do të lejoja në meshën e famullisë, apo në cilëndo ngjarje që nuk është e tipit karizmatik. Ideale është të shfrytëzohet në lutjet private, të veçanta, për njerëzit. Mund të shfrytëzohet po ashtu në seminarët karizmatikë dhe në Meshët për shërim.

NEVOJA QË NJERËZIT TË MËSOHEN: është shumë e rëndësishme. Kur përgatitem për vajim dhe lutje, gjithmonë e përmend se disa njerëz mund të bien në dysheme. Njerëzve duhet thënë se është përvojë e zakonshme, se nuk duhet të thirret ndihma e shpejtë ose të kërkohet mjeku. Disa njerëz janë lutur për grupe të mëdha njerëzish dhe as që e kanë përmendë se çka mund të ndodhë. Njerëzit janë rrëzuar nën fuqinë e Shpirtit Shenjt, e të tjerët, të shokuar dhe të frikësuar, e kanë braktisur tubimin. Në shoqërinë tonë, kur i shohim njerëzit që rrëzohen,

mendojmë se nuk janë mirë, - ndoshta kanë ndonjë sulm në zemër. Duhet që paraprakisht t'u tërhiqet vërejtja njerëzve për atë që do të mund të ndodhë dhe të paralajmërohen se çka mund të presin, edhe nga ana e jashtme edhe nga ana e brendshme, pikërisht si mjeku ose dentisti i tërheq vërejtjen pacientit për atë që pason. Nganjëherë është e nevojshme që njerëzve t'u ndihmohet që, në brendinë e vet, të formojnë hapësirë që të krijohet mundësia për të ndodhë pushimi në Shpirtin Shenjt. Kështu iu ndihmohet të bëjnë atë që Shpirti i nxit.

Disa njerëz që nuk pushojnë në Shpirtin Shenjt, do të ndjehen të izoluar ose do të mendojnë se Zoti nuk i do. Është e nevojshme t'i bindim në dashurinë e Zotit. Atyre ndoshta do t'u duhen më shumë lutje dhe mësim, në mënyrë që në aspektin psikologjik të bëhen të hapur për këtë përvojë. Bindni njerëzit se nëse nuk pushojnë në Shpirtin Shenjt, nuk do të thotë se nuk i janë të afërt Zotit. Po ashtu, duhet thënë se pushimi nuk është shenjë e shenjtërisë. Derisa Nëna Tereze, me gjasë, kurrë nuk ka pushuar në Shpirtin Shenjt, i njoh disa 'hora' të mëdhenj që e kanë pasur këtë përvojë.

PUSHIMI MUND TË KONTROLLOHET: Çasti i rrëzimit kryesisht është nën kontrollin e personit që rrëzohet. Nëse i mbani programet karizmatike në institucion, i cili nuk është i hapur pushimit në Shpirtin Shenjt ose në ndonjë situatë të pavolitshme, u thoni pjesëmarrësve që shpirtin e vet t'ia mbyllin kësaj përvojë dhe lutini të mos pushojnë. Do të shihni se në të shumtën e rasteve do t'ju dëgjojnë dhe pushimi do të mungojë. I kam lutur 700 të pranishëm në një kishë të vogël në qytetin australian Brisban të përmbahen nga pushimi, duke mbyllur shpirtin e vet për këtë përvojë, sepse rrethanat ishin të pavolitshme. Ata vërtet e bënë këtë me sukses.

PËRVOJAT NEGATIVE: Në bazë të përvojës personale, do të thosha se veprimet negative gjatë pushimit në Shpirtin Shenjt janë të rralla. Individët që janë të brengosur për veprimet e mundshme negative, zakonisht kanë përvojë të pamjaftueshme ose kuptim të fuqive negative prej të cilave individët lirohen. Nganjëherë, në raste të tilla, në vend të kujtimeve të dhembshme ose shpirttrave të këqij, vjen Jezusi dhe ajo që mund të ishte negative, në të vërtetë është gjë shumë pozitive. Jo rrallë shpirttrat e këqij hyjnë nëpër plagët shumë të thella emocionale ose janë me to ngushtë të lidhur, kështu që – gjatë procesit të shërimit – mund të shkaktohet lirimi i fuqishëm i ndjenjave. Francis MacNutt thotë: "...çdo gjë që nuk është e thjeshtë dhe e qetë, nuk është veprim i drejtpërdrejtë i Shpirtit Shenjt, por është reagim i natyrës së lënduar njerëzore ose i fuqive të këqija."

Kur duket se individi, i cili pushon, në njëfarë mënyre është i shqetësuar, karizmatiku i pjekur dhe i përgatitur (me njohje të caktuar të betejës shpirtërore dhe lutje për shërim të brendshëm) duhet të gjendet në afërsi të personit të tillë, që ta ketë nën kujdes.

ÇËSHITJA E VENDIT: kur është fjala për grup, duhet siguruar hapësirë të mjaftueshme që njerëzit të kenë mundësi të pushojnë në dysheme.

KUJDESTARËT: Siguroni kujdestarë të mirë dhe të aftësuar që do të mbajnë rend dhe do të kujdesen që, në mënyrë të vazhdueshme, të mbretërojë qetësia dhe dinjiteti si u ka hije rrethanave.

NDIHMËSIT: Duhet të gjenden ndihmës me përvojë që do të qëndrojnë pas personit për të cilin lutet dhe do t'i lëshojnë në dysheme në mënyrë të kujdesshme. Nëse ekziston mundësia e pushimit, kujdesuni gjithmonë që pas personit për të cilin lutet, të qëndrojnë ndihmësi. Ata, gjithashtu, duhet t'u ndihmojnë njerëzve të ngrihen kur jenë të gatshëm për këtë.

MUZIKA: Besoj në vlerën e korit kualitativ, i cili gjatë kohës kur njerëzit pushojnë në Shpirtin Shenjt, këndon këngë karizmatike. Kjo u ndihmon njerëzve që, në lavdërim të thellë, të përqendrohen në Jezusin, që i hap pastaj për një dorëzim më të plotë.

DËSHMITË, PAS PËRVOJËS SË PËRJETUAR: Pas pushimit në Shpirtin Shenjt do të ishte mirë të dëgjohen dëshmitë e njerëzve çka u ka ndodhur, asisoj, ajo që është mësuar, të kalojë nëpër vlerësimin dhe përvojën e njerëzve. Tri pyetje mund të ndihmojnë në atë rast:

1. A ka qenë e vlefshme?

2. A ka plotësuar ndonjë nevojë të caktuar?
3. A është përjetuar Zoti në mënyrë më të thellë?

Vetëm personi, i cili e ka pasur këtë përvojë, mund të thotë se i ka ndodhur diçka nga këto. Do t'ju befasojë thellësia e përvojës së shumë njerëzve. Sipas mendimit tim, thellësia e kënaqësisë që e përcjell përvojën, është tregues i besueshmërisë së tij. Kjo duhet ndarë me të tjerët.

MATERIALI INFORMATIV: Duhet të shpërndahen fletëpalosje me përshkrimin e aktiviteteve lokale, duke përfshirë emrat e bashkësive të lutjes dhe literatura që preferohet për rritje të mëtutjeshme.

SI TË VAZHDOHET: Besoj se njerëz të pjekur dhe të aftësuar në mënyrë adekuate, duhet që çështjen ta çojnë përpara. Sidomos për njerëzit me përvoja negative duhet siguruar lutje të vazhdueshme. Nëse lëvizen lëmi të thella, e nuk punohet më shumë në to, është problem i vërtetë pastoral. Personalisht mbaj seminare vetëm atje ku ekziston bashkësia e lutjes, e cila mund të vazhdojë punën dhe njerëzit i vendos në rreth të mbushur me dashuri të bashkësisë brenda së cilës procesi i shërimit mund të vazhdojë.

ÇFARË QËNDRIMI TË MERRET NDAJ KEQPËRDORIMEVE: Të gjithë jemi të vetëdijshëm për faktin se keqpërdorimet janë të mundshme gjithmonë. Dhe të gjitha dhuratat mund të keqpërdoren, prandaj është e nevojshme udhëheqja dhe njohja e mësuesit dhe bariut. Pushimi në Shpirtin Shenjt mund të shfrytëzohet për të mirë, por mund të keqpërdoret po ashtu. Për shembull, njeriu që shkon në lutje tek tre vetë, gjithsesi paraqet keqpërdorim. Orientimi në atë që ndërmjetëson dhuratën në vend se në Jezusin, gjithashtu mund të jetë keqpërdorim. Të lidhurit e tepërt me përvojën e jashtme, mund të paraqesë keqpërdorim (flet për mungesën e kuptimit të thelbit të përvojës dhe për nevojën e të mësuarit). Edhe lutësit, të cilët kënaqen për mundësinë që njerëzit t'i shtien në pushimin në Shpirtin Shenjt për shkak të afirmimit të vet, po ashtu mund të paraqesin keqpërdorim. Konsideroj se ata që janë të ngarkuar për mësim, duhet të japin këshilla dhe udhëzime, në mënyrë që të mënjanojnë keqpërdorimet.

"Para pushimit, gjatë pushimit dhe pas..." **Përgatitja të hyhet në pushimin e Tij**

Ashtu sikurse e kam thënë në Shërbesën e shërimit, "do t'i kisha propozuar dikujt që ndoshta kurrë nuk ka pushuar në Shpirtin Shenjt dhe dëshiron të rritet në Zotin, që me lutje ta shtie në pushimin në Shpirtin Shenjt. Njerëzit thonë se dëshirojnë, por nëse kjo është dëshirë e kokës dhe jo edhe e zemrës, zakonisht nuk do të ndodhë. Nëse hapeni, atëherë dera e zemrës suaj do të hapet nga brenda. Thuaj Zotit: 'Dëshiroj të pranoj krejt çka ke përgatitur për mua, Zot. Dëshiroj të pranoj krejt çka do të më bëjë person më të mirë, person që do të dojë më shumë dhe, i cili do të shërbejë më mirë Ty dhe vëllezërve.'"

Motra Francis Clare sjell këto këshilla:

PARA PËRVOJËS: "Mos nxitni asgjë dhe mos pengoni që fuqia e tij të zbresë mbi ju, duke u frikuar se ku do të bini dhe si do të dukeni, se çka do të mendojnë njerëzit për ju. Lirohuni nga të gjitha ato frika. Lëshohuni në dashurinë e Tij dhe lavdërojeni me butësi për shkak se ju do. Lirohuni nga çdo ndjenjë fajësie dhe padenjësie. Kjo nuk është përvojë për ata që janë të denjë, por për ata që kanë nevojë për lirim, shërim të brendshëm dhe shugurim."

GJATË PËRVOJËS: "Lëshohuni në dashurinë e Tij. Dorëzohuni dashurisë së Tij. Besoni me fe të gjallë se po ndodh diçka brenda jush, edhe pse ndoshta ju nuk e ndjeni këtë. Qëndroni në atë gjendje aq sa mendoni se është e nevojshme."

PAS PËRVOJËS: "Kur të ktheheni në nivelin normal të vetëdijes, qetësoni në vete çdo ide për vetëgjykim, vetë-analizë dhe çka njerëzit mendojnë, ose dëshpërimin se asgjë nuk keni ndjerë. Qëndrimi në pushim pesë minuta ose pesë orë nuk është shenjë e mëkatit më të madh

ose e shenjtërisë më të madhe. Fjalët e dashurisë ose të lavdërimit të Atit, Birit dhe Shpirtit Shenjt, të drejtuara nga zemra e sinqertë, e mbajnë të vazhdueshëm procesin e shërimit në zemër. Jeni të hapur çdo ditë vullnetit të Zotit të gjallë. Përvoja e pushimit në Shpirtin Shenjt është vetëm fillimi. Zoti do të vazhdojë veprën e vet me orë, javë muaj, madje ndoshta edhe me vitet që pasojnë. Me të vërtetë është gëzim i madh fakti se Ai na do dhe lejon që Gjaku i Tij i Shtrenjtë na pastron në këtë mënyrë.

“Jezusi është Shërues, e Shpirti i Tij i Shenjtë është ai që shëron, sepse ky është vullneti i Atit në këtë moment të jetës suaj.”

Dëshmi

“Mu duk tepër thjesht...”

Tregimi për faljen e motrës Monikë

“Në vitin 1979., pak kohë pasi hyra në kuvend, kisha probleme me adaptimin për shkak të raporteve të pashëruara me nënën. Ishte e sëmurë mendërisht, mirëpo as unë as anëtarët tjerë të familjes nuk ishim të vetëdijshëm për këtë fakt.

“Udhëheqësi im shpirtëror më dërgoi te meshtari që ishte në shërbesën e shërimit, te ati Joe Otte. Posa e pashë, pata besim të plotë në të. Më futi në dialog të thjeshtë të faljes me nënën time (që mu duk tepër e thjeshtë për problem aq të thellë. Atëherë u ngrit dhe filloi të lutet për mua. Nuk më preku dhe unë as që kisha dëgjuar deri atëherë për `pushimin në Shpirtin Shenjt’. Së shpejti ndjeva se nuk kam forcë të qëndroj në këmbë, prandaj u shtrina në dysheme. Derisa qëndroja e shtrirë, ai filloi të flasë, por zëri i tij më dukej si të ishte shumë mile larg. Më tha të kaloj dialogun e faljes me secilin që kam pasë probleme dhe që mos të ngrihem derisa të ndiej se është kryer ai proces. Ndjeva një kënaqësi dhe paqe të pabesueshme dhe pas nja 45 minutash u ndjeva e gatshme të ngrihem.

“Pak kohë pas kësaj përvoje, mora lajmin se nëna ime ishte vendosur në një spital për të sëmurë mentale dhe fluturova në Miçigan që t’i ndihmoja. Menjëherë shpërtheu brenda meje në mënyrën e njëjtë destruktive, e cila në të kaluarën më hidhëronte aq shumë, por kësaj here isha krejtësisht e lirë nga urrejtja. Më ishte kthyer e gjithë dashuria nga fëmijëria për te dhe kishte filluar po ashtu të lirohet edhe dashuria e saj për mua. U shërua plaga e vjetër 27 vjet dhe mbeti e shëruar deri në vdekjen e saj.

“Nëna ime ishte zhytur thellë në okultizëm, i cili luante rol edhe në jetën time para kthimit. Sikur të kisha dëgjuar për pushimin në Shpirtin Shenjt ose të kisha parë se si i ndodh dikujt, me siguri do të kujtoja se është fjala për diçka okultiste dhe do t’i largoja njerëzit nga ai. Kualiteti i jetës së krishterë që ma ka zbuluar atë Otte, si dhe frytet e asaj përvoje, më kanë bindur se është fjala për dhuratë të vërtetë të Shpirtit Shenjt dhe jo për vepër të shpirttrave okult. Shpirti Shenjt është ai, i cili e ka kthyer lirinë dhe dashurinë në raportin tim me nënën dhe e ka bërë këtë nëpërmes `pushimit në Shpirtin Shenjt’.

*"Kthehu, shpirti im, në qetësinë tënde,
sepse Zoti është bamirësi yt!"*

(Ps 116,7)

"Kam provuar madje edhe picën..."

Raport nga Kanadaja

"I dashur atë DeGrandis:

"Para disa vitesh kur përmendej seminari për shërime, largohesha me shpejtësi. Pastaj ngadalë fillova ta njoh Zotin dhe – me ndihmën e njerëzve rreth meje – qëndrimi im u ndryshua. Gjatë dy viteve të shkuara shpesh jam vajuar, por nuk e kam përjetuar 'pushimin' në Shpirtin Shenjt. Gjithmonë e kam dëshiruar, por kisha frikë dhe jam përmbajtur që t'i hapem plotësisht shërimit të Zotit.

"Në meshën tuaj, kur keni ndjerë se disa njerëz po shërohen, dëshiroja shërimin e dhembjeve në lukth dhe kraharor që më mundonin për disa muaj. Merrja barna, por nuk më ndihmonin. Lutesha, por lutja nuk dëgjohej. Atë mbrëmje, kur keni thënë fjalët e njohjes se Zoti po i shëron disa njerëz, nuk kam ndjerë asgjë.

"Pastaj, para vajimit, kur keni shpjeguar se si t'i hapemi fuqisë së Shpirtit Shenjt, (ju drejtoj në pyetjen 7,8 të anketës: vëreni se 62% të atyre që kanë pushuar në Shpirtin Shenjt kanë patur shpjegime. Do të ishte interesante në ndonjë studim të ardhshëm të shihet se a ka lidhshmëri në mes të informimit dhe shërimit) vendosa të provoj. Këndova me zë dhe i ngrita duart. Edhe pse nuk kisha besim të mjaftueshëm që t'i mbyllja sytë, e dija se Shpirti Shenjt po vepron fuqishëm. Ndodhi aq shpejt. Ndjeva ngrohtësi në ballë, kur më lyet me vaj. Çdo gjë u bë aq e qetë. Nuk di si ta shpjegoj pushimin, por ishte i mrekullueshëm.

"Atë mbrëmje shkova në shtëpi duke pyetur veten se a mund të mungoja nga puna të nesërmen, të kthehem në seminarin tuaj. Dëshiroja më shumë. Në zemër këndoja tërë natën, deri në mëngjesin e nesërm.

"Atë natë jam shëruar nga problemet lidhur me lukthin dhe kraharorin. Erdhi e shtuna dhe mua m'u kthye oreksi. Madje e provova edhe picën, që t'i vërtetoja të gjitha. Deri më sot dhembjet nuk më janë kthyer. Është e mrekullueshme, jo vetëm të pranosh shërimin, por edhe të dish se Zoti të do. Tani mund t'i lejoj Zotit të më prijë të kem më shumë dashuri dhe falje për të tjerët."

*"Të dhënçin lavdi mbarë popujt, o Hyj,
mbarë popujt e botës ty të lavdërofshin!"*
(Ps 67, 4)

"Thirrja e butë e Jezusit..."

Dëshmia e Tomës

"Jam marrë dhjetë vjet me shitjen e drogës dhe në të njëjtën kohë e kam përdorur: para së gjithash, marihuanën dhe kokainën. Kam qenë i varur dhe, krejt çka kam dëshiruar, ka qenë që ta marr. Jam edukuar si i krishterë, por të gjitha ato vlera i kam humbur gjatë asaj kohe të tmerrshme. Nuk e kontrolloja jetën time. Isha i frikësuar, pa ndihmë dhe i pa aftë të dilja nga ajo gjendje. Një mbrëmje, pasi isha droguar, vërtet rashë në dëshpërim. Rashë në gjunjë para kryqit që ishte i varur mbi shtratin tim dhe e luta Zotin të më ndihmonte.

"Një javë më vonë shkova në kishën e famullisë sime dhe mora pjesë në Eukaristinë Shenjte. E lutja Zotin të më ndihmonte. Ditët kalonin dhe ndjeva thirrjen e butë të Jezusit të shkoj në rrëfim. Kur shkova, më vinte aq turp për varësinë time, e këtë nuk i thashë meshtarit. Derisa pas rrëfimit qëndroja para tabernakullit, vendosa të kthehem dhe të rrëfej varësinë time për drogën. Meshtari ishte aq i kënaqur që u ktheva. Kur e ngriti dorën të më bekojë, trupin tim e përfshiu një topitje e jashtëzakonshme, por e këndshme: prej kokës tek thembrat. Më vonë kam

kuptuar se kam pushuar në Shpirtin Shenjt i ulur në karrige. Kur u nisa të shkoj te makina, pas rrëfimit, më dukej se këmbët i kisha si të gomës.

"Më vërshoi përvoja fizike e dashurisë së Zotit. Isha i sigurt se Ai është i kënaqur me mua dhe se më do. Ajo njohje e drejtpërdrejtë dhe personale e dashurisë së Tij më ka dhënë fuqinë e nevojshme për shërim nga varësia dhe largim nga kërkimi i përvojave jo të shëndosha.

"Nëpërmjet pushimit në Shpirtin Shenjt, Zoti ma ka zbuluar jetën e re. Tani e udhëheq bashkësinë e lutjes dhe zemra ime është e hapur dashurisë dhe shërbimit për popullin e Zotit."

"Do t'u jap një zemër për të më njohur se unë jam Zoti..."
(Jer. 24, 7)

ANKETA

(edhe pak statistikë)

15. A mendoni se është në rregull që një katolik të pushojë në Shpirtin Shenjt në seminarët karizmatikë ose në bashkësitë e lutjes?

Po	91%
Jo	2%
Pa përgjigje	7%

16. A do t'i nxisnit të tjerët të përjetojnë këtë përvojë?

Po	90%
Jo	2%
Pa përgjigje	8%

(Rezultatet tregojnë se ka më shumë meshkuj se femra që do t'i nxisnin të tjerët të pushojnë në Shpirtin Shenjt: 96% të meshkujve është përgjigjur pozitivisht në raport me 88% të femrave).

17. A do të dëshironit të bëhej pjesë e rregullt e jetës katolike?

Po	87%
Jo	3%
Pa përgjigje	10%

(Edhe në këtë pyetje, numër më i madh i meshkujve është përgjigjur pozitivisht: 94% ndaj 85% të femrave).

(fondi i anketës)

"Zot... na ke krijuar për vete dhe zemra jonë është e shqetësuar derisa nuk qetësohet në Ty"

(Shën. Augustini)

Pasqyrë e pikave kyçe

*Disa njerëz e kanë humbur aftësinë e reagimit spontan në jetë.

*Zoti dëshiron të na lirojë nga ato gjëra, të cilat na pengojnë që t'i dorëzohemi lirisht.

*Për ata tek të cilët thellësisht shqetësohen gjatë pushimit në Shpirtin Shenjt, është me rëndësi që dikush të vazhdojë të lutet mbi ta.

*Na duhet udhëheqja dhe shqyrtimi i bariut dhe mësuesit, ashtu, të zbulohen lëmitë e keqpërdorimeve.

Lutja

Atë Qiellor, Të lutem përtërije brenda meje aftësinë e reagimit të lirë dhe spontan në jetë. Ashtu si motrës Monikë, edhe mua ndoshta më duhen liria dhe dashuria në marrëdhëniet familjare. Ashtu si kanadezit, edhe mua më duhet njohja më e thellë e dashurisë Sate shëruese. Ashtu si Tomit, edhe mua më duhet forca që vjen nga njohja e thellë e dashurisë Sate.

Atë Qiellor, si udhëheqës më duhet të rritem në urtinë pastorale. Liria, por edhe vijat e drejtimit të sigurta, njësoj janë të nevojshme te pushimi në Shpirtin Shenjt. Të falem nderit që më dhuron pjekurinë në atë lëmi. Në emër të Jezusit. Amen.

"Unë erdha që ta kenë jetën, e ta kenë me plotësi."

(Gjn. 10, 10)

7. Me vaj erëmirë kryet ma lyen, gotën ma mbush plot e përplot

"Dhe Hyu, në të cilin e kemi shpresën, ju mbushtë me çdo gëzim e paqe në besimin tuaj që, në saj të fuqisë së Shpirtit Shenjt, kurrë të mos ju mungojë shpresa!"

(Rom. 15,13)

Një grua 27 vjeçare mu afrua njëherë dhe ndau me mua përvojën e saj të pushimit në Shpirtin Shenjt: "Atë, ka qenë përvoja më e bukur e jetës sime. Iu kundërvura me fjalët: "Mendoni, ndoshta, përvoja më e bukur fetare." U përgjigj: "Jo, pikërisht përvoja më e bukur!"

Zoti është dashuri dhe dëshiron që ne ta ndiejmë atë dashuri. Duke udhëtuar në kuadër të shërbesës sime brenda dhe jashtë vendit, shoh të krishterë të bashkuar në dëshirën për përvojën e thellë të Jezusit. Është një gjë të dëgjosh për Dashurinë e Tij e diçka tjetër ta ndjesh me të vërtetë. Është një gjë të dëgjosh se Zoti shëron, e tjetër gjë ta ndjesh në mënyrë të drejtpërdrejtë shërimin e shenjtë të Tij në trupin tënd.

Si duket, pushimi në Shpirtin Shenjt i ndihmon shumë shërbesës së shërimit. Francis McNutt thotë: "Kam parë mënyrat më të ndryshme të shërimit, të cilat kanë ndodhur derisa njerëzit pushonin në Shpirtin Shenjt." Më duhet të pajtohem me të. Duket se është mjet me të cilin Zoti shërbehet të na bie në situatë në të cilën mund të pranojmë shërimin.

Ky kapitull i fundit sjell edhe disa shembuj, si dhe një pasqyrë të shkurtër të fryteve të pushimit në Shpirtin Shenjt.

Dëshmi

"Largohuni prej meje! Ende nuk kam pushuar..."

tregimi nga Kalifornia

"Ndjeva një joshje fizike të papritur dhe të pamasë ndaj një njeriu, i cili udhëtonte me ne në një tubim. Dëshira ishte e dyanshme, por e komplikuar me faktin se unë isha e martuar. Kur ktheheshim, rrija vetëm në fund të aeroplanit dhe një person nga grupi tha një profetizim të fuqishëm. Derisa dëgjoja, Shpirti i Zotit vepronte fuqishëm në mbarë grupin, edhe unë pushova në Shpirtin Shenjt. Pas pushimit, u zhduk e gjithë dëshira

seksuale dhe zhgënjimi. Me gëzim dëshirova ta ndaj atë liri me mashkullin për të cilin ishte fjala. Por, ai u zmbraps dhe më tha: "Largohuni prej meje! Ende nuk kam pushuar!"

"Ndjehesha si arra, e ndarë përgjysmë..."

tregimi i Lucisë

"Më kujtohet njëherë kur Zoti më ka prekur thellë derisa pushoja në Shpirtin Shenjt. Udhëhiqja tubimin në seminarin njëditor të atë DeGrandis. Tërë ditën ndieja një shqetësim dhe një ndjenjë të brendshme të pakëndshme, të cilës nuk mund t'i bija në gjurmë. Pasi atë DeGrandis në fund të ditës filloi të lyej me vaj njerëzit, nuk munda më tepër të duroj. E dija se më duhet të pranoj vajimin. Derisa pushoja në Shpirtin Shenjt pas vajimit, mu kthye një pjesë e të kaluarës. Para meje qëndronte fëmija – isha unë – i përlotur dhe i thyer. Pas pushimit kërkova të luten për mua. Kur pushova për të dytën herë u ndjeva si arra e ndarë më dysh: fëmija dhe personi i rritur në mua. Të parën herë në jetën time u takova me fëmijën brenda meje, i cili ka qenë i keqtrajtuar seksualisht. Të parën herë kam mundur ta thërras me emër. Qysh atëherë ka vazhduar procesi i shërimit tim të brendshëm. I kam humbur gadi tridhjetë kilogram dhe kam filluar që ta pranoj veten. Tani jam anëtare e grupit që merret me shërbesën e shërimit të brendshëm."

"Shpinorja e këmishës së Jimmy-t..."

tregimi i Lindës

"Në jetën time ka ekzistuar modeli i ngjarjeve shokuese – tregimeve të vërteta tmerri ta cilat kanë lënë gjurmë të thella në mua. Dukej se i tërhiqja mbi vete pikërisht ato përvoja.

"Pas vdekjes së djalit të adoptuar, pranova pagëzimin në Shpirtin Shenjt dhe takova Shëruesin e kujtesës. Numri më i madh i shërimeve që i kam pranuar pas kësaj kanë ndodhur derisa kam pushuar në Shpirtin Shenjt. Në kujtesë më ka ardhur një përvojë shumë e fortë, lidhur me babin tim.

"Kur i kam pasur tetë vjet, babait tim i është thërrmuar këmba në fatkeqësinë që ka ndodhur në sharrën e tij në rripin malor bregdetar. Një i punësuar dhe mik shumëvjeçar, Jimmy, e ka bartur prej vendit të fatkeqësisë deri te automobili me të cilin është dashur të dërgohet në spital në Monterey. Në kujtesë më ka mbetur gjurma e përgjakshme e dorës së babait në shpinoren e këmishës së pambuktë të Jimmy-t. E kam parë atë gjurmë në këmishën e tij atë pasdite kur kthehesha prej shkollës së ulët. Gjatë 35 viteve të ardhshme ajo fotografi e gjurmës së përgjakur të shuplakës së babait tim kohë pas kohe lajmërohej në kokën time, së bashku me ndjenjat e hidhura të asaj ngjarjeje.

"Derisa pushoja në Shpirtin Shenjt në një seminar të shërimit 35 vjet më vonë, përsëri e kam parë shpinoren e këmishës së Jimmy-t., por kësaj here ishte ndryshe. Në atë vizion u paraqit Jezusi. U afrua dhe dorën e Tij të përgjakur, të shpuar nga gozhdja, e vuri mbi këmishën e Jimmy-t, pikërisht mbi gjurmën e shuplakës së babait. Disa çaste më vonë e ngriti dorën e vet dhe gjurma e shuplakës së babait u zhduk.

"Derisa qëndroja e shtrirë duke pushuar në Shpirtin Shenjt, isha e vetëdijshme se u zhduk krejt dhembja e atij kujtimi. E zëvendësoi vetëdija e thellë e mbushur me paqe se Zoti në mënyrë sovranë është kthyer në të kaluarën dhe në atë ngjarje tragjike, duke lënë gjurmën e vet në shpinoren e këmishës së Jimmy-t."

*"...e mjerimin në harresë do ta qesish;
do të kujtohet si ujërat që shkuan."
(Jb. 11, 16)*

"E barte nënën në Duart e Tij..."

Kujtimi i Muriel nga Massachusett-si

"Mora pjesë në shërbesën e shërimit të atë DeGrandis jo shumë kohë pas kthimit nga pushimi tre javor në Havaje. Derisa isha atje, nëna ime shkoi në spital. Kishte probleme serioze me zemrën dhe duhej gjithsesi të jetë e hospitalizuar. Atë mbrëmje erdha në Meshë duke bartur nënën në zemër.

"Kah fundi i shërbesës, punoja me Jessie-n në pjesën e librave dhe papritmas ndjeva nevojën të shkoj në vajim. Kur pranova vajimin, ndjeva se si po bie në duart e ndihmësit. Derisa u shtriva ngadalë në dysHEME, më vërshoi ndjenjë e fuqishme e paqes. Kisha po ashtu ndjenjë të dritës verbuese, si reflektor që ndriçon fytyrën time. Ndieja madje edhe ngrohtësinë e asaj drite. Mund të krahasohej me ngrohtësinë e diellit, kur rrezitemi. Përnjëherë pashë në Shpirtin Shenjt Jezusin me fustan të bardhë me konop të gështenjtë në brez. Hyri në dhomën e spitalit. Kur iu afrua shtratit, pashë se e sëmura në shtrat ishte nëna ime. Në fillim mendova se do të shërohet nga problemet e zemrës, por pastaj e pashë se si po e merr në duar dhe po del përjashta. Dhoma dhe shtrati mbetën të zbrazët dhe ndjeva se po më përfshin një ftohtësi. Fillova të qaj. Kur u ktheva te librat, Jessie më pyeti se çka kam. Ia shpjegova vizionin dhe i thashë se po ndiej se Zoti po e thërret nënën në shtëpi. E dija se më ka lejuar të përgatitem për atë që po më priste. Të nesërmen nëna kaloi në amshim."

Mendime për frytet e pushimit në Shpirtin Shenjt

Në vitin 1909 pastorët gjermanë janë takuar në Berlin dhe kanë dhënë një deklaratë për lëvizjen pentakostale. Në mes tjerash, kanë thënë se cilësia kryesore dhe fuqia shtytëse e lëvizjes është "dashuria ndaj Jezusit dhe dëshira që Ai, në çdo kuptim, ta plotësojë qëllimin e vet në ne."

Sot, në kuadrin e Ripërtëritjes karizmatike katolike, kam prirjen që ta them të njëjtën gjë. Stili ynë është ndoshta paksa i ndryshëm, por Shpirti i Jezusit është i njëjtë. Na thërret të gjithë neve, në të gjitha kishat e veta, në dorëzim më të thellë. Nëse "duke rënë në tokë (...) vdesim", do të sjellim fryte të begatshme.

Të përkujtojmë disa prej fryteve të pushimit në Shpirtin Shenjt prej vetëm disa shembujve:

- *Billy është liruar nga frika.
- *Vince ka lënë duhanin, alkoolin dhe jetën botore dhe është kthyer në kishën katolike.
- *Shërbesa që Charles dhe Frances Hunter bëjnë sot në mbarë botën ka filluar në dysHEME.
- *Kur Irenën e ka prekur mirësia e Tij, ia ka ndryshuar jetën.
- *Makinisti i pensionuar i është afruar Zotit.
- *Drejtori i shkollës ka kaluar në një nivel të ri të kuptimit të realiteteve shpirtërore.
- *Bujku e ka gjetur paqen në Zotin.
- *Mësuesi e ka fituar shpirtin e mësimit.
- *Shtëpiakja është shëruar në raportin e vet ndaj atit tokësor dhe Atit Qiellor.

- *Bibliotekistja është shëruar nga katër diskutët e përdredhur.
- *Është shëruar djaloshi me kancer të eshtrave.
- *Rregulltarja është shëruar nga mungesa e besimit.
- *Të burgosurit janë mbushur me paqe dhe shpresë.
- *Psikiatri në Floridë ka gjetur diçka më të mirë se hipnoza.
- *Mjeku ka pranuar 'riparimin e përgjithshëm'.

Përfundim

Kemi ardhur deri në fund të studimit tonë, por unë e përjetoj këtë si fillim. Ashtu si George Washington Carver nuk ka mësuar as përafërsisht të gjitha mbi kikirikun, ashtu edhe ne jemi larg nga kuptimi i të gjitha atyre që kanë të bëjnë me pushimin në Shpirtin Shenjt. I kemi ndarë përbërësit e shumtë dhe kemi shqyrtuar aplikimet e ndryshme, por pyetja të cilën do të kishim mundësi t'ia bënim Zotit, 'Përse e ke krijuar pushimin në Shpirtin Shenjt?' është edhe më tutje shumë e gjerë. Ndoshta është koha të nisemi, të përjetojmë atë përvojë dhe të gjejmë disa efekte të tjera për ne.

"Sprovoni e shihni sa i mirë është Zoti."
(Ps. 34, 9)

Lutja

Atë Qiellor, kthehemi në "punëtorinë" Tënde të vogël dhe lutemi përsëri për Shpirtin Tënd të së Vërtetës. E vërteta do të na lirojë. Zot, të lutemi, zbrit mbi ne me Shugurimin e fuqishëm të Shpirtit Shenjt. Na prek me paqen tënde të thellë, me atë paqe që bota s'mund të na japë. Na mbush me dashurinë Tënde shëruese. Na dërgo më tutje në fuqinë Tënde të Shenjtë, që t'u kthejmë të verbërve dritën e syve dhe t'i lirojmë të burgosurit. Të falem nderit, Atë Qiellor. Të falem nderit, Zotëri Jezus. Të falem nderit, Shpirti Shenjt. Amen.

*"Hiri dhe mirësia do të më përcjellin
në të gjitha ditët e jetës sime
do të banoj në shtëpinë e Zotit
derisa të jem gjallë."*
(Ps. 23,6).

Shtesë

Pasqyrë e pjesëmarrësve të seminarit

Janë anketuar 200 individë në seminarët në mbarë vendin, ishin 148 femra dhe 52 meshkuj.

Në pyetjen: sa herë kanë pushuar në Shpirtin Shenjt, deri tash janë përgjigjur kështu:

(këto nuk janë përqindje):

më pak se tri herë	10
3-20 herë	135
21-50 herë	17
51-100 herë	7
më shumë se 100 herë	20
pa përgjigje	11

Në pyetjen sa vjet janë në Ripërtëritje, janë përgjigjur:

Më pak se tri vjet	11
3-7 vjet	73
7-10 vjet	42
më shumë se 10 vjet	50
pa përgjigje	24

P Ë R M B A J T J A

Parathënie botimit kroat	2
Parathënie botimit anglisht	3
1. Zoti është bariu im, asgjë nuk më mungon	4
“Punëtorja e Zotit...” – të mësojmë nga George Washington Carver	4
Hyrja	4
Definicioni	9
Dëshmi	
“21 cigare...”	10
Motra Linda Koontz rrëfen një tregim të veçantë	
“Valët e mëshirës...”	11
Tregimi i Billy-t	
Kur ua kam nxjerrë këta dhëmbë?	12
Tregimi i Barbares	
ANKETA	12
(të dhëna statistikore të anketës)	
Pasqyrë e pikave kyçe	13
Lutja	13
2. Më mballon kullotave të gjelbra	14
Themelet biblike	14
I. Rënje të vullnetshme	14
II. Rënie pa qëllim	14
A. Konflikt shpirtëror	
Tregimi për Shën Augustinin dhe për disa shenjtër të tjerë	16
Në mbarë botën në mesin e pentakostalëve	17
Dëshmi	19
“Ndodhi në Romë...”	19
“Në qiell nuk ka orë...”	20
Tregimi i Mateut	
“Kur pashë se si Jezusi është i afërt...”	21

Tregimi i Karin-ës	
ANKETA	21
(edhe pak statistikë)	
Pasqyrë e pikave kyçe	22
Lutja	22
3. Më prin në ujëra të qeta	24
“Të gjithë ata njerëz që rrinë të shtrirë atje...”	24
Dukja nga jashtë	24
Ambienti	24
Pozita	24
Mjeti	25
Ndjenja gjatë rënies	25
Ndryshime në kuptimin trupor gjatë qëndrimit në dysHEME	25
Manifestimet trupore	25
Koha e qëndrimit në dysHEME	25
“Përqafime të kujdesshme dhe përkundje...”	25
Shikimi nga brenda	25
Përvojat e meshkujve	25
Përvojat e femrave	26
Dëshmi	28
“Më kujtohet se çka thoshte nëna...”	28
Tregimi i Vincent-it	
“Prekja e Mirësisë...”	28
Tregimi i Irenës	
“Unë? Aq të duhem unë?”	29
Tregimi i Evelyn-ës	
ANKETA	30
(edhe pak statistikë)	
Pasqyrë e pikave kyçe	30
Lutja	30
4. E freskon shpirtin tim	31
Dëshmi dhe mendime të meshtarëve dhe të rregulltarëve	31
“Ndoshta keni të drejtë, por...”	31
Ati Jack raporton nga Australia	
“Përqendrimi në ndryshim...”	31
Raport i një meshtari nga Minnesota	
“E thërrasin ‘motra Haleluja’ ...”	32
Rregulltarja nga Portoriko sjell tregimin e vet	
“Zoti në mirësinë e Tij...”	33
Mendime dhe dëshmi të atit Ralph DiOrio	
“Argumenti qëndronte në përvojë...”	34
Një skeptik irlandez sjell tregimin e vet	
“Do të përkulet çdo gju...”	35
Raste nga shërbesa i atit Rick Thomas në El Paso	
“Kuptimi im i pushimit në Shpirtin Shenjt ...”	36
Raport i një ipeshkvi të kujdesshëm nga Kalifornia	
“Me siguri është fjala për sasinë e sheqerit në gjak...”	37
Ati Tom raporton nga New Yorku	

"Rrëzimi nuk është pushim..."	38	
Ati Jim nga Skotlanda sjell një vërejtje		
"Të lutem, a do të pushosh të thithësh pëlqyerin?..."	39	
mendime personale dhe tregime nxitëse të motrës Fransis Clare		
ANKETA	41	
Pasqyrë e pikave kyçe	42	
Lutja	43	
5. Ai më prin shtigjeve të drejta	44	
"Shqyrtoni pushimin tim..."	44	
Disa lëmi kundërthënëse		
"Hipnoza, histeria dhe pushimi – terapi..."	46	
Përgjigjet e mjekëve dhe psikologëve në anketë		
"Shikoni mirë këtë..."	47	
Mendime psikologësh dhe mjekësh		
<i>Dëshmi</i>	48	
"Shpesh më kanë hipnotizuar..."	48	
Psikiatri nga Florida "krahason shënimet"		
"I kriposur' dhe i gatshëm..."	48	
Mendimet e mjekut nga Viskonsini		
"Dashuria që vërshon..."	49	
Letër e mjekut nga Louisiana		
"Zot, ndjem keq i shtrirë këtu... unë jam mjek!"	49	
dëshmi mbi 'riparimin e përgjithshëm' të ndërmarrë nga Shpirti Shenjt		
ANKETA	49	
(Edhe pak statistikë)		
Pasqyrë e pikave kyçe	50	
Lutja	50	
6. S'trembem nga e keqja, sepse ti je me mua	51	
Lista e Dorothesë të problemeve psikologjike		
të pushimit në Shpirtin Shenjt		51
Lutja të mënjanohej pengesat:	52	
Përmbledhje e disa preokupimeve pastorale	52	
"Para pushimit, gjatë pushimit dhe pas..."	54	
Përgatitja të hyhet në pushimin e Tij		
<i>Dëshmi</i>	55	
"Mu duk tepër thjesht..."	55	
Tregimi për faljen e motrës Monikë		
'Kam provuar madje edhe picën..."	55	
Raport nga Kanadaja		
"Thirrja e butë e Jezusit..."	56	
Dëshmia e Tomës		
ANKETA	57	
(Edhe pak statistikë)		
Pasqyrë e pikave kyçe	57	
Lutja	57	
7. Me vaj erëmirë kryet ma lyen,		

gotën ma mbush plot e përplot	58
<i>Dëshmi</i>	58
"Largohuni prej meje! Ende nuk kam pushuar..."	58
Tregimi nga Kalifornia	
"Ndjehesha si arra, e ndarë përgjysmë..."	58
Tregimi i Lucisë	
"Shpinorja e këmishës së Jimmy-t..."	59
Tregimi i Lindës	
"E bartëte nënën në Duart e Tij..."	59
Kujtimi i Muriel nga Massachusett-si	
Mendime për frytet e pushimit në Shpirtin Shenjt	
60	
Përfundim	61
Lutja	61
Shtesë	61
Përmbajtja	63